



BASHKIA DIBËR

# PLANI VENDOR PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE TË NGURTA URBANE

BASHKIA DIBËR / SHQIPËRI

Qershor 2017

Ky plan u përgatit nga Bashkia Dibër me ndihmën teknike të Qendrës Rajonale e Mjedisit (REC), Shqipëri dhe mbështetjen financiare të programit për decentralizimin dhe zhvillimin vendor (dldp) zbatuar nga Helvetas Albania.

***Stafi i përgatitjes së planit***

**Eduart Cani** (REC Shqipëri) - Hartues i planit dhe drejtues i ekipit

**Antike Torba** (Bashkia Dibër) - Përgjegjëse e ekipit vendor

**Daniela Ruçi** (REC Shqipëri) – Hartuese e fushatës dhe planit të ndërgjegjësimit

**Greisa Gurabardhi** (REC Shqipëri) - Përpunimet në GIS

***Nën drejtimin e***

**Mihallaq Qirjo** (REC Shqipëri)

**Arben Koplaku** (Helvetas Albania)

*dhe*

**Felix Schmidt** (CSD INGENIEURS, Zvicër)

**Emilie Gex** (CSD INGENIEURS, Zvicër)



# Tabela e përmbajtjes

<b>1</b>	<b>HYRJE .....</b>	<b>6</b>
1.1	RRETH PLANIT.....	6
1.1.1	<i>Detyrimet për hartimin e një plani vendor të menaxhimit të mbetjeve urbane .....</i>	<i>7</i>
1.2	HARTIMI I PLANIT .....	7
1.3	QËLLIMI I PLANIT.....	7
<b>2</b>	<b>POLITIKAT KOMBËTARE DHE KUADRI LIGJOR .....</b>	<b>9</b>
2.1	POLITIKA DHE STRATEGJIA KOMBËTARE MBI MBETJET .....	9
2.2	PRINCIPET E MANAXHIMIT TË MBETJEVE .....	9
2.3	KUADRI LIGJOR SHQIPTAR MBI MBETJET .....	10
2.4	STRUKTURAT KOMBËTARE MBËSHTETËSE.....	19
<b>3</b>	<b>PËRSHKRIMI I KARAKTERISTIKAVE TË ZONËS.....</b>	<b>20</b>
3.1	SHTRIRJA GJEOGRAFIKE .....	20
<b>4</b>	<b>PËRBËRJA ADMINISTRATIVE E NJËSIVE .....</b>	<b>22</b>
4.1	TË DHËNA TË PËRGJITHSHME .....	22
4.2	INFRASTRUKTURA.....	22
4.3	POPULLSIA .....	24
4.3.1	<i>Shpërndarja e popullsisë.....</i>	<i>26</i>
4.4	ARSIMI.....	27
4.5	STREHIMI.....	28
4.6	BIZNESET DHE KATEGORITË E TYRE .....	28
4.7	INSTITUCIONET .....	32
4.8	LËVIZJET DHE TENDENCAT DEMOGRAFIKE .....	32
<b>5</b>	<b>TË DHËNAT EKONOMIKE .....</b>	<b>35</b>
5.1	SEKTORËT EKONOMIKË.....	35
5.2	PUNËSIMI DHE PAPUNËSIA.....	35
<b>6</b>	<b>FINANCAT VENDORE .....</b>	<b>38</b>
6.1	BUXHETI I BASHKISË DIBËR.....	38
<b>7</b>	<b>PLANI OPERACIONAL PËR AFATIN KOHOR 2017 - 2022.....</b>	<b>40</b>
7.1	SITUATA AKTUALE .....	40
7.1.1	<i>Metodologjia.....</i>	<i>40</i>
7.2	INFORMACION I PËRGJITHSHËM .....	41
7.2.1	<i>Popullsia, vendbanimet, zona e shërbimit, gjenerimi i mbetjeve.....</i>	<i>41</i>
7.2.2	<i>Zhvillimi i sektorit të biznesit.....</i>	<i>44</i>
7.2.3	<i>Gjenerimi i mbetjeve urbane.....</i>	<i>44</i>
7.2.4	<i>Lloje të tjera të mbetjeve të gjeneruara .....</i>	<i>45</i>
7.2.5	<i>Ofrimi i shërbimit, frekuenca e grumbullimit.....</i>	<i>46</i>
7.2.6	<i>Infrastruktura e ofrimit të shërbimit aktual.....</i>	<i>47</i>
7.2.7	<i>Personeli .....</i>	<i>48</i>
7.2.8	<i>Gjendja e zonave të depozitimit të mbetjeve dhe operacionet.....</i>	<i>49</i>
7.2.9	<i>Objektet e riciklimit nëqoftëse ka ndonjë zyrtar dhe veprimtaritë e tjera si përshembull grumbulluesit e mbetjeve. ....</i>	<i>50</i>
7.3	ASPEKTET FINANCIARE.....	50

7.3.1	Buxheti total i Bashkisë.....	50
7.3.2	Buxheti i përgjithshëm i Bashkisë për shërbimet e menaxhimit të mbetjeve të ngurta.....	51
7.3.3	Shpenzimet bazuar në ekv. Kosto/banorë .....	52
7.3.4	Tipologjia e tarifave .....	52
7.3.5	Kapaciteti i mbulimit të kostos (mbledhja e tarifës) në përqindje .....	52
7.3.6	Tarifa e paguar (ekv. banorë. /vit).....	55
7.4	NIVELI I PERFORMANCËS.....	57
7.4.1	1.1 Kuptimi i vlerave të treguesve.....	57
<b>8</b>	<b>PLANIFIKIMI PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE NË NIVEL LOKAL .....</b>	<b>59</b>
8.1	VIZIONI I PLANIT.....	59
8.2	QËLLIMI I PLANIT.....	59
8.3	OBJEKTIVAT SPECIFIKE TË PLANIT .....	59
8.4	RRYMAT E MBETJEVE TË CILAT JANË OBJEKT I KËTIJ PLANI .....	59
8.5	ZBATIMI I HIERARKISË SË MENAXHIMIT TË MBETJEVE.....	60
8.5.1	Shmangia .....	60
8.5.2	Ripërdorimi .....	61
8.5.3	Riciklimi.....	61
8.5.4	Mbetje për energji .....	62
8.5.5	Depozitimi i mbetjeve .....	62
<b>9</b>	<b>PLANIFIKIMI I MENAXHIMIT TË MBETJEVE .....</b>	<b>63</b>
9.1	ANALIZA E DETAJUAR E SITUATËS .....	63
9.1.1	Gjeografia .....	63
9.1.2	Vendbanimet.....	66
9.1.3	Infrastruktura rrugore.....	66
9.1.4	Popullsia.....	69
9.1.5	Zhvillimi Ekonomik .....	69
9.1.6	Kapaciteti financiar.....	70
9.1.7	Sjellja e klientit.....	70
9.2	ZHVILLIMI I SKEMËS FUNKSIONALE PËR PERIUdhËN 2017 - 2022 .....	71
9.3	PËRCAKTIMI I NIVELIT TË PERFORMANCËS 2017-2022 .....	92
9.4	SHPJEGIMI I VLERAVE TË TREGUESVE TË PROJEKTUAR .....	93
9.5	POLITIKAT E TARIFËS .....	100
9.6	TARIFA MBULON KOSTON.....	102
9.7	PROÇESI I FSHIRJES .....	105
9.7.1	Gjendja aktuale.....	105
9.7.2	Plani i fshirjes së qytetit Peshkopi (2017-2022) .....	107
9.7.3	Standardizimi i proçesit të fshirjes .....	107
9.8	MENAXHIMI I RRYMAVE TË TJERA TË MBETJEVE .....	111
9.8.1	Mbetjet Spitalore (të kujdesit shëndetësor).....	111
9.8.2	Mbetjet Elektrike dhe Elektronike (MEE) .....	111
9.8.3	Mbetjet nga vajrat e përdorur .....	111
9.8.4	Mbetjet nga gomat e përdorura.....	112
9.9	STRUKTURA E OFRIMIT TË SHËRBIMIT.....	113
<b>10</b>	<b>PLANI I VEPRIMIT .....</b>	<b>114</b>
<b>11</b>	<b>MONITORIMI DHE PERFORMANCA .....</b>	<b>121</b>
11.1	OBJEKTI.....	121
11.2	AKTORËT E MONITORIMIT .....	121
<b>12</b>	<b>SISTEMI I PERFORMANCËS .....</b>	<b>127</b>



<b>13</b>	<b>ANALIZA E DETAJUAR FINANCIARE DHE OPERATIVE E SHËRBIMIT.....</b>	<b>128</b>
13.1	ZONA E SHËRBIMIT PESHKOPI – TOMIN .....	128
13.2	ZONA E SHËRBIMIT MAQELLARË - MELAN .....	133
<b>14</b>	<b>KOMUNIKIM DHE NDËRGJEGJËSIM .....</b>	<b>138</b>
<b>15</b>	<b>SHTOJCAT .....</b>	<b>139</b>

## 1 HYRJE

### 1.1 Rreth planit

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta (PVMIMN) është një dokument planifikimi strategjik, i cili mundëson zbatimin e politikave kombëtare të mbetjeve në nivel bashkiak, si një dokument / udhëzues i rëndësishëm për menaxhimin e mbetjeve urbane në Bashkinë Dibër.

Ky plan mundëson orientimin strategjik të menaxhimit të shërbimit të mbetjeve urbane për sot dhe për të ardhmen, dhe, njëkohësisht, krijon një qëndrim të përbashkët midis aktorëve të ndryshëm për menaxhimin e mbetjeve në nivel vendor. Plani është më shumë i orientuar në veprime konkrete dhe të detajuara, në lidhje me sistemin e grumbullimit, të riciklimit, të trajtimit final dhe të impianteve përkatëse të trajtimit të mbetjeve.

Plani është ndërtuar në 3 pjesë kryesore:

**Pjesa e parë:** Përshkrim i njësisë vendore duke marrë në konsideratë elementët që kanë rëndësi të drejtpërdrejtë në menaxhimin e mbetjeve, të tilla si: gjeografia; topografia; sistemi rrugor; ekonomia; popullsia dhe lëvizjet e popullsisë, etj.;

**Pjesa e dytë:** Paraqitje e planit operacional të ofrimit të shërbimit dhe të të gjithë elementëve përbërës të shërbimit si: zonat e shërbimit; veprimet në terren; aspektet financiare; politikat e tarifës; organizimi funksional i stafit; monitorimi dhe ndërgjegjësimi;

**Pjesa e tretë:** Shtojcat e planit, të cilat janë, gjithashtu, të rëndësishme pasi përcaktojnë në detaje operacionet financiare të shërbimit, shërbimin në zonat e largëta, planin operacional për përmirësimin e fushës së depozitimit dhe rregulloren vendore.

***Të tre këto pjesët përbëjnë planin në tërësi dhe janë të nevojshme të përdoren së bashku, dhe sipas rastit edhe veç e veç.***

Ky plan sjell për herë të parë një sistem të planifikimit të shërbimit në terren me anë të shërbimit GIS Netowrk Analyst, i cili është i pasuruar me informacion nga terreni për të bërë më eficient rrugëtimin e makinës në grumbullim dhe për të përcaktuar më drejt kohën dhe shpenzimet në ofrimin e shërbimit.

Plani është i pajisur me hartat në GIS, të cilat mundësojnë një panoramë më të qartë të shërbimit në terren dhe lehtësojnë procesin e përmirësimit të mëtejshëm të shërbimit.

**Është e rëndësishme të theksohet se, ky plan është hartuar si dokumenti i parë për Bashkinë në këtë sektor dhe si i pari pas bashkimit të 15 njësisë në Bashkinë Dibër. Kësisoj, ky dokument pritet që, së pari të vendosë në normë sistemin e grumbullimit të mbetjeve dhe ta nxjerrë atë nga gjendja kaotike në të cilën ndodhet sektori, duke shtruar rrugën për një sistem edhe më të avancuar në vitet në vijim. Çdo arritje e këtij plani do të mundësojë më shumë pastërti, edukatë dhe kulturë institucionale në sektorin e menaxhimit të mbetjeve për Bashkinë Dibër. Për arritjen e qëllimeve të tij do të përballemi me sfida të mëdha, të cilat kanë të bëjnë, pikë së pari, me thyerjen e mentalitetit ndaj shërbimeve publike. Ndaj, kërkohet një angazhim i madh nga të gjithë institucionet, ku, veçanërisht, shkollat kanë një rol shumë të madh për të luajtur.**

### 1.1.1 Detyrimet për hartimin e një plani vendor të menaxhimit të mbetjeve urbane

Menaxhimi i mbetjeve përcaktohet si funksion ligjor i Bashkisë në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 23 - Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve: ...4. Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake.

Hartimi i planit vendor për menaxhimin e mbetjeve nga Njësitë e Qeverisje Vendore është një detyrim ligjor i përcaktuar nga Ligji i ri nr.10 463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, ku në nenin 12, pika 2 citohet: *Çdo njësi e qeverisjes vendore, apo grup njësisish të qeverisjes vendore, harton planin vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve për territorin që ka nën juridiksion, në përputhje me planin kombëtar dhe planin rajonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe me kërkesat e nenit 10 të këtij ligji.*

## 1.2 Hartimi i planit

Ky plan është përgatitur nga një ekip teknik, i përbërë nga përfaqësues të Bashkisë Dibër dhe ekipi i projektit nga Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) Shqipëri, të cilat kanë punuar nën mbështetjen e Programit të Decentralizimit dhe Zhvillimit Lokal (DLDP), në kuadër të projektit “Fuqizimi i sistemit të menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Dibër”, për periudhën Mars 2016 – Qershor 2017.

### **Plani u hartua si një proces, i cili kaloi në fazat e mëposhtme:**

Grumbullim informacioni > Analizë e gjendjes > Projektim > Diskutim > Konsultime > Projektim > Verifikim në terren > Grumbullim të dhënash të mëtejshme > Projektim > Konsultim > Dakortësim > Finalizim > Miratim.

Si rezultat i këtij procesi, u hartua dokumenti i plotë i planit dhe produktet mbështetëse të tij.

Një raport i shkurtër i takimeve konsultative për hartimin e planit, gjendet bashkëlidhur këtij dokumenti.

## 1.3 Qëllimi i planit

**Qëllimi i këtij plani është të parashtrojë një qasje të qartë të politikave të menaxhimit të mbetjeve në nivel vendor, duke vlerësuar aftësinë përbaluese dhe vetëmjaftuese si principe të vendosura nga Ligji organik Nr. 139/2015 “Për vetë-qeverisjen vendore”. Plani vlerëson variantet më të mundshme dhe të përballueshme, duke parashtuar atë variant që është i mundshëm teknikisht, financiarisht dhe që mund të përballohet nga qytetarët e njësisë dhe të administratës vendore.**

Më konkretisht, ky plan ka si qëllim të mundësojë dhe të sigurojë si më poshtë:

- *Përputhshmëri maksimale me Strategjinë Kombëtare të Mbetjeve (SKM) dhe objektivat e saj: duke kontribuar në zbatimin e politikave kombëtare dhe në arritjen e objektivave kombëtare në fushën e mbetjeve;*
- *Variantet e menaxhimit të mbetjeve: për të mundësuar grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve në përputhje me objektivat kombëtare. Plani identifikon fushat dhe teknologjitë e duhura për minimizimin dhe depozitimin (asgjesimin) final të mbetjeve;*

- *Nevojat financiare për investime:* duke përshkruar dhe argumentuar nevojat financiare dhe ato për investime, me qëllim zbatimin e skemave të grumbullimit dhe të trajtimit të mbetjeve;
- *Burimet financiare për investime:* duke krijuar një klimë të favorshme për sigurimin e fondeve qeveritare për mbetjet, sikurse dhe fonde nga institucionet ndërkombëtare;
- *Instrumentet institucionale, organizative dhe rregullore:* duke mundësuar një paraqitje të plotë të kuadrit institucional, organizativ dhe rregullator dhe duke rekomanduar masat për përmirësimin e elementëve përbërës të tij.

## 2 POLITIKAT KOMBËTARE DHE KUADRI LIGJOR

### 2.1 Politika dhe Strategjia Kombëtare për mbetjet

Strategjia Kombëtare e Mbetjeve dhe Plani Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve (2011) ka përcaktuar drejtimin e politikës së Qeverisë së Shqipërisë për menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve deri në 2025-ën, duke synuar minimizimin e ndikimit të mbetjeve në mjedis në nivel kombëtar dhe vendor dhe përmirësimin e përdorimit eficient të burimeve në Shqipëri. Kjo strategji është krijuar duke u mbështetur në angazhimin e Qeverisë Shqiptare për të përmbushur angazhimet dhe detyrimet e përafritit me BE në lidhje me reduktimin e mbetjeve, riciklimin, kompostimin apo përpunimin me përfitim energjie. Ajo ka vendosur, njëkohësisht, objektiva sfidues dhe realistë, të cilët synojnë ndryshimin rrënjësor të mënyrës së menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri.

Strategjia kombëtare e mbetjeve paracakton katër shtylla kryesore me qëllim zbatimin e politikës dhe të strategjisë së mbetjeve nëpërmjet Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve (PKMM). Këto shtylla politike janë thelbësore dhe shumë të rëndësishme për të garantuar qëndrueshmërinë dhe suksesin e të gjithë menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri.

#### Shtyllat politike janë si në vazhdim:

Planifikimi	Edukimi	Mbështetja financiare	Forcimi i kuadrit ligjor
Hapi i parë në zbatimin e procesit duhet të jetë zhvillimi i planeve për të çuar përpara axhendën e strategjisë dhe të politikës së mbetjeve në lidhje me zbatimin.	Partnerët/bashkë-punëtorët kryesorë të sistemit duhet të edukohen në mënyrë që të përmbushin potencialin e tyre brenda sistemit dhe të lehtësojnë zbatimin e reformave.	Burimet njerëzore dhe vetë sistemi duhet të mbështeten financiarisht në mënyrën e duhur.	Sistemi kërkon një paketë rregulloresh. Për më tepër, për të siguruar hyrjen në Bashkimin Evropian, vendi do të duhet të bëjë përafritim me legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian në fushën e mjedisit, në vitet në vijim.

### 2.2 Principet e menaxhimit të mbetjeve

Direktivat e BE-së dhe dokumentet strategjike, rekomandojnë që të gjithë planet në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor duhet të bazohen në parimet e përgjithshme, paraqitur më poshtë:

Parimi reduktues	Parimi parandalues	Parimi i afërsisë dhe vetëmjaftueshmërisë	Përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit
Të sigurojë ruajtjen e burimeve natyrore, duke minimizuar sa më shumë të jetë e mundur, gjenerimin e mbetjeve. Qëllimi kryesor në reduktimin	Të sigurojë reduktimin e ndikimit nga mbetjet në shëndetin e njerëzve dhe të mjedisit, veçanërisht të reduktojë substancat e	Kërkon që mbetjet të menaxhohen sa më afër vendit ku gjenerohen.	Parimi kërkon që prodhuesit e produkteve të mbulojnë koston e menaxhimit të mbetjeve që gjenerojnë. Kështu,

e mbetjeve qëndron në domosdoshmërinë e ndërprerjes së lidhjes midis rritjes ekonomike dhe gjenerimit të tyre.	rrezikshme tek mbetjet.	kostot mjedisore dhe kostoja e menaxhimit të mbetjeve në të gjitha proceset, duhet të reflektohen në çmimin e produktit si dhe në tarifat për ofrimin e shërbimit. Synimi është ofrimi i një sistemi të drejtë dhe dekurajues për gjenerimin pa kriter të mbetjeve.
--	-------------------------	---

### 2.3 Kuadri ligjor shqiptar për mbetjet

Qeveria Shqiptare është e angazhuar në procesin e anëtarësimit të plotë në BE dhe, për këtë qëllim, Ministria përgjegjëse për mjedisin punon drejt përafrimit dhe përshtatjes së legjislacionit shqiptar në përputhje me instrumentat legjislativë të BE-së. Progresi më i madh në fushën e mbetjeve është bërë në fushën e legjislacionit. Gjatë periudhës 2008-2016, legjislacioni shqiptar për menaxhimin e mbetjeve është përmirësuar me ligje të reja, vendime dhe rregullore, që reflektojnë direktivën kuadër të BE-së dhe detyrimet nga Konventa e Baselit.

Në tabelën më poshtë jepet një përmbledhje e kuadrit ligjor shqiptar në fushën e menaxhimit të mbetjeve dhe detyrimet që kanë bashkitë në zbatim të tij:

**Tabela 1. Kuadri ligjor mbi të cilin bazohet menaxhimi i mbetjeve në Shqipëri dhe detyrimet e bashkisë**

Kuadri ligjor	Detyrimi Ligjor
1) Ligji Nr.10 463, datë 22/09/2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përcaktimi i përparësive në ligje, strategji, plane dhe programe të menaxhimit të integruar të mbetjeve, të trashëguara apo të atyre që krijohen bëhet duke pasur parasysh hierarkinë e mëposhtme: <ul style="list-style-type: none"> <li>a) parandalimin e mbetjeve;</li> <li>b) përgatitjen për ripërdorim;</li> <li>c) riciklimin;</li> <li>d) rikuperime të tjera;</li> <li>e) asgjësimin.</li> </ul> </li> <li>• Për përcaktimin e kësaj hierarkie mbahen parasysh parimet e përgjithshme për mbrojtjen e mjedisit, të përcaktuara në <b>nenet 6-14 të Ligjit Nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit"</b> dhe kërkesat e tjera të këtij ligji. Në rastet e zbatimit të hierarkisë së menaxhimit të integruar të mbetjeve, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, ministria dhe të gjitha autoritetet përkatëse marrin masa për të nxitur variantet me rezultatet e përgjithshme më të mira për mjedisin.</li> <li>• Aktet nënligjore të veçanta për rryma të veçanta mbetjesh bazohen në hierarkinë e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, kur një gjë e tillë justifikohet nga analiza e ciklit të kohëzgjatjes së ndikimeve të përgjithshme, që vijnë nga krijimi dhe menaxhimi i këtyre mbetjeve, në mënyrë që të përftohet rezultati i përgjithshëm më i mirë për mjedisin.</li> </ul>

- Çdo njësi e qeverisjes vendore, apo grup njësisish të qeverisjes vendore, harton planin vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve për territorin që ka nën juridiksion, në përputhje me planin kombëtar dhe planin rajonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe me kërkesat e nenit 10 të këtij ligji.
- Çdo njësi e qeverisjes vendore, apo grup njësisish të qeverisjes vendore, përcakton rregulloren për kontrollin e menaxhimit të rrymave specifike të mbetjeve, që gjenerohen në territorin e saj, përfshirë letrën dhe kartonin, ambalazhet prej qelqi, metali e plastike të pijeve dhe ushqimeve, ose masën e gjelbër nga parqet a kopshtet e shtëpive. Këto rregulla mund të jenë më strikte sesa qëllimet dhe kërkesat e përcaktuara në Planin Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve. Këto rregullore miratohen nga këshilli i qarkut.
- Njësitë e qeverisjes vendore grumbullojnë në mënyrë të diferencuar mbetjet, sipas nenit 16 të këtij ligji, brenda 31 dhjetorit 2018, të paktën për këto rryma mbetjesh: letër, metal, plastikë dhe qelq.
- Kryetarët e njësive të qeverisjes vendore janë përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin e mbetjeve që krijohen brenda territorit të tyre administrativ, në përputhje me kërkesat e këtij ligji.

**2) Ligji Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”**

- Objektivat e mbrojtjes së mjedisit:
  - a) parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji;
  - b) ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
  - c) ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike;
  - d) përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;
  - e) ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror;
  - f) mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit;
  - g) mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe i shëndetit të njeriut.
- Parimet e mbrojtjes së mjedisit:
  - Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
  - Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
  - Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
  - Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
  - Parimi i qasjes së integruar
  - Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe i bashkëpunimit
  - Parimi “Ndotësi pagan”**
  - Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
  - Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit.
- Organet e qeverisjes vendore kanë si detyrë:
  - a) Të përcaktojnë vendet e grumbullimit dhe të përpunimit të mbetjeve prodhuese dhe jetësore, në përputhje me kriteret mjedisore dhe planet e zhvillimit; e. të organizojnë depozitimin e mbetjeve dhe të lëndëve të rrezikshme dhe ruajtjen e zonave të gjelbra në qendrat qytetëse dhe rreth tyre;
  - b) Të administrojnë mbetjet qytetëse, impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura dhe të mbetjeve të ngurta.

<p>3) Vendim Nr.575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte"</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <u>Njësitë e Qeverisjes Vendore</u> janë përgjegjëse për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim, sipas llojit, sasisë dhe përbërjes së tyre, të krijuar në territorin e njësisë së qeverisjes vendore që ato administrojnë.</li> </ul>
<p>4) Vendim Nr. 387, datë 6.5.2015 "Për miratimin e rregullave për kontrollin e asgjësimit të PCB-ve, çndotjen apo asgjësimin e pajisjeve që përmbajnë PCB dhe/ose asgjësimin e mbetjeve të PCB-ve të përdorura"</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <u>Njësitë e Qeverisjes Vendore</u>, janë të detyruara të plotësojnë formatin e raportimit të statistikave vjetore të mbetjeve për mbetjet e krijuara në territorin e tyre, dhe i dërgojnë këto të dhëna në Këshillin e Qarkut përkatës, në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe në ministrinë përgjegjëse për infrastrukturën/transportin brenda datës 31 Janar, të çdo viti.</li> </ul>
<p>5) Vendim Nr. 418, datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim"</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <u>Njësitë e qeverisjes vendore</u> janë përgjegjëse për marrjen e masave mbi arritjen e objektivave dhe afateve të përcaktuara në këtë vendim.</li> <li>• <u>Çdo njësi e qeverisjes vendore</u> raporton, në mënyrë periodike, objektivat dhe të dhënat mbi grumbullimin e rrymave të mbetjeve në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, brenda datës 31 Janar të çdo viti.</li> <li>• <u>Bashkitë</u> e kategorisë së parë përcaktojnë masat e përshtatshme për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve, brenda datës 31 Dhjetor 2016, të paktën për rrymat e mbetjeve të mëposhtme: Letër/karton; Metal; Plastikë; Qelq.</li> <li>• <u>Njësitë e qeverisjes vendore</u> marrin masat për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim, duke iu siguruar qytetarëve minimalisht një sistem grumbullimi mbetjesh prej tre grupesh, për: Mbetje të riciklueshme të thata; Mbetje të riciklueshme të njoma; Mbetje të pariciklueshme.</li> <li>• Ofrim të numrit të duhur të koshave dhe të kontenierëve në çdo pikë grumbullimi të mbetjeve në të gjithë vendin.</li> </ul>
<p>6) Vendim Nr. 608, datë 17.09.2014 "Për masat e nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve BIO si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre"</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <u>Njësitë e qeverisjes vendore</u>, në planet e tyre të menaxhimit të mbetjeve dhe në përputhje me nevojat vendore, realizojnë grumbullimin e mbetjeve bio me frekuenca ditore, javore ose më të gjata se javore, ose zbatojnë sisteme të tjerë, të ndryshëm për grumbullimin e mbetjeve bio, të tilla si kompostimi i mbetjeve në oborret e shtëpive. Vendi ku do të vendosen koshat e mbetjeve bio, përcaktohet nga njësia përkatëse e qeverisjes vendore.</li> <li>• Objektivat që duhen arritur nga <u>njësitë e qeverisjes vendore</u> për pakësimin e sasisë së mbetjeve bio që shkojnë në landfill janë: *të ulet në masën 50% të peshës totale të mbetjeve bio të prodhuara në 2014, jo më vonë se 7 vjet pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi; *të ulet në masën 35% të peshës totale të mbetjeve bio të prodhuara në 2014, jo më vonë se 12 vjet pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.</li> <li>• Në rastet e zonave me shtëpi private, <u>njësia e qeverisjes vendore</u> duhet të sigurojë kontenierë individualë për të lehtësuar trajtimin e duhur të mbetjeve bio.</li> </ul>



- Njësia e qeverisjes vendore në zonat rurale përcakton për banorët brenda territorit që ka nën juridiksion, mënyrat, vendet dhe afatet kohore për trajtimin e mbetjeve bio në shtëpi ose në nivel lagje.
- Njësiti e qeverisjes vendore bashkëpunojnë midis tyre për të nxitur:
  - \*Sisteme të përbashkëta të grumbullimit të mbetjeve bio;
  - \*Ngritjen e skemës së ndarjes së mbetjeve bio.
- Ky bashkëpunim mundëson grumbullimin optimal të mbetjeve bio, ripërdorimin dhe riciklimin ose asgjësimin në një nga impiantet më të afërt, me teknologjitë dhe metodat më të përshtatshme, me qëllim sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe të shëndetit publik.
- Çdo njësi e qeverisjes vendore raporton, brenda fundit të muajit dhjetor të çdo viti, në këshillin e qarkut përkatës të dhëna mbi grumbullimin e mbetjeve bio dhe objektivat e trajtimit, si pjesë e raportimit për zbatimin e planit vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve.
- Në rastet e zonave me shtëpi private të shpërndara, njësia e qeverisjes vendore duhet të sigurojë kontenerë individualë për të lehtësuar kompostimin dhe/ose digjestimin e duhur të mbetjeve bio, sipas rastit.
- Njësia e qeverisjes lokale në zonat urbane duhet të nxisë, kur është e përshtatshme, kompostimin në shtëpi ose në nivel lagje, duke zbatuar metodat optimale që respektojnë traditat lokale.
- Njësia e qeverisjes vendore në zonat rurale harton dispozita detyruese për kompostimin në shtëpi ose në nivel lagje. Masa dhe metoda të tjera për të arritur objektivat brenda afateve të përcaktuara, duhet të parashikohen në çdo Plan Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve, në përputhje me Udhëzimin e Ministrit “Për miratimin e manualit “Për planifikimin vendor të menaxhimit të mbetjeve”.

7) Vendim Nr. 798, datë 29/09/2010 për miratimin e rregullores "Për administrimin e mbetjeve spitalore"

- Organet e pushtetit vendor janë përgjegjëse për miratimin e vendndodhjes së impianteve të përpunimit të mbetjeve spitalore dhe të venddepozitimit të mbetjeve spitalore jo të rrezikshme.
- Organet e pushtetit vendor monitorojnë administrimin e mbetjeve spitalore sipas kompetencave.

8) Vendim Nr. 866, datë 04/12/2012 "Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre"

- Njësiti e qeverisjes vendore llogarisin përqindjet e grumbullimit, të realizuara në territorin ku shtrijnë juridiksionin e tyre, gjatë vitit kalendarik paraardhës dhe i regjistrojnë ato në regjistrat e tyre, të krijuar për këtë qëllim.
- Njësiti e qeverisjes vendore raportojnë në agjenci, brenda muajit prill të çdo viti, përqindjet e realizuara të grumbullimit për vitin paraardhës, sipas tabelës së paraqitur në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

9) Vendim Nr. 705, datë 10/10/2012 "Për menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në fund të jetës"

- Roli i autoriteteve publike
  - \*Autoritetet publike, qendrore dhe vendore, njësiti e qeverisjes vendore në nivel qarku, në bazë të përgjegjësi të tyre, miratojnë hapësira të përshtatshme për ushtrimin e veprimtarisë së trajtimit të automjeteve të dala jashtë përdorimit, me kërkesë të operatorëve ekonomikë.
  - \*Autoritetet publike, qendrore dhe vendore, si administrues të mjedisit apo pjesëve të tij, brenda kompetencave të tyre, realizojnë miratimin e vendgrumbullimeve apo të vendeve të posaçme ku do të ushtrohen

	<p>veprimtaritë e përcaktuara në këtë vendim, si dhe monitorimin e zbatimit e këtij vendimi nga strukturat përkatëse.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mospranimi i hedhjes së gomave në gropa.</li> </ul>
<p>10) Vendim Nr. 957, datë 19/12/2012 "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike"</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <u>Njësitë e qeverisjes vendore</u>, prodhuesit dhe shpërndarësit, apo palë të treta që veprojnë në emër të tyre, marrin masat e nevojshme për të minimizuar asgjësimin e MPEE-ve, si mbetje e pandarë nga mbetjet e tjera bashkiake dhe për të siguruar një nivel të lartë grumbullimi të diferencuar të MPEE-ve. -Ngarkohen ministria, ministria përgjegjëse për ekonominë, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, <u>njësitë e qeverisjes vendore</u> dhe të gjithë personat, fizikë ose juridikë, të përmendur më lart, për zbatimin e këtij vendimi.</li> <li>• <u>Njësitë e qeverisjes vendore</u> përcaktojnë dhe miratojnë vendet e grumbullimit të diferencuar të MPEE-ve.</li> <li>• <u>Njësitë e qeverisjes vendore</u> llogaritin peshën totale të hyrjeve dhe të daljeve në territorin nën juridiksionin e tyre dhe përqindjet përkatëse, sipas përcaktimeve të bëra në shkronjat "a", "b", "c" dhe "ç" të pikës 1, gjatë vitit kalendarik paraardhës dhe i regjistrojnë ato në regjistrat e tyre të krijuar për këtë qëllim.</li> <li>• <u>Njësitë e qeverisjes vendore</u> raportojnë brenda muajit prill të çdo viti, në agjenci, për rezultatet e llogaritjeve të bëra për vitin paraardhës sipas pikës 8 të këtij kreu.</li> <li>• Koleksione të veçanta të MPEE-ve nga shtëpiaket.</li> <li>• Rigjenerimi i objektivave të MPEE.</li> </ul>
<p>11) Vendim Nr. 177, datë 06/03/2012 "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre"</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ngarkohen Ministria, Inspektorati Qendror Teknik, në varësi të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, <u>njësitë e qeverisjes vendore</u> dhe të gjithë operatorët ekonomikë e subjektet e përcaktuara në këtë vendim, për zbatimin e këtij vendimi.</li> <li>• <u>Njësitë e qeverisjes vendore</u> raportojnë, brenda datës 28 shkurt të çdo viti, në agjenci, shifrat e realizuara të grumbullimit për vitin paraardhës, sipas pikës 4 të kreut XI të këtij vendimi, dhe në total për gjithë territorin nën juridiksionin e tyre.</li> <li>• Riciklimi i mbetjeve të paketimeve (shuma në % nga pesha)</li> <li>• Riciklimi i drurit në mbetjet e paketimeve (shuma në % nga pesha)</li> </ul>
<p>12) Ligj Nr. 10 304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë"</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <u>Njësitë e qeverisjes vendore</u> mund t'i propozojnë ministrit miratimin e zonave minerare, karrierat, për t'u shfrytëzuar për qëllime publike vendore, në sipërfaqet në pronësi të njësisë përkatëse.</li> <li>• Shfrytëzimi i karrierave për qëllime publike vendore, sipas përcaktimeve të nenit 23 të këtij ligji, mund të bëhet vetëm nga subjekti i krijuar <u>nga njësia e qeverisjes vendore</u>, në pronësi dhe në juridiksionin e së cilës ndodhet karriera, por vetëm pas pajisjes së saj me leje shfrytëzimi, sipas procedurave të këtij ligji.</li> </ul>
<p>13) Ligj Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Neni 23 - <u>Bashkitë</u> janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:             <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja.</li> </ol> </li> </ul>

2. Sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen nga ndotja akustike.
  3. Zhvillimin e aktiviteteve edukuese dhe promovuese, në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e mjedisit.
  4. Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake
  5. Administrimin e shërbimeve publike
- Neni 33 - Njësitë e vetëqeverisjes vendore sigurojnë dhënien e shërbimeve publike, nëpërmjet një ose më shumë instrumenteve. Në çdo rast, pavarësisht nga instrumenti i përzgjedhur, njëzia vendore do të jetë përgjegjëse për krijimin e një njësie të posaçme në strukturën e njësisë së vetëqeverisjes vendore, e cila do të jetë përgjegjëse për prezantimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e performancës dhe të shërbimit, përfshirë edhe aspektin gjinor.

**14) Ligji Nr. 8094, datë 21.3.2000 "Për largimin publik të mbetjeve"**

- *Neni 7 - Dorëzimi i mbetjeve*

Dorëzimi i mbetjeve kryhet nëpërmjet koshave, kazanëve e stacioneve të betonit në pika të caktuara të vendosura nga bashkia e qytetit dhe komuna.

- *Neni 9 - Metodrat dhe teknologjitë që përdoren ose do të përdoren për largimin publik të mbetjeve, caktohen nga bashkitë dhe komunat, në bashkëpunim me organet kompetente, sipas rregullores për shërbimin e pastrimit publik.*

- *Neni 14 - Kontrolli dhe mbikëqyrja*

Bashkia e qytetit dhe komuna kanë të drejtë të kontrollojnë e të mbikëqyrin largimin e mbetjeve, në përputhje me kushtet tekniko-higjienike, në zbatim të kontratës, nga personat e autorizuar prej saj.

- *Neni 17 - Zonë pastrimi*

Bashkitë e qyteteve dhe komunat, brenda perimetrit të vijës kufizuese që ato kanë nën juridiksion, bëjnë ndarjen territoriale në zona pastrimi, së bashku me seksionin e urbanistikës, si më poshtë:

1. Qytetet me popullsi deri në 100 000 banorë kanë një zonë pastrimi.
2. Qytetet me popullsi mbi 100 000 banorë mund të organizojnë disa zona pastrimi.

- *Neni 19 - Largimi i mbetjeve*

Largimi publik i mbetjeve (pastrimi) është mbledhja me kontenier dhe transportimi i tyre në vendet e caktuara nga bashkia e qytetit ose komuna. Mbledhja dhe transportimi i mbetjeve bëhet në përputhje me rregullat teknike të higjienës dhe të depozitimit të tyre, të përcaktuara në rregulloren e pastrimit të qyteteve.

- *Neni 22 - Organet e pushtetit lokal* (bashkia, komuna) caktojnë një person për kontrollin e zbatimit të kontratës (mbikëqyrës), i cili paguhet nga taksat e mbledhura për shërbimin e pastrimit.

- *Neni 25 - Vendgrumbullimi i mbetjeve publike*, për bashkitë e qytetit dhe komunat, është gjithnjë jashtë perimetrit të vijës kufizuese të tyre.

- *Neni 31 - Caktimi i tarifave*

Bashkitë dhe komunat caktojnë tarifën për largimin publik të mbetjeve. Tarifën e pastrimit caktohen duke pasur parasysh teknikën dhe teknologjinë e përdorur, koston, numrin e kontenierëve dhe kushte të tjera.

- *Neni 37 - Shkelja e dispozitave të këtij ligji*, parashikuar në nenet 7, 11, 14, 15, 23, 24 dhe 27, keqpërdorimi, ndërrimi i destinacionit të kazanëve, koshave, stacioneve të betonuara të plehrave, hedhja e

parregullt e plehrave dhe atyre voluminoze, hedhja e mbetjeve të rrezikshme e të dëmshme, parkimi i mjeteve para ose pranë pikave të mësipërme, mospastrimi i hapësirave publike dhe terreneve private, hedhja në territore dhe sipërfaqe publike e mbetjeve të përcaktuara në nenin 5, mospastrimi i vendeve përreth lokaleve ose pikave ambulante të shitjes, dënohen me gjobë nga 1000 lekë deri në 5000 lekë. Gjohat vendosen nga inspektorët sanitarë të caktuar nga bashkia ose komuna”.

**15) Ligji Nr. 8094, datë 21.3.2000 “Për largimin publik të mbetjeve” - Dispozita të përgjithshme**

- *Neni 1*

Duke detajuar të drejtat dhe detyrat e të gjithë palëve që marrin pjesë në procesin e administrimit të mbetjeve të ngurta urbane, rregullorja synon të lehtësojë zbatimin e kërkesave të legjislacionit të kësaj fushe dhe të mundësojë një kontroll efektiv e të vazhdueshëm në zbatimin e tyre.

- *Neni 2*

Kjo rregullore përcakton mënyrën e administrimit mjedisor të mbetjeve urbane në territorin e Bashkisë, duke saktësuar rregullat, teknikat dhe metodat e trajtimit të tyre në çdo fazë të këtij administrimi, me qëllim mbrojtjen e mjedisit urban nga ndotja me mbetje dhe mbajtjen e një mjedisi të shëndetshëm për banorët e qytetit.

- *Neni 8*

Mbetjet që prodhohen nga ekonomitë familjare, por që nuk përfshihen në mbetjet urbane, si për shembull mbetjet e rrezikshme, mbetjet nga ndërtimi apo prishja e ndërtesave dhe objektet e vëllimshme, transportohen nga vetë prodhuesit e tyre në fushat përkatëse të depozitimit, që specifikohen nga bashkia përkatësisht për secilën prej mbetjeve.

- *Neni 11*

Sistemimi dhe dorëzimi i mbetjeve nga familjarët dhe nga të gjithë subjektet e tjerë, bëhet vetëm në vendet e mbledhjes së mbetjeve që ka caktuar Bashkia. Dorëzimi i tyre jashtë këtij rregulli, është shkelje dhe ndëshkohet si e tillë.

- *Neni 13*

Dorëzimi i mbetjeve teknologjike, ndërtimore, mbetjeve të zanatit, mbetjeve të vajrave lubrifikante, si dhe mbetje të tjera që nuk konsiderohen si mbetje urbane nga Ligji Nr.8094, datë 21.03.2000 “Për largimin publik të mbetjeve” dhe nga kjo rregullore, do të bëhet në pikat e veçanta të caktuara nga Bashkia për këtë qëllim.

- *Neni 14*

1-Mbetjet ndërtimore dorëzohen në vendet e caktuara nga Bashkia për këtë qëllim. Gjatë procesit të ndërtimit, riparimit apo prishjes, qytetarët, investitorët dhe subjektet ndërtuese, marrin masa për largimin e vazhdueshëm të mbetjeve ndërtimore.

2-Hedhja e mbetjeve ndërtimore në rrugë, në trotuare, në çdo mjedis publik, si dhe në pikat që ka caktuar Bashkia për mbetjet urbane, është e ndaluar dhe përbën shkelje që ndëshkohet si e tillë.

- *Neni 15*

Ndalohet dorëzimi i mbetjeve në vendet e zbuluara të hapësirave private, në trojet e sheshet, pronat e rikthyera, të rrethuara ose jo, në të cilat nuk ka filluar ndonjë veprimtari ndërtimore apo e çdo natyre tjetër. Pronarët e tyre janë të detyruar të kujdesen për mbajtjen pastër të tyre dhe të mos lejojnë kthimin e tyre në vende të depozitimit të mbetjeve.

- *Neni 16*

Kalimtarët, mbetjet e çastit si ambalazhe të ndryshme, i dorëzojnë vetëm në koshat e vendosur në qytet ose para dyqaneve. Ndalohet hedhja e tyre në rrugë, në trotuare apo në ambiente të tjera publike.

- *Neni 17*

Mbetjet që dalin nga krasitja e pemëve, e hardhive, nga punimet në oborre, në lulishte e parqe, para se të çohen në vendet e mbledhjes së këtyre mbetjeve, priten në pjesë të vogla e palosen për të mos bllokuar kazanët dhe vështirësuar transportin.

- *Neni 18*

1-Autoritetet e Bashkisë, në bashkëpunim me strukturat përkatëse rajonale si përfaqësuesit e inspektoriatit sanitar shtetëror të rrethit, përfaqësuesit e inspektoriatit të mbrojtjes së mjedisit dhe ata të ndërmarrjes/sipërmarrjes së pastrimit, përcaktojnë dhe publikojnë grafikun e pastrimit të rrugëve, shesheve dhe trotuareve.

2-Pastrimi i rrugëve, shesheve dhe trotuareve bëhet përgjithësisht një herë në 24 orë, herët në mëngjes ose në orët e mbrëmjes, kur është ulur ndjeshëm aktiviteti qytetar. Gjatë ditës, pastërtia sigurohet duke grumbulluar dhe larguar nga sheshet, rrugët e trotuaret, hedhurinat e ngurta të kalimtarëve si dhe ndotjet e tjera.

- *Neni 20*

1-Pastrimi dhe larja e rrugëve realizohet nga Bashkia, ose nga një palë e tretë e ngarkuar prej saj apo e kontraktuar për të kryer këtë shërbim. Në kontratë specifikohen të gjitha kushtet dhe kërkesat që ka Bashkia për pastrimin, kontrolli për zbatimin e tyre, si dhe sanksionet për shkelje të kushteve e kërkesave të kontratës.

2-Pastrimit i nënshtrohen të gjithë rrugët e asfaltuara, rrugët me kalldrëm, sheshet, si dhe trotuaret e qytetit dhe të qendrës së banuar.

- *Neni 21*

Bashkia përcakton rrugët dhe sheshet që duhet të lahen. Për larjen e rrugëve përdoren automjete të posaçme.

- *Neni 22*

1-Mbetjet që dalin nga pastrimi i rrugëve, trotuareve dhe shesheve hidhen në pikat më të afërta të grumbullimit të mbetjeve.

2-Ndalohet kategorikisht hedhja e mbetjeve që dalin nga pastrimi i rrugëve, trotuareve dhe shesheve në pusetat e elektrikut, në pusetat e telefonisë, në pusetat e ujësjellësit, në pusetat e ujërave të zeza, në pusetat e hidranteve, në zgarat e pusetave të ujërave atmosferike, në shtretërit e ujërave rrjedhëse, në basenet ujore natyrale apo artificiale.

- *Neni 23*

1-Çbllokimi dhe pastrimi i pusetave të rrugëve, bëhet vetëm nga punonjësit e subjektit të ngarkuar me administrimin e tyre.

2-Mbetjet e nxjerra nga pastrimi i pusetave largohen menjëherë nga subjekti përgjegjës dhe depozitohen në vendet e përcaktuara nga Bashkia.

- *Neni 25*

1-VMM-të ku vendosen kontenierët, kazanët apo stacionet e betonuara për grumbullimin e mbetjeve, caktohen nga Bashkia.

2-Këshilli Bashkiak, miraton dhe publikon skemën konkrete të vendndodhjes së VMM-ve dhe strukturën e përmasat e secilës. Ndryshimi i vendndodhjes së VMM-ve, pa miratim të bashkisë përbën shkelje dhe ndëshkohet si e tillë.

- *Neni 26*

1-Grumbullimi i mbetjeve urbane bëhet në kontenierë, dhe, në raste të veçanta, edhe në sheshe të betonuara për këtë qëllim.

2-Kontenierët lahen dhe dezinfektohen sipas grafikut të miratuar nga Bashkia. Kontenierët mbahen gjithmonë në kushte optimale pune nga subjekti që është angazhuar me administrimin e mbetjeve.

- *Neni 27*

1-Grumbullimi i mbetjeve që krijohen nga biznesi (i vogël, i mesëm, i madh), por që nuk përfshihen në kategorinë “mbetje të bizneseve” (si p.sh tallash, xham, etj.), bëhet me kontenierë privatë të vendosur brenda sipërfaqes ku kryhet aktiviteti. Kontenierët privatë duhet të kenë të njëjtët parametra si edhe ata publikë.

2-Të gjithë shitësat e tregut të prodhimeve bujqësore e blegtorale, mbetjet që krijojnë gjatë tregëtimit të produkteve vetjake, i grumbullojnë dhe i hedhin në pikat e përcaktuara nga Bashkia. Largimi nga tregu pa bërë këtë sistemim të mbetjeve, është shkelje që ndëshkohet me moslejimin për të tregtuar përsëri në treg.

- *Neni 28*

1-Djegia e mbetjeve në kazanë, rreth tyre dhe në çdo ambient tjetër, është kategorikisht e ndaluar dhe ndëshkohet si shkelje e rëndë sepse gazrat dhe tymrat e djegies rrezikojnë shëndetin e njeriut.

2-Ndalohet kullotja e kafshëve barngrënëse në mbetjet e kazanëve dhe në pikat e grumbullimit të tyre, si dhe marrja prej mbetjeve e ushqimeve për kafshët si mbetje buke, etj.

- *Neni 29*

Bashkia është përgjegjëse për detyrën e largimit të mbetjeve në zonën nën juridiksionin e saj.

- *Neni 31*

Transportimi i mbetjeve për në vendet e depozitimit bëhet nga Bashkia ose nga një palë e ngarkuar prej saj.

- *Neni 32*

Transportimi i mbetjeve nga pikat e grumbullimit për në vendet e depozitimit e të përpunimit të tyre, bëhet me kamionë të posaçëm dhe të mbuluar, ngarkesa e të cilëve nuk rrezikon derdhjen apo rishpërndarjen e mbetjeve.

- *Neni 60*

1-Tarifa e pastrimit vilet nga autoritetet e bashkisë për mbulimin e shpenzimeve të heqjes së mbetjeve dhe pastrimin e qytetit

2-Autoritetet e bashkisë mund të ngarkojnë një palë të tretë me përlogaritjen e këtyre tarifave, hartimin dhe dërgimin e njoftimeve për këto tarifa, marrjen dhe transferimin e tyre, lëshimin e vërtetimeve për autoritetet e bashkisë, përpunimin e të dhënave të kërkuara dhe vënien në dijeni të autoriteteve.

- *Neni 61*

Tarifat vilen për pastrimin e qytetit, për vënie në gjendje pune dhe për përdorimin e impianteve për largimin, transportin, depozitimin dhe përpunimin e mbetjeve.

- *Neni 62*

1-Niveli i tarifës përcaktohet me një vendim të veçantë të Këshillit Bashkiak.

2-Vendosja e tarifës së pastrimit, pagesa dhe vjelja e saj kryhen sipas vendimit të Këshillit Bashkiak për tarifën e pastrimit.

- *Neni 63*

Ndaj personave fizikë dhe juridikë që nuk respektojnë kërkesat e kësaj rregulloreje, zbatohen sanksionet e Ligjit Nr.8094, datë 21.3.1996, “Për largimin publik të mbetjeve”.

- *Neni 65*

-Çdo konsumator ka të drejtën e ankimit me gojë ose me shkrim mbi procesin e largimit publik të mbetjeve.

-Bashkia ka të drejtën të dërgojë një supervisor për të kontrolluar zgjidhjen e ankesës.

- *Neni 66*

Zbatimit të kësaj rregulloreje i nënshtrohen:

-Organet shtetërore dhe organizatat vendore.

-Gjithë individët, banorë të qytetit e të zonës, kalimtarë të rastësishëm, turistë e pushues, shtetas të huaj rezident në qytet, punonjës në organe e organizma publike e private.

-Gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari ekonomike, tregëtare, shoqërore, arsimore, kulturore, artistike, shëndetësore, turistike.

-Personat juridikë e fizikë, publikë dhe privatë, vendas apo të huaj, të angazhuar me kontratë dhe të licencuar për grumbullimin, depozitimin, transportimin, riciklimin, përpunimin dhe asgjësimin e mbetjeve.

## 2.4 Strukturat kombëtare mbështetëse

Përveç Ministrive të linjës, politika kombëtare për mbetjet ka përcaktuar me detaje ngritjen dhe miratimin e disa strukturave të përhershme, shtesë për të mundësuar zbatimin e plotë të politikës kombëtare të mbetjeve dhe të strategjisë nëpërmjet PKMM-së dhe të një serie të planeve të “Zonave të Mbetjeve”, si dhe planeve vendore. Strukturat e reja të propozuara janë:

- i. **Komiteti për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve (KMIM):** Ky komitet është një organ themelor në nivel qendror; ai përbëhet nga përfaqësues të qeverisë në nivel zv/ministrash nga secila ministri që lidhet drejtpërsëdrejti me sektorin e mjedisit;
- ii. **Grupi Kombëtar Këshillimor për Mbetjet (GKKM):** Është një entitet politik i përbërë nga përfaqësues në nivel kombëtar dhe rajonal, me kompetencë teknike në menaxhimin e mbetjeve. Përfaqësuesit mund të zgjidhen nga sektori publik dhe privat, me qëllim këshillimin e ministrave në aspekte të ndryshme të strategjisë së planifikimit të menaxhimit të mbetjeve, të politikës dhe të investimeve;
- iii. **Grupet e Zonave të Mbetjeve (GZM)** përbëhen nga përfaqësues në nivelin rajonal dhe vendor, që do të sigurojnë zhvillimin e planeve, të politikave dhe të projekteve në partneritet dhe me interes vendor për zbatimin e strategjisë dhe të politikës kombëtare të mbetjeve. Ky grupim do të ketë përgjegjësi rajonale për këshillimin e autoriteteve rajonale dhe vendore në çështjet e menaxhimit të mbetjeve dhe do të jetë përgjegjës për të siguruar që planet rajonale dhe vendore të ofrojnë qëndrueshmëri dhe të jenë efektive, eficiente dhe të mirëkoordinuara midis tyre dhe në përputhje me politikën kombëtare. Grupi i Zonave të Mbetjeve do të kryesohet nga një përfaqësues i Këshillit të Qarkut dhe mbështetja për sekretarinë, anën administrative dhe aktivitetet e grupit do të sigurohen nga Qarku. Anëtarët e Grupit të Zonave të Mbetjeve do të jenë ekspertë rajonalë për menaxhimin e mbetjeve, por do të ketë, gjithashtu, edhe përfaqësues nga sfera të tjera të interesit si nga autoritetet vendore dhe rajonale, kompanitë e mbetjeve apo industria e riciklimit, ekspertë lokalë të pavarur apo OJF-ë me eksperiencë për çështjet e mbetjeve.

## 3 Përshkrimi i karakteristikave të zonës

### 3.1 Shtrirja gjeografike

Bashkia e Dibrës shtrihet në veri-lindje të Shqipërisë, në koordinatat gjeografike 41° e 53' dhe 20° e 34', në një territor me sipërfaqe 937.88 km<sup>2</sup>. Peshkopia është qendra administrative dhe urbane e bashkisë dhe ndodhet në largësinë 44 km nga Lura, 36 km nga Kalaja e Dodës dhe 18 km nga pika kufitare e Bllatës. Këto zona janë skajet e këtij territori. Territori është rural në më shumë se 91% të sipërfaqes së tij.

Bashkia e Dibrës përbëhet nga një qytet (Peshkopia) dhe nga 141 fshatra, të cilat janë pjesë e 14 njësive administrative si: Lura, Zall-Reçi, Zall-Dardha, Selishta, Luzni, Muhurri, Arrasi, Fushë-Çidhna, Slllova, Kalaja e Dodës, Kastrioti, Tomini, Melani dhe Maqellara. Bashkia e Dibrës kufizohet me bashkinë e Kukësit në veri, me fshatrat e Matit dhe të Mirditës në jug, me fshatrat e Bulqizës në jug-lindje dhe me kufirin shtetëror të Maqedonisë në veri-lindje.

### 3.2 Relievi

Relievi i zonës është malor dhe dallohet për karakterin kompleks. Në përbërje të relievit gjejmë: kurrize malore, pllaja, gropa, fusha karstike si dhe malësi e lugina. Kjo malësi shtrihet nga 380 në 2751 m në skajin lindor. Mbizotërojnë malësitë mbi 700-900 m, që ulen gradualisht në drejtim të perëndimit. Në këtë malësi takohen tipa të relievit strukturor-eroziv, erozivo-dedunues, karstik, akullnajor. Territori i bashkisë Dibër, në masën 90%, është zonë rurale dhe vetëm 10% e këtij territori është zonë urbane, që shtrihet në qytetin e Peshkopisë. Zona rurale përfaqësohet nga 141 fshatra me një diversitet relievi nga fshatra malorë, kodrinorë dhe fushorë, kryesisht në luginën e Drinit të Zi. Territori i zonës është kryesisht malor me 55% të territorit, kodrinor rreth 30% e territorit dhe 15% i territorit është fushor.

### 3.3 Klima

Përsa i përket tipareve klimaterike, territori i Dibrës, që shtrihet në pjesën e brendshme të vendit, ka klimë mesdhetare kontinentale. Si pjesë e zonës malore, ky territor karakterizohet nga sasi reshjesh mbi mesataren vjetore të vendit. Ato shkojnë deri në 980 mm. Temperaturat më të larta të vërejtura arrijnë 25° - 30°C në korrik, ndërkohë që temperaturat minimale gjatë dimrit arrijnë deri në -20°C. Orët vjetore me diell variojnë nga 2.100 dhe 2.300. Korriku dhe, disa here, gushti janë muajt më të thatë, ndërsa dhjetori dhe janari muajt më të ftohtë.

### 3.4 Hidrografia


Sistemi ujqor në territorin e Dibrës përbëhet nga lumenj, përrenj, liqene dhe burime të tjera ujore. Lumi Drini i Zi përshkon gjithë territorin. Në të derdhen të gjithë përrenjtë, të cilët janë malorë me pjerrësi të lartë (>30%).

Midis pasurive të shumta vlejné për t'u përmendur edhe liqenet shumë të bukura të Lurës, burimi i Illxhave, si dhe disa burime të vogla në afërsi të qytetit. Pasuritë hidrike kanë ndihmuar jo pak në zhvillimin ekonomik të kësaj zone si në energji, ujitje, peshkim, industri, etj.



Sistemi ujqor përbëhet nga tërësia e burimeve nëntokësore dhe mbitokësore ujqore, si dhe përmban të gjithë trupat ujqorë, përfshirë brigjet, sipas përcaktimeve të legjislacionit të posaçëm. Gjithashtu, ka edhe një sërë rezervuaresh artificiale për nevoja ujqitjeje (6 rezervuarë).

**Harta 1: Rrjeti hidrografik i Bashkisë Dibër**



## 4 Përbërja administrative e njësive

### 4.1 Të dhëna të përgjithshme

Bashkia e Dibrës është një nga bashkitë e reja me territorin më të madh në rang vendi, me një sipërfaqe prej 937.88 km<sup>2</sup>.

Kjo bashki përbëhet nga 15 njësi administrative, të cilat janë: Peshkopi, Tomin, Melan, Kastriot, Lurë, Maqellarë, Muhurr, Luzni, Selishtë, Sllovë, Kala e Dodës, Zall-Dardhë, Zall-Reç, Fushë Çidhën dhe Arras. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Dibrës dhe qarkut të Dibrës. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 141 fshatra.

**Harta 2: Ndarja administrative e Bashkisë Dibrë**




### 4.2 Infrastruktura

Zona e Dibrës ka një akses shumë të vështirë infrastrukturor rrugor, që e lidh me portet, aeroportet dhe qendrat e mëdha industriale dhe tregtare. Rruga nacionale Tiranë-Dibrë (182 km), që e lidh

Dibrën me metropolin e vendit-Tiranën, portin e Durrësit dhe aeroportin “Nënë Tereza”, është më e keqja nga të gjitha rrugët në Shqipëri. Rrugët që lidhin Dibrën me pikën e Morinës (pika kufitare me Kosovën), 87 km e gjatë, dhe ajo që e lidh me Bllatën (pika kufitare me Maqedoninë) 18 km, janë në gjendje të pranueshme, por vlerësohen si me akses të vështirë, për shkak të terrenit malor dhe të gjeometrisë së rrugës.

Sistemi rrugor i zonës funksionale të Dibrës përbëhet nga një sistem rrugor prej 911 km, nga të cilat 145 km janë të asfaltuara dhe 766 km të paasfaltuara. Infrastruktura rrugore funksionon mbi bazën e tre kategorive kryesore rrugore, që janë: rrugë kombëtare gjithsej 109 km, nga të cilat 60 km janë të asfaltuara; rrugë rajonale gjithsej 72 km, ku vetëm 3 km janë të asfaltuara; dhe rrugë lokale të brendshme, që lidhin fshatrat dhe lagjet me njëra-tjetrën, gjithsej 730 km, nga të cilat 82 km të asfaltuara. Në figurën më poshtë jepen treguesit e sistemit rrugor.


**Grafiku 1: Gjendja e sistemit rrugor të Bashkisë Dibër**



**Burimi Strategjia e Territorit Dibër 2016**

Shumica e rrugëve janë të paasfaltuara, por edhe rrugët e asfaltuara, që përbëjnë 16% të infrastrukturës rrugore, lenë për të dëshiruar, sidomos pjesa e akseve të rrugës nacionale.

Harta 3: Rrjeti rrugor i Bashkisë Dibër



Dibra është bërë pjesë e planeve kombëtare për të qenë edhe ajo arterie e Korridorit të 8-të, me ndërtimin e Rrugës së Arbrit, si dhe të korridoreve të tjera energjetike. Në pjesën e brendshme, ajo përshkohet nga rruga Kukës-Peshkopi, e asfaltuar, pjesë e unazës rurale veriore, që e lidh me rrugën e Kombit dhe një sërë rrugësh rurale rajonale, si ajo e Lurës, që e lidh me Mirditën, rruga e Qafë-Murrës, që e lidh me Matin dhe pika kufitare e Bllatës, që e lidh me Maqedoninë.

### 4.3 Popullsia

Popullsia e zonës së Dibrës përbëhet nga 78.940 banorë, e shpërndarë kjo popullsi në qytetin e Peshkopisë dhe në 141 fshatra. Qyteti i Peshkopisë është qendra urbane e zonës së Dibrës dhe ka popullsinë më të lartë, ndërsa popullsia tjetër banon në zonën rurale të Maqellarës, Melanit, Tominit, Kastriotit, Fushë-Çidhës, Sllovës, Kalasë së Dodës, Reçit, Zall-Dardhës, Arrasit, Muhurrit, Luznisë, Selishtës dhe Lurës. Tabela e mëposhtme jep strukturën e popullsisë. Sipas Censurit të vitit

2011, bashkia e re ka një popullsi prej 61.619 banorësh, ndërkohë që sipas Regjistrit Civil, kjo bashki numëron 78.940 banorë.

**Tabela 2: Popullsia totale e Bashkisë Dibër**

Bashkia / Nj. Përbërëse		Total	Meshkuj	Femra	Dendësia (banorë/ km <sup>2</sup> )
Nr.	Gjithsej / Total	61,619	31,924	29,695	
	Në raport me totalin	100%	51.8%	48.2%	
1	ARRAS	3,055	1,576	1,479	71
2	FUSHË MUHUR	2,780	1,458	1,322	165
3	FUSHË ÇIDHËN	2,909	1,508	1,401	57
4	KALA E DODËS	2,252	1,171	1,081	36
5	KASTRIOT	6,200	3,295	2,905	117
6	LURË	1,096	557	539	11
7	LUZNI	2,433	1,225	1,208	73
8	MAQELLARË	10,662	5,540	5,122	135
9	MELAN	3,649	1,922	1,727	62
10	PESHKOPI	13,251	6,800	6,451	1,018
11	QENDËR TOMIN	7,590	3,883	3,707	20
12	SELISHTË	1,605	843	762	37
13	SLLOVË	2,405	1,235	1,170	128
14	ZALL DARDHË	1,051	553	498	25
15	ZALL REÇ	681	358	323	25

**Burimi: Census 2011**

Dendësia mesatare e popullsisë në zonën e Dibrës është 78.2 banorë/km<sup>2</sup>, një shifër shumë më e ulët se niveli kombëtar, 148 banorë/km<sup>2</sup>. Kjo shifër varion nga 270 banorë/km<sup>2</sup> për zonat fushore në 50 banorë/km<sup>2</sup> për zonat malore. Dendësinë më të madhe e ka qyteti i Peshkopisë me 1.008 banorë/km<sup>2</sup> dhe përbën 25% të popullsisë së zonës, ndërsa dendësinë më të ulët e ka zona malore e Zall-Dardhës, Reçit dhe Lurës, me shifra që variojnë nga 11 - 24 banorë/km<sup>2</sup>. Shifra e popullsisë urbane ka qenë pak a shumë e qëndrueshme gjatë periudhës 2002 - 2013. Aktualisht popullsia urbane përbën 25% të totalit të popullsisë. Ndërsa, sipas vlerësimit dhe raportimeve të bëra nga gjendja civile në Janar të 2014-ës (sipas Bashkisë së Re Dibër), gjendja e popullsisë paraqitet kështu:

**Tabela 3: Popullsia e Bashkisë Dibër**

NR	Emërtimi i njësisë administrative	Numri i popullsisë (Gjendja Civile)	Numri i familjeve (Gjendja Civile)	M	F
1	Peshkopi	19179	5175	9809	9370
2	Maqellarë	13730	3496	7048	6682
3	Tomin	8519	2235	4382	4137
4	Melan	4389	1124	2255	2134
5	Kastriot	7348	2046	3817	3531
6	Sillovë	3103	965	1574	1529
7	Muhurr	3466	1028	1814	1652
8	Fushë-Cidhen	3554	1023	1873	1681
9	Arras	3775	1145	1924	1851
10	Kala e Dodës	3025	837	1588	1437
11	Selishtë	1974	569	1024	950
12	Luzni	3171	935	1618	1553
13	Zall-Reç	2401	714	1254	1147
14	Zall-Dardhë				
15	Lurë	1463	493	725	738
	TOTALI	79 097	21 785	40 705	38 392


**Burimi: Gjendja Civile 2014**

#### 4.3.1 Shpërndarja e popullsisë

Popullsia dominuese e zonës është ajo rurale, ndërsa pjesa e përket asaj urbane shumica është e përqëndruar në qytetin e Peshkopisë. Ashtu siç u shprehëm edhe më lart, popullsia si rurale edhe urbane ka pësuar rënie gjatë dy dekadave të fundit. Aktualisht, popullsia urbane përbën 25 % të totalit të popullsisë dhe ajo rurale 75%.

Shifra e popullsisë urbane ka qenë pak a shumë e qëndrueshme gjatë 2002-2013. Kjo zonë është karakterizuar nga një lëvizje e popullsisë rurale drejt qytetit të Peshkopisë, ndërsa ajo urbane drejt Tiranës dhe Durrësit. Ky fenomen ka qenë më i theksuar gjatë viteve 2001 -2006, ku shpopullimi ka qenë masiv, ndërsa më pas ritmet kanë rënë edhe pse migrimi i brendshëm pritet të jetë një nga faktorët determinant në përcaktimin e morfologjisë demografike të zonës për vitet në vijim.

Harta 4: Densiteti i popullsisë (Bashkia Dibër)



#### 4.4 Arsimi

Sistemi publik arsimor parauniversitar përfshin rreth nëntë shkolla të mesme, 41 shkolla 9-vjeçare dhe 69 kopshte, të shtrira në të 15-të njësitë administrative. Gjatë vitit mësimor 2014-2015 numri i nxënësve në arsimin parauniversitar ishte 14.462 nxënës.

Sipas statistikave, tregohet se rreth 2.6 % e popullsisë janë analfabetë, 0.6% dinë shkrim dhe këndim dhe 1.7% janë pa diplomë. Arsimi bazë ka numrin më të lartë të regjistrimeve, ndoshta edhe pse është arsim i detyrueshëm me 70% të popullsisë, arsimi i mesëm rreth 20% dhe vetëm 4.3% ndjekin arsimin e lartë dhe më tej.

Komunat Arras, Luzni, Fushë Çidhën, Zall Dardhë dhe Zall Reç kanë normat më të larta të analfabetëve. Komunat Kala e Dodës, Luzni dhe Selishtë kanë përqindjen më të ulët të ndjekësve të shkollës së mesme. Përjashtim bën qyteti i Peshkopisë, ku ndjekin arsimin e lartë 11.3% e popullsisë banuese.

Gjatë dhjetë viteve të fundit, sistemi arsimor në përgjithësi dhe shkollat në veçanti, kanë qenë objekt i reformave ristrukturuese. Por, një problem serioz mbetet braktisja e arsimit të detyruar 9-vjeçar. Përqindja e grupmoshës që duhet të ndjekë arsimin nëntëvjeçar është ulur në 95 %. Më serioze paraqitet gjendja e fëmijëve, të cilët nuk regjistrohen në shkollë. Ky problem është më i ndjeshëm në zonat e karakterizuara nga lëvizje të fuqishme migratore, si Reçi, Zall-Dardha, Lura, Selishta, Luznia, Sllova dhe Kalaja e Dodës.

Një problem tjetër me rëndësi, përsa i përket çështjes së arsimit është se pjesa më e madhe e shkollave 9-vjeçare, rreth 90% e tyre, ndodhen në zonat rurale. Konkretisht, në vitin 2013/14, nga 97

shkolla të arsimit 9-vjeçar, 86 ishin në zonat rurale dhe vetëm 11 ishin në zonat urbane. Edhe numri i të regjistruarve dhe i të diplomuarve në zonat rurale është më i lartë se në zonat urbane.

**Tabela 4: Niveli i arsimit në Bashkinë Dibër**

Nr	Bashkia/Njësi Administrative	% e analfabetizmit	Fillore	E mesme	E lartë dhe më tej	Mesatarja e viteve të shkollimit
1	ARRAS	4,5%	72,3%	18,3%	3,3%	9,0
2	FUSHË ÇIDHËN	4,4%	72,6%	19,4%	2,5%	9,1
3	KALA E DODËS	2,6%	85,3%	7,6%	1,2%	8,4
4	KASTRIOT	3,3%	70,3%	22,0%	3,1%	9,2
5	LURË	1,6%	71,7%	22,7%	2,9%	9,5
6	LUZNI	5,2%	80,1%	11,3%	1,6%	8,6
7	MAQELLARË	2,1%	77,3%	17,0%	2,8%	9,1
8	MELAN	3,7%	75,4%	16,9%	2,2%	8,7
9	MUHURR	3,0%	69,2%	22,1%	4,2%	9,3
10	PESHKOPI	1,6%	45,7%	38,7%	12,9%	11,2
11	QENDËR TOMIN	2,7%	72,4%	20,5%	3,0%	9,3
12	SELISHTË	3,4%	83,6%	10,7%	1,6%	8,8
13	SLLOVË	3,2%	70,5%	22,4%	2,7%	9,3
14	ZALL DARDHË	3,1%	68,3%	22,8%	3,8%	9,3
15	ZALL REÇ	5,2%	78,7%	13,6%	1,3%	8,6

**Burimi: Census 2011**

#### 4.5 Strehimi

Strehimi në Dibër është kryesisht privat. Numri total i banesave nuk është i regjistruar, por vlerësohet të jetë tek 11.000 shtëpi në zonën rurale dhe 3.250 shtëpi në zonën urbane, vlerësim i bërë nga zyra për planifikimin e urbanistikës në bashki.


Në qytetin e Peshkopisë, ku vlerësohet se janë 3.250 shtëpi banimi, në çdo shtëpi jetojnë afro 1.5 familje. Numri i shtëpive është më i vogël se numri i familjeve, për shkak të kushteve ekonomike dhe të pamundësisë së njerëzve për të blerë një shtëpi. Mbizotërojnë shtëpitë individuale një katëshe. Këto banesa, kryesisht, banohen nga 5 ose më shumë anëtarë.

#### 4.6 Bizneset dhe kategoritë e tyre

Numri i bizneseve aktive në zonën funksionale të Dibrës për vitin 2014 ishte 1.381. Këto biznese janë përqëndruar, kryesisht, në qytetin e Peshkopisë (1.018). Në zonat rurale, numri më i lartë i bizneseve vërehet në zonën e Maqellarës, me 180 biznese, dhe shumë më pak në zonat e Zall-Dardhës, Reçit dhe të Luznisë, me 3 biznese. Këto biznese janë me karakter familjar, 21 prej tyre, dhe kryesisht kanë nga 1 deri në 3 persona të punësuar. Tregtia, transporti, baret dhe hotelet zënë numrin më të madh të aktiviteteve. Grafiku më poshtë jep numrin e bizneseve jobujqësore.



Grafiku 2: Kategoritë e bizneseve të Bashkisë Dibër



Burimi: Strategjia e Territorit Dibër 2016

Ndërsa në tabelën e mëposhtme tregohet numri i shpërndarjes së bizneseve sipas njësive administrative.

Tabela 5: Shpërndarja e bizneseve sipas njësive (Bashkia Dibër)

Nr	Emërtimi i njësisë administrative	Numri i bizneseve (Burimi QKR)	Distanca nga Qendra (km)
1	Peshkopi	1.018	
2	Maqellarë	180	15,7
3	Tomin	45	1,7
4	Melan	27	2,2
5	Kastriot	36	7,1
6	Sllovë	7	22,9
7	Muhurr	17	11,8
8	Fushë-Çidhën	7	12,4
9	Arras	16	22
10	Kala e Dodës	5	33,7
11	Selishtë	8	25
12	Luzni	3	11
13	Zall -Reç	5	43,7
14	Zall-Dardhë	0	32,9
15	Lurë	7	47
	TOTALI	1.381	

Zona e Dibrës nuk shquhet për pasuri të shumta minerare dhe, prandaj, sektori më i rëndësishëm ekonomik është ai i shërbimeve, më pas vijnë me rradhë tregtia, transporti, ndërtimi.


**Tabela 6: Shpërndarja e detajuar e bizneseve në Bashkinë Dibër**

NjQV	Tot.	Bujq.	Rest.& Hot.	Min.	Ind. Përpn	Ndërt.	Qira	Shërb.	Transp.	Treg.
Peshkopi	888	7	174	4	56	24	37	60	135	391
Maqellarë	172	1	28	1	17	4	7	12	33	69
Tomin	42	2	6	-	2	4	1	1	12	14
Kastriot	34	3	2	-	2	-	-	-	19	8
Melan	26	-	4	-	1	1	1	-	9	10
Arras	16	1	2	2	-	-	-	1	6	4
Muhurr	15	1	-	1	2	4	1	-	4	2
Fushë Çidhën	7	-	-	-	-	1	-	-	2	4
Selishte	7	-	-	1	-	1	-	-	4	1
Slllove	7	1	-	-	-	1	-	-	4	1
Kala e Dodës	5	2	-	-	-	-	-	-	2	1
Zall Reç	5	-	-	-	-	1	-	-	3	1
Lurë	4	1	-	2	-	-	-	-	1	-
Luzni	3	-	-	-	-	-	-	-	3	-
Zall Dardhë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>Totali</b>	<b>1.231</b>	<b>19</b>	<b>216</b>	<b>11</b>	<b>80</b>	<b>41</b>	<b>47</b>	<b>74</b>	<b>237</b>	<b>506</b>

**Burimi: Analiza e Territorit, Ministria e Zhvillimit Urban**

Siç shihet dhe nga tabela, numri më i madh i bizneseve është i përqëndruar në njësitë vendore më të mëdha, si në Peshkopi (74%) dhe Maqellarë (13%). Ndërsa, në njësitë e tjera vendore bizneset janë shumë të vogla, ku në komunat e Zall-Dardhës nuk kemi asnjë biznes të rregjistruar, ndërsa në 7 komuna nuk kalohet numri i dhjete bizneseve të rregjistruara, dhe këto janë kryesisht njësitë vendore më malore dhe më të largëta me Peshkopinë.

**Harta 5: Shpërndarja e bizneseve në Bashkinë Dibër**



Zona e Dibrës ka disa biznese, që janë të grumbulluara sipas llojit të produktit dhe pozicionit gjeografik, por duket se nuk ka një ndërveprim të strukturuar mes tyre. Më tipike janë bizneset e përqëndruara në turizmin kurativ të Llixhave të Peshkopisë, ku bashkia ka në zotërim kompleksin balnear ku menaxhon burimin ujor, ambjentet e kompleksit, shërbimin mjekësor dhe promovon këtë biznes të përqëndruar në një ndërmarrje ekonomike të bashkisë. Bizneset turistike që ushtrojnë aktivitetin e tyre në këtë zonë paguajnë tarifën për ujin dhe lehtësirat e tjera që afrohen nga qendra balneare, e cila është në funksion të tyre.

Karakteristikë kryesore e bujqësisë në Dibër është që ekonomitë janë të organizuara në bazë familje. Si ekonomitë e vogla, ashtu dhe ato ekonomi që janë pak më të mëdha apo më të strukturuar, kanë vështirësi aksesit në tregun e gjerë të prodhimeve bujqësore.

Pjesa më e madhe e prodhimit bujqësor destinohet për nevojat e vetë familjeve dhe pjesa tjetër për tregun lokal në Peshkopi dhe tregun kombëtar, kryesisht në Tiranë. Sasia e prodhimit për treg është e vogël. Familjet mendojnë më shumë për nevojat e tyre familjare se sa për tregun.

Blegtoria është një sektor prioritar dhe jetik për zhvillimin e zonës rurale dhe të ekonomisë në zonën e Dibrës. Blegtoria luan një rol të rëndësishëm dhe, kryesisht, mbarështrrohet për qumësht, mish dhe këto vite edhe për lesh. Ka një tendencë vitet e fundit për mbarështrimin e bletarisë dhe të pularive.

#### 4.7 Institucionet

Përsa i përket Bashkisë së Dibrës, numri më i madh i institucioneve ndodhen në qytetin e Peshkopisë, ku është edhe qendra e kësaj Bashkie.

**Tabela 7: Shpërndarja e Institucioneve (Bashkia Dibër)**

Nr.	Emri i Institucionit	Qyteti ku ndodhet
1	Qendra Kombëtare e Biznesit	Peshkopi
2	Agjencia e Legalizimeve, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale	Peshkopi
3	Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit	Peshkopi
4	Drejtorja e Përgjithshme e Përmbarimit	Peshkopi
5	Drejtorja e Përgjithshme e Taksave	Peshkopi
6	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor	Peshkopi
7	Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme	Peshkopi
8	Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile	Në të gjitha njësitë (përveç Tomin, Zall Reç)

#### 4.8 Lëvizjet dhe tendencat demografike


Gjatë dekadës së fundit, situata demografike në zonën e Dibrës ka ndjekur të njëjtën tendencë me zonat e tjera në veri dhe në veri-lindje të vendit. Ajo është karakterizuar nga një lëvizje e përgjithshme e popullsisë drej qendrave metropolitane dhe urbane të rajoneve të tjera dhe migracionit brenda zonës funksionale, kryesisht në qytetin e Peshkopisë. Bazuar në analizën e zhvillimeve demografike dhe hapësinore, Dibra si bashki paraqet karakteristikat e mëposhtme:

Zona e Dibrës ka normën më të lartë të migrimit të brendshëm të popullsisë (norma bruto 11,2 % në 2014) drejt qendrave urbane të vendit dhe emigrimit ndërkombëtar. Kjo zonë ka një popullsi relativisht të re dhe kjo është një nga arsytet që vazhdon të përjetojë lëvizje të popullsisë nga pjesët me më pak mundësi ekonomike, në veri, drejt bregut perëndimor, e veçanërisht në pjesën qendrore Tiranë dhe Durrës. Ky fenomen parashikohet të ketë pasoja të dukshme për zhvillimin e zonës, pasi bashkë me lëvizjen demografike, lëvizin dhe kapitalet financiare e ato njerëzore, duke krijuar kështu zona të boshatisura.

Karakteristikat gjeografike (relievi i thyer dhe largësia mes qendrave të banuara) ndikojnë në lidhjet e zonave periferike, që janë kryesisht malore, me qendrën administrative dhe shërbimet bazë, duke paraqitur në këtë mënyrë sfida të rëndësishme socio-ekonomike dhe administrative.


Mes viteve 1990 dhe 2013 popullsia është ulur deri në 25% (në varësi të metodës së matjes). Migrimi më i lartë, me 11%, ka ndodhur gjatë viteve 2004-2006. Që nga viti 2006 ndryshimi i numrit të popullsisë është më i vogël, përkatësisht 2,1% dhe 1,6% për periudhat 2006-2008 dhe 2008-2013.

**Grafik 3: Tendanca e popullsisë 2001 - 2011 (Bashkia Dibër)**



Burimi: Analiza e Territorit, Ministria e Zhvillimit Urban

**Grafik 4: Ndryshimi i popullsisë (Bashkia Dibër)**



Burimi: Analiza e Territorit, Ministria e Zhvillimit Urban

Tendencat e lëvizjeve të fundit kanë qenë të pranishme pothuajse në të gjitha njësitë administrative, konkretisht sipas grafikut të mësipërm, në Zall Reç popullsia është përgjysmuar gjatë periudhës 1989-2001 (-50,9%) dhe ka vijuar më tej shpopullimi me ritme akoma më të larta gjatë dekadës pasardhëse 2001-2011 (-65%). Në total, kjo komunë ka humbur rreth 83% të popullsisë në vetëm 22 vjet. Një situatë e ngjashme vihet re edhe në Zall Dardhë me -76%, Lurë -78,2%, Selishtë -67,7%, Slllovë -61%, dhe Kala e Dodës -58,2%, gjatë të njëjtës periudhë 1989-2011.

Sipas hipotezave të skenarëve të mundshëm, projeksionet demografike sugjerojnë një reduktim të vazhdueshëm të numrit të popullsisë, pothuajse me 30%, si pasojë e migrimit të popullsisë, pa marrë parasysh koeficientin e vdekshmërisë. Ky reduktim do të sjellë pasojë të dukshme ekonomike dhe sociale të zones, ku një nga rreziqet më të mëdha do të jetë largimi i popullsisë totale në zonat malore, si pasojë e migrimit drejt metropoleve ku ka më shumë kapitale dhe burime financiare.

## 5 Të dhënat ekonomike

### 5.1 Sektorët Ekonomikë

Dibra është zonë agrare, me potenciale turistike balneare dhe rurale. Për nga kushtet e zhvillimit ekonomik, zona e Dibrës është e pozicionuar në zonat e fundit (58%) në krahasim me GDP-në mesatare kombëtare (indeksuar në 100). GDP-ja për zonën e Dibrës është 177.111 lekë për frymë, kurse në nivel kombëtar ajo është 305.229 lekë. Sektorët që kontribuojnë më shumë janë bujqësia, pylltaria, turizmi, ndërtimi, minierat dhe hidroenergji.

Dibra është një zonë ku dallohen qartazi ekonomia e zonës rurale dhe ekonomia e zonës urbane. Ekonomia e zonës urbane bazohet kryesisht në sektorin e shërbimeve, të tregtisë, të hoteleri-turizmit, të përpunimit dhe të ndërtimtarisë. Ndërsa zona rurale ka karakter të qartë bujqësor. Ajo bazohet në ekonominë familjare të fermave të vogla bujqësore dhe blegtorale, me një tendencë në rritje. Gjithashtu, bazohet edhe në disa shërbime bazë dhe biznese tregtare (më e përqëndruar dhe e dalluar kjo gjë është në zonën e Maqellarës). Këto vitet e fundit ka një fillim të investimeve në përpunimin e produkteve bujqësore, kryesisht të qumështit (rreth 19 baxho), të frutave (punishte për lëngje frutash, pijesh alkoolike, kompostosh/reçeli, të jufkave, etj). Shumica e këtyre bizneseve në sektorin bujqësor, janë me bazë familjare.


Treguesit makroekonomik për Dibrën nuk janë shumë premtues. Ajo renditet në vendet e fundit sa i takon të ardhurave për person, nivelit të punësimit, etj. Si një tregues negativ për zhvillimin ekonomik në zonën e Dibrës, mund të jetë mungesa e investimeve të huaja, të cilat kanë pasur interes vetëm për pasuritë natyrore të gipseve, kromit dhe hidro-energjisë, por akoma nuk kemi ndonjë investim të huaj në zonë. Investimet e mëdha në zonën e Dibrës janë kryesisht në sektorin e energjisë, me investime vendase dhe të huaja. Janë 4 HEC-e të ndërtuar në Lurë dhe 2 HEC-e në ndërtim në komunën Selishtë dhe Muhurr.

### 5.2 Punësimi dhe Papunësia

Zona e Dibrës ka një popullsi të aftë për punë në një tregues moshe të barabartë me 66% të popullsisë së përgjithshme në zonë. Për periudhën 2002-2014, treguesi i popullsisë së aftë për punë ka qenë mjaft i qëndrueshëm (norma e rritjes 46%). Përqindja e popullsisë së aftë për punë në zonat urbane është 45% dhe në ato rurale, 52.5%.

Struktura e punësimit mbështetet në sektorin e bujqësisë, në sektorin privat dhe në sektorin publik. Bujqësia dhe sektori privat janë sektorët kryesorë që kanë mbajtur peshën e punësimit në vitet e fundit, duke vazhduar të dominojnë ende. Të dhënat tregojnë se numrin më të lartë të të punësuarve e kemi në sektorin bujqësor (58.6%) dhe në sektorin privat jobujqësor (24%), ndërsa punësimi në sektorin shtetëror është 17.4% në periudhën 2014. Struktura gjinore e krahut të punës, e matur kjo në vitin 2014, përbëhet nga 13% femra dhe 87% meshkuj. Dëshmi kjo e një çekuilibri gjinor në punësim.

**Grafik 5: Sektorët e punësimit në Bashkinë Dibër**



**Burimi: Strategjia e Territorit Dibër 2016**

Papunësia, sipas statistikave zyrtare të vitit 1999, kap shifrën 16% të popullsisë në moshë pune. Por, papunësia në të vërtetë mund të kapë shifra më të larta, 35-40% të popullsisë, vetëm se deri tani nuk kemi tregues të matshëm. Sipas censusit të fundit (Census 2011) mendohet se 17.963 persona janë të punësuar dhe kjo shifër përbën 35% të fuqisë së aftë për punë. Pjesa tjetër mendohet të jetë e vetëpunësuar në sektorin bujqësor (58.6%). Ndërkohë që, papunësia është më tepër fenomen urban dhe reflektohet në treguesit e papunësisë së regjistruar në zyrat e punës, nëpunësimi (*underemployment*) është fenomen rural. Në zonat urbane të qytetit të Peshkopisë mendohet se papunësia kap shifrën 42%, duke qenë kështu më e lartë se niveli mesatar kombëtar. Papunësia është më tepër e pranishme tek të rinjtë, ku mbi 60% e tyre janë nën moshën 34 vjeç.

Grupet e rrezikuara dhe varfëria në Dibër nuk identifikohen vetëm tek të papunët, apo tek familjet që jetojnë në varfëri ekonomike. Ato përfaqësohen, gjithashtu, edhe nga kategori, të cilat janë të përjashtuara nga të drejtat themelore për të patur një banesë, ushqim të mjaftueshëm, ngrohje dhe veshje në dimër, punë në përputhje me aftësitë fizike dhe nivelin arsimor, shkollë afër shtëpisë dhe mundësi për ta ndjekur atë, shërbim primar shëndetësor, mbrotje nga grabitja dhe dhuna, të drejta dhe zë për të kërkuar të drejtat. Në Dibër jetojnë nën nivelin zyrtar të varfërisë, rreth 4.859 familje dhe trajtohen me ndihmë ekonomike rreth 25% e familjeve që jetojnë në këtë territor.

Përqindja e familjeve që mbështeten me të ardhura të pjesshme nga ndihma ekonomike është më e lartë në zonat rurale, duke shkuar deri në 45-55% të popullsisë. Programi i mbështetjes së familjes me të ardhura (ndihma ekonomike), për shkak të pagesave tepër të ulëta, nuk i ndihmon familjet të dalin nga varfëria.



**Tabela 8: Gjendja e punësimit dhe e papunësisë (Bashkia Dibër)**

	Tot.	Pa dipl.	Fillore	9 vjeç.	E mesme e përgjith.	E mesme profes.	Univer.	Nuk kanë ndjekur asnjëherë shkollën
Të punësuar								
Gjithsej	25 749	77	1 054	12 655	5 206	3 176	3 433	148
Meshkuj	16 907	49	719	8 536	3 687	2 061	1 759	96
Femra	8 842	28	335	4 119	1 519	1 115	1 674	52
Të papunësuar								
Gjithsej	13 522	39	485	7 552	3 549	1 003	668	226
Meshkuj	8 772	29	334	5 037	2 257	659	296	160
Femra	4 750	10	151	2 515	1 292	344	372	66

**Burimi: Census 2011**

## 6 Financat Vendore

### 6.1 Buxheti i Bashkisë Dibër

Të ardhurat kapitale përfshijnë fondet e disponueshme për investime kapitale në çdo vit. Bashkia Dibër ka të ardhura prej afërsisht 500 milion lekësh për vitin 2016. Vihet re që ky buxhet është dyfishuar, krahasuar me vitin 2014 (me vlerën më të lartë 308 milion, llogaritur për të 15-të ish-NJQV-të) dhe vitin 2013 (afërsisht 302 milion lekë).

Për vitin 2016, për investimet ishte parashikuar afërsisht një buxhet prej 200 milion lekësh (nga të ardhurat totale të bashkisë), pa llogaritur këtu donacionet dhe investimet nga palë të tjera.

Më poshtë janë listuar disa nga burimet që përbëjnë buxhetin kapital të bashkisë Dibër:

1. Buxheti i transferuar nga qeveria qendrore (e pakushtëzuar), që për vitin 2016 është afërsisht 315 milion lekë.
2. Transferta e kushtëzuar nga qeveria qendrore është një tjetër burim i financimit të investimeve kapitale (për vitin 2016 është afërsisht 185 milion lekë).
3. Treguesit e realizimit të të ardhurave nga taksat/tarifave vendore. Bazuar në të dhënat e grumbulluara për nivelin e grumbullimit të taksave dhe të tarifave për bashkinë Peshkopi dhe ish-komunat, niveli i parashikuar i të ardhurave nga ky zë buxheti mund të jetë rreth 100 milion lekë.
4. Në të ardhurat lokale kapitale, ku përfshihen të ardhurat që vijnë vetëm një herë dhe të cilat krijohen p.sh. nga shitja e një ndërtese në pronësi të bashkisë, por që nuk nevojitet për përdorim publik, apo nga dhënia me qera e një objekti apo aseti të vet bashkisë me qëllim përdorimin për interesa publike, bashkia Dibër nuk parashikon të ketë të ardhura lokale kapitale për vetë inventarin e pronave që ajo disponon.
5. Aktualisht, bashkia Dibër nuk ka filluar të krijojë një fond rezervë kapitali, i cili të mund të përdoret për zëvendësimin e ndonjë pajisjeje kapitale në kohën kur kjo pajisje vjetërohet, ose për investime të tjera kapitale.
6. Përdorimi i huasë: Aktualisht, Bashkitë mund të marrin hua dhe kuadri ligjor është miratuar tashmë.
7. Grante nga donatorët. Këtu janë parashikuar të ardhurat që bashkia siguron nga donatorët, duke identifikuar qartë donatorin, fondin, kërkesat e tij dhe vitin e përdorimit.

**Tabela 9: Buxheti sipas NJQV-ve/Njësive administrative (Bashkia Dibër)**

Totali	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Të ardhurat	Investimet	% mbi totalin e buxhetit	% e të ardhurave mbi totalin e buxhetit
	295	300	194	88	0	100%	45.4%
Peshkopi	100	102	107	55.8	-	55%	52%
Maqellarë	32	33	15	3.7	-	8%	25%
Tomin	23	23	10	4.5	-	5%	45%
Kastriot	19	19	8	4.7	-	4%	59%

Melan	15	16	7	2.5	-	4%	36%
Silovë	13	13	6	0.5	-	3%	8%
Lurë	13	13	6	0.4	-	3%	7%
Arras	13	13	6	3	-	3%	50%
Kala e Dodës	12	12	5	2.1	-	3%	42%
Muhurr	12	12	5	0.8	-	3%	16%
Selishtë	11	12	5	1.9	-	3%	38%
Fushë Çidhën	10	10	4	3.1	-	2%	78%
Luzni	10	10	4	0.4	-	2%	10%
Zall Dardhë	6	6	3	1.8	-	2%	60%
Zall Reç	6	6	3	2.9	-	2%	97%

**Burimi: Analiza e Territorit, Ministria e Zhvillimit Urban**

## 7 Plani operacional për afatin kohor 2017 – 2022

### 7.1 Situata aktuale

#### 7.1.1 Metodologjia

Metodologjia e planifikimit, e bazuar në performance, përcakton se si duhet të drejtohet ky vlerësim bazë dhe çfarë informacioni nevojitet për t'u prezantuar. Elementët kryesorë janë paraqitur më poshtë.

- 1) Informacioni i përgjithshëm, i cili përfshin:
  - Popullsinë, vendbanimet, zonat e shërbimit, gjenerimin e mbetjeve, gjeografinë, infrastrukturën rrugore, ekonominë, konsumin, sektorin e biznesit, gjeneruesit e tjerë të mbetjeve, tipologjitë e mbetjeve të gjeneruara (urbane, minerare, të rrezikshme, etj).
  - Infrastrukturën e ofrimit të shërbimit aktual (llojet e kamionëve dhe të kontenierëve, venddepozitimin dhe objektet e tjera).
  - Ofrimin e shërbimeve (publike/private), frekuencën e grumbullimit.
  - Personelin (shërbimi i mbetjeve dhe i pastrimit).
  - Gjendjen e zonave të venddepozitimit të mbetjeve dhe operacionet.
  - Objektet e riciklimit, në qoftë se ka ndonjë objekt zyrtar dhe veprimtaritë e tjera, si për shembull grumbulluesit e mbetjeve.
  
- 2) Informacioni financiar, i cili përfshin:
  - Buxhetin total të Bashkisë
  - Buxhetin total të Bashkisë të përcaktuar për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta
  - Koston për banorë
  - Tipologjinë e tarifave
  - Kapacitetin e rikuperimit të koston (mbledhja e tarifës) në përqindje
  - Pagesën e tarifës (ekv. banorë / vit)

Informacioni i grumbulluar në fund të kësaj faze vlerësimi duhet të lejojë krijimin e performancës bazë, nëpërmjet një grupi treguesish të propozuar.

## 7.2 Informacion i përgjithshëm

### 7.2.1 Popullsia, vendbanimet, zona e shërbimit, gjenerimi i mbetjeve

Kjo pjesë mundëson informacion të gjendjes aktuale të mbulimit me shërbim të zonës. Informacioni i detajuar, përsa i përket popullsisë dhe karakteristikave të Bashkisë, është shpjeguar në kapitullin e parë të këtij dokumenti.

Tabela e mëposhtme tregon gjendjen aktuale të ofrimit të shërbimit dhe aksesin në të gjithë Bashkinë Dibër:


**Tabela 10: Aksesueshmëria në ofrimin e shërbimeve për grumbullimin e mbetjeve të ngurta**

Njësia Administrative	Popullsia Census 2014	Nr. Bizneseve	Distanca nga Peshkopia (km)	Aksesi rrugor	Mbulimi aktual me shërbim	Sasia e vlerësuar e mbetjeve të gjeneruara për të gjithë zonën, përfshirë edhe fshatrat e paaksesueshëm (në ditë)
<b>PESHKOPI</b>	19,179	1,018	0	Plotësisht i aksesueshëm me përjashtim të disa rrugëve të ngushta në qytet	Mbuluar plotësisht	13.4
<b>MAQELLARË</b>	13,730	180	15.7	Shumica e zonës e aksesueshme me përjashtim të disa fshatrave (shih hartën më poshtë)	Shërbim i mundësuar në qendër të fshatit	6.9
<b>TOMIN</b>	8,519	45	1.7	Shumica e zonës e aksesueshme me përjashtim të disa fshatrave (shih hartën më poshtë)	Shërbim i mundësuar në disa zona rreth qytetit	4.3
<b>MELAN</b>	4,389	27	2.2	Pjesërisht i aksesueshëm me përjashtim të disa fshatrave (shih hartën më poshtë)	Shërbim i mundësuar në qendër të fshatit	1.8
<b>KASTRIOT</b>	7,348	36	7.1	Të aksesueshëm fshatrat kryesorë (shih	Pa shërbim	2.9

				hartën më poshtë)		
<b>SLLOVË</b>	3,103	7	22.9	Të aksesueshëm fshatrat kryesore (shih hartën më poshtë)	Pa shërbim	0.9
<b>MUHURR</b>	3,466	17	11.8	Akses vetëm në rrugën kryesore (shih hartën më poshtë)	Pa shërbim	1.0
<b>FUSHË CIDHËN</b>	3,554	7	12.4	Akses vetëm në rrugën kryesore (shih hartën më poshtë)	Pa shërbim	1.1
<b>ARRAS</b>	3,775	16	22	Pa akses (shih hartën më poshtë)	Pa shërbim	1.1
<b>KALA E DODËS</b>	3,025	5	33.7	Akses vetëm në rrugën kryesore (shih hartën më poshtë)	Pa shërbim	0.6
<b>SELISHTË</b>	1,974	8	25	Pjesërisht i aksesueshëm vetëm në rrugën kryesore (shih hartën më poshtë)	Pa shërbim	0.4
<b>LUZNI</b>	3,171	3	11	Pa akses (shih hartën më poshtë)	Pa shërbim	1.0
<b>ZALL-REÇ</b>	2,401	5	43.7	Pa akses (shih hartën më poshtë)	Pa shërbim	0.5
<b>ZALL-DARDHË</b>	0	0	32.9	Pa akses (shih hartën më poshtë)	Pa shërbim	0.0
<b>LURË</b>	1,463	7	47	Pa akses (shih hartën më poshtë)	Pa shërbim	0.3
<i>Totali</i>	<i>79,097</i>	<i>1,381</i>				<i>~36</i>

Situata e aksesueshmërisë pritet të përmirësohet, pasi po ndërmerren zhvillime të shumta si për shembull ura e re Fushë-Çidhën – Arras dhe Zall Reç, e cila lidh dy anët e lumit. Zhvillime të mëtejshme pritet të ndodhin gjatë vitit 2017-2018 në përmirësimin e infrastrukturës rrugore, si për shembull rruga ndërmjet Fushë-Çidhën dhe Kastriotit dhe rruga lidhëse e fshatrave të Muhurrit me Arrasin. Zhvillime të tilla do të përmirësojnë performancën e grumbullimit të mbetjeve dhe do të mundësojnë aksesin edhe në zonat më të izoluar të Bashkisë.

Harta 6: Situata e aksesueshmërisë së fshatrave bazuar në aksesin me rrugë të asfaltuara



### 7.2.2 Zhvillimi i sektorit të biznesit

Njësia me aktivitetin më të madh ekonomik është Peshkopia, e cila ka dhe numrin më të madh të bizneseve; ndjekur nga Maqellara, e cila ka toka të shumta produktive për bujqësi; nga Tomini që është njësia që rrethon qytetin dhe nga Kastrioti, për shkak të pozitës gjeografike dhe afërsisë me qytetin. Njësitë e tjera kanë një numër të kufizuar të bizneseve, si për shembull zonat e largëta që tregohen në hartë. Kryesisht, bizneset janë gjenerues të mëdhenj mbetjesh, me një normë prej 6-15 kg/ditë, megjithatë për shkak të kushteve të varfëra ekonomike në këtë rajon, aktiviteti i bizneseve është i kufizuar. Në përgjithësi, mbizotërojnë bizneset e vogla, ashtu siç tregohet edhe në tabelën e mëposhtme.

Bizneset e vogla	Bizneset e mëdha	Institucionet
746	67	36

Harta 7: Shpërndarja e bizneseve



### 7.2.3 Gjenerimi i mbetjeve urbane

Sasia e mbetjeve të gjeneruara për ekuivalent banorë në vit varion nga 0,6 - 0,8 kg për qytetin në më pak se 0,4 kg/ditë/eqv. banorë për zonat rurale Maqellarë dhe Tomin. Matjet e kryera nga Bashkia për grumbullimin e mbetjeve në ditë tregojnë një sasi më të madhe të mbetjeve të gjeneruara, por



një investigim i mëtejshëm tregoi se kontenierët ishin përdorur për hedhjen e mbetjeve nga krasitjet e pemëve, gjë e cila ndikon në sasi më të madhe mbetjesh. Në këtë aspekt, vlerat fikse për qëllim planifikimi do të jenë si më poshtë:

**Tabela 11: Mbetjet urbane të gjeneruara për çdo Njësi Administrative (Dhjetor 2016, matjet dhe vlerësimet nga vrojtimi)**

Njësia Administrative	Sasia e gjeneruar e mbetjeve kg/banorë/ditë ekv.
Peshkopi (qyteti)	0,7
Tomin	0,5
Maqellarë	0,5
Melan	0,4
Kastriot	0,4
Luzni, Muhurr, Arras, Fushë-Çidhën, Slllovë	0,3
Selishtë, Kala e Dodës, Zall Reç, Zall Dardhë	0,2

#### 7.2.4 Lloje të tjera të mbetjeve të gjeneruara

Deri më tani nuk ka të dhëna dhe nuk mund të grumbullohet një informacion i saktë për llojet e tjera të mbetjeve. Për të kuptuar më mirë këtë situatë, pas vitit të parë të zbatimit të skemës së re do të bëhen matjet dhe do të zbatohen politikat e duhura për venddepozitimet e paligjshme. Nëpërmjet mbështetjes, nga struktura e zgjeruar e menaxhimit të mbetjeve do të grumbullohet informacion për mbetjet e gjeneruara dhe llojet e tyre.

Gjithashtu, do të merren në konsideratë studime të tjera të kryera për qytete të ngjashme. Tabela e mëposhtme jep një pasqyrë të situatës në qytetet e Bashkisë së Vorës dhe Fushë – Krujës.

Megjithatë, niveli i varfërisë në Dibër është më i lartë se njësitë e përzgjedhura dhe, për këtë arsye, sasia e mbetjeve organike do të jetë më e lartë.


**Tabela 12: Projektioni i përbërjes së mbetjeve për Bashkinë Dibër (në %)**

Kategoria e mbetjeve	Vorë	F. Krujë	Dibër
Organike	51.7	52.3	>52.0
Letër-karton	9.9	10.1	10.0
Plastikë	10.6	11.5	11.1
Qelq	4.7	5.0	4.9
Tekstile	5.4	4.6	5.0
Metale	1.2	1.6	1.4
Inerte (ndërtime)	6.2	7.2	6.7
Spitalore	3.3	2.5	2.9
Të tjera	7	5.0	6.0

Duke marrë në konsideratë informacionin për qytetin e Peshkopisë, vetëm sasi të mbetjeve të dhëna më poshtë do të merren parasysh për këtë njësi.

Tabela 13: Sasia e përbërjes së mbetjeve për Peshkopinë në kg

Kategoria e mbetjeve	Gjenerimi ditor i mbetjeve	Peshkopia (ditë)	Peshkopia (Vit)
Organike	13000	6760	>2467400
Letër-karton		1300	474500
Plastikë		1443	526695
Qelq		637	232505
Tekstile		650	237250
Metale		182	66430
Inerte (ndërtim)		871	317915
Spitalore		377	137605
Të tjera		780	284700




Pas vitit të parë të zbatimit të skemës së re, do të grumbullohet një informacion më i saktë për sasi të dhe përbërjen e mbetjeve, i cili do të ndihmojë në përmirësimin e sistemit aktual të menaxhimit të mbetjeve drejt një sistemi më të integruar.

### 7.2.5 Ofrimi i shërbimit, frekuenca e grumbullimit

Deri në vitin 2016, shërbimi ishte i mundur nga ndërmarrja publike për qytetin e Peshkopisë dhe për një pjesë të Njesisë Administrative të Tomin, që është më afër qytetit. Me bashkimin në Bashki më të madhe, shërbimi u zgjerua më tej në njësitë Maqellarë dhe Melan dhe vetëm në disa fshatra kryesorë të njësive të tjera. Shërbimi mundësohet nga vetë Bashkia dhe kryhet çdo ditë ose një herë në 2 ditë, në varësi të nevojave. Megjithatë, operacionet nuk janë të rregulluara siç duhet, pasi rregullat janë vendosur duke u bazuar në nevojat e menjëhershme.

Harta 8: Shtrirja e shërbimit deri në Mars 2017



### 7.2.6 Infrastruktura e ofrimit të shërbimit aktual

Tabela e mëposhtme mundëson një pasqyrë të plotë për infrastrukturën e grumbullimit dhe të trajtimit të mbetjeve në Bashkinë e re të Dibrës, deri para hyrjes në fuqi të këtij plani.

OBJEKTI	PËRSHKRIMI	GJENDJA E FUNKSIONIMIT
<b>1. Objektet për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve</b>	<i>Kamioni kompaktor 10t (Steiner)</i>	<i>1 përdorur por në gjendje pune.</i>
	<i>Kamionë të hapur lart (Benz). 2 mjete, një për qytetin dhe një për njësitë e tjera.</i>	<i>Të dy janë shumë të përdorur.</i>
	<i>Traktori në venddepozitimin e Peshkopisë</i>	<i>1 vjetër por në gjendje të mirë.</i>
	<i>Buldozeri në venddepozitimin e Peshkopisë, për nxjerrjen dhe heqjen e mbetjeve voluminoze të ngurta.</i>	<i>1 vjetër dhe jo shumë i mirëmbajtur, por në gjendje pune.</i>

<b>2. Kontenierët 1.1m<sup>3</sup></b>	140 kontenierë në Peshkopi dhe 15 në Njësinë Maqellarë.	Shumë të përdorur. Në gjendje jo shumë të mirë.
<b>3. Kosha ditor 70 kg</b>	50 copë aktualisht në magazinë	Të rinj dhe të papërdorur.
<b>4. Objekti i magazinimit dhe i parkimit</b>	Një objekt i vjetër përdoret për mirëmbajtjen e rrugëve. Ky objekt përdoret aktualisht nga një pjesë e stafit për zyra dhe pjesa tjetër për parkimin e kamionëve.	Ndërtesa është shumë e vjetër dhe është planifikuar të rikonstruktohet dhe të përdoret për të gjitha shërbimet e Bashkisë, duke përfshirë mirëmbajtjen e duhur për infrastrukturën e re të menaxhimit të mbetjeve.



Mjeti i hapur lart dhe kontenierët në qytet




Një kontenier i dëmtuar në Maqellarë



Përmbajtja e një kontenieri në qytet, i cili është përdorur edhe për mbetjet nga krasitjet e pemëve

### 7.2.7 Personeli

Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2016 sektori i menaxhimit të mbetjeve u riorganizua dhe u përmirësua me një drejtori shërbimesh dhe një sektor për menaxhimin e mbetjeve, të cilat janë përshkruar në diagramën e mëposhtme. Kjo përfaqëson një hap të rëndësishëm të bërë kundrejt shërbimeve më të mira në një Bashki më të madhe, duke rritur kështu qëndrueshmërinë institucionale të shërbimit në aspektin e burimeve njerëzore dhe të ndarjes së buxhetit. Sektori ka një numër total të stafit të angazhuar në zyrë dhe në terren me rreth 43 punonjës, të cilët përfaqësojnë një raport prej 2.15 punonjës për 1.000 banorë.



Sektori nuk ka asnjë rregullore për përshkrimin e punës së stafit dhe nuk ka një sistem për mbikëqyrjen sasiore dhe cilësore të shërbimit. Drejtuesi i sektorit është specialisti më i kualifikuar, me një qëndrim të gjatë në zyrë dhe me trajnime komplekse për ngritjen e kapaciteteve, duke krijuar kështu një burim të vlefshëm që do të ndihmojë në avancimin e menaxhimit të mbetjeve brenda Bashkisë.

## 7.2.8 Gjendja e zonave të depozitimit të mbetjeve dhe operacionet

### **Venddepozitimi i Peshkopisë**

Venddepozitimi i Peshkopisë është projektuar të mbajë mbetjet urbane nga qyteti dhe fshatrat përreth për 25 vjet, llogaritje këto të bëra në 2003-in, atëherë kur edhe është ndërtuar kjo zonë. Zona drejtohet nga Bashkia Peshkopi dhe përdoret nga dy komuna të tjera (Melan dhe Tomini), bazuar në një marrëveshje ndërmjet këtyre NjQV-ve. Pas reformës së re territoriale, zona drejtohet nga Bashkia Dibër, e cila përbëhet nga 15 Njësi Administrative. Zona është e vetmja që ka një leje për përdorim. Megjithatë, kjo zonë nuk ka standardet e duhura dhe nuk funksionon siç duhet. Aktualisht, sasia e mbetjeve që depozitohet në zonë nuk rregjistrohet dhe nuk ka të punësuar asnjë punonjës në objekt. Në bazë të llogaritjeve të përafërta, sasia e mbetjeve që shkon në venddepozitim nga qyteti i Peshkopisë është 6-8 t/ditë, ndërkohë që nga njësitë e tjera nuk mund të identifikohet sasia, pasi ato depozitohen nga mjete të tjera që nuk janë pronë e Bashkisë. Një traktor punon në zonë për të ngjeshur dhe miksuar mbetjet me tokën. Megjithatë, traktori nuk operon në zonë në bazë të një plani të mirëfilltë operacional. Për këtë arsye, në zonë është formuar një kodër mbetjesh, ndërkohë që gjysma tjetër e saj është pothuajse bosh. Në këtë situatë, nuk mund të futet menaxhimi i duhur me qeliza. Zona kërkon shumë punë përmirësuese, përpara se të futet menaxhimi i duhur i mbetjeve. Për shkak të masave të pakontrolluara, zona është e hapur dhe në të mund të futen kafshë ose gjatë verës të ndizen zjarre.





*Venddepozitimi Peshkopi*

*Diga e venddepozitimit të Peshkopisë*

### **Venddepozitimi Maqellarë**

Kjo zonë është përdorur nga ish komuna. Pretendohet që zona të ketë një leje operationale, por jo një leje mjedisore. Zona nuk është mbajtur siç duhet dhe nuk ka kushtet më të nevojshme për mbrojtjen e mjedisit.

### **7.2.9 Objektet e riciklimit, nëse ka ndonjë objekt zyrtar dhe veprimtaritë e tjera, si për shembull grumbulluesit e mbetjeve.**

Nuk ka asnjë aktivitet riciklimi në Bashkinë Dibër.

## **7.3 Aspektet financiare**

Informacioni financiar është mjaft i vështirë për t'u kuptuar, për shkak të bashkimit të ish komunave në një Bashki të re dhe, për këtë arsye, ka boshllëqe në informacione të rëndësishme dhe mungesë besueshmërie në këtë informacion. Burimi kryesor dhe, që është dhe më i besueshmi, është buxheti i Njesisë Administrative të Peshkopisë ku ekzistojnë evidencat, por nuk janë të mirëmbajtuara apo të organizuara. Prandaj, evidencat e mëposhtme janë ato ku është mundësuar shërbimi i menaxhimit të mbetjeve (Peshkopi, Maqellarë dhe Melan).

### **7.3.1 Buxheti total i Bashkisë**

Tabela e mëposhtme mundëson evidenca nga buxheti i Njesisë Administrative të Peshkopisë përpara reformës territoriale dhe buxhetin e Bashkisë së madhe Dibër për vitin 2016 si viti i parë buxhetor.

Tabela 14: Varianca e buxhetit total të Bashkisë ndër vite

Viti	Bashkia Peshkopi (sot NJQV Peshkopi)						Bashkia Dibër (e madhe)	
	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Buxheti total i Bashkisë Peshkopi	410.449.000	275.326.000	352.369.000	445.430.000	196.612.598	314.000.338	648.779.436	596.125.324

Kjo luhatje e buxhetit ka të bëjë me faktin se funksionet e deleguara mundësojnë fonde shtesë për shërbimet e tjera të deleguara nga qeveria qendrore dhe në vitin 2015-të buxheti është bashkuar me njësitë e tjera, duke formuar Bashkinë e re.


### 7.3.2 Buxheti i përgjithshëm i Bashkisë për shërbimet e menaxhimit të mbetjeve të ngurta

Tabela e mëposhtme jep informacion për shumën e shpenzimeve për menaxhimin e mbetjeve në Bashkinë Peshkopi (deri në vitin 2015) dhe më pas në Bashkinë Dibër. Të dhënat tregojnë shpenzime shumë të ulëta për këtë sektor, pasi shërbimi është shumë bazik dhe nuk mbulon të gjithë territorin. Planifikimi është bazuar në buxhetin në dispozicion dhe nuk është bazuar në nevojat në përputhje me ligjin. Për këtë arsye, shpenzimet janë më pak sesa duhet të ishin. Zakonisht, Bashkitë shpenzojnë 5 - 20% të buxhetit për një shërbim të duhur.

Tabela 15: Përqindja e buxhetit për menaxhimin e mbetjeve në vite

Viti	Bashkia Peshkopi (sot NJQV Peshkopi)						Bashkia Bashki (e madhe)	
	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Buxheti total për mbetjet	26.650.000	19.052.000	26.407.000	19.928.000	18.272.900	17.700.000	14.573.966	22.798.955
% për menaxhimin e mbetjeve	6%	7%	7%	4%	9%	6%	2%	4%

Grafiku 6: Përqindja e buxhetit për menaxhimin e mbetjeve në vite



### 7.3.3 Shpenzimet bazuar në ekv. kosto për banor

Vlerësimi bazohet në faktin që shërbimi para dhe pas bashkimit në Bashkinë e madhe i është ofruar pothuajse të njëjtit numër popullsie. Tabela e mëposhtme jep shifra mbi koston për popullsinë që merr shërbim dhe, duke supozuar, që kontribuojnë duke paguar 100% për shtrirjen e shërbimit në 2017.

**Tabela 16: Shërbimi i mbetjeve ekv. kosto për banor / vit (në Lek)**

Viti	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Kosto shërbimi	26,650,000	19,052,000	26,407,000	19,928,000	18,272,900	17,700,000	14,573,966	22,798,955
Nr. i popullsisë me shërbim	20,000	20,000	20,000	20,000	20,000	20,000	20,000	20,000
Popullsia totale për NJQV e re	NA	NA	NA	NA	NA	NA	79,000	79,000
<b>Kosto për banorë (me shërbim)</b>	<b>1332</b>	<b>953</b>	<b>1320</b>	<b>996</b>	<b>914</b>	<b>885</b>	<b>729</b>	<b>1140</b>
<b>Kosto për banorë (të gjithë)</b>	<b>NA</b>	<b>NA</b>	<b>NA</b>	<b>NA</b>	<b>NA</b>	<b>NA</b>	<b>184</b>	<b>289</b>

### 7.3.4 Tipologjia e tarifave

Bashkia aplikon një metodë të thjeshtë për vendosjen e tarifave, e cila nuk është e bazuar në një sistem apo rregullore. Për këtë arsye, tarifat vendosen nga stafi dhe miratohen nga Këshilli. Tarifat vendosen për familjet, bizneset dhe institucionet. Zyra e taksave kryen llogaritjet dhe dërgon për aprovim tarifat në Këshill. Sektori për menaxhimin e mbetjeve nuk merr pjesë në vendosjen e tarifës.

Tarifa vendoset për këto kategori: 1) Familjet, përfshirë edhe ato me ndihmë ekonomike; 2) Bizneset (e vogla dhe të mëdha); 3) Institucionet.

Shpërndarja tipike e tarifës ndërmjet familjeve, bizneseve dhe institucioneve është 40/60%.



### 7.3.5 Kapaciteti i mbulimit të koston (mbledhja e tarifës) në përqindje

Meqënëse buxheti zhvillohet nga sektori për menaxhimin e mbetjeve dhe tarifa menaxhohet nga zyra e taksave dhe e tarifave, nuk ka një sistem të duhur për të kuptuar këtë tregues. Tabelat dhe grafikët e mëposhtëm prezantojnë në detaje situatën për periudhën 2011 – 2016. Tarifa është vendosur për banorët e qytetit të Peshkopisë, ku është ofruar shërbim deri në vitin 2016-të, përpara zgjerimit të shërbimit. Në llogaritjet e buxhetit ka një ndryshim pas reformës territoriale të vitit 2015-të, ku të gjitha bizneset e të 15 Njësi Administrative menaxhohen si një dhe tarifat janë vendosur vetëm për tre Njësi (Tomin, Maqellarë dhe Melan).



**Tabela 17: Tarifa mbulon koston (në Lek)**

	2015	2016
Shpenzimet për shërbimin	14.573.966	22.798.955
Shuma e faturuar	11.398.600	18.906.739
% mbulon koston	78%	83%

Shifrat tregojnë vetëm planifikimin për mbulimin e tarifës dhe jo normën e mbledhjes. Ato tregojnë që Bashkia nuk planifikon mbulim të plotë shërbimi nga tarifa. Boshllëku prej 20% do të mbulohet nga fondet e buxhetit të Bashkisë. Megjithatë, boshllëku faktik në grumbullim është shumë i lartë dhe sasia e mbuluar nga Bashkia është 40-50%.


**Tabela 18: Vlerësimi kompleks i tarifës së faturuar, të grumbulluar dhe mospërputhja për periudhën 2011-2016 (në 000 Lek)**

	2011			2012			2013			2014			2015			2016			Mesatare
	Faturuar	Mbledhur	Rap.	Faturuar	Mbledhur	Rap.	Faturuar	Mbledhur	Rap.	Faturuar	Mbledhur	Rap.	Faturuar	Mbledhur	Rap.	Faturuar	Mbledhur	Rap.	
<i>Familjet</i>	3600	1680	47%	4100	1805	44%	4200	1780	42%	1100	964	88%	5786	1029	18%	6451	1105	17%	43%
<i>Bizneset dhe institucionet</i>	6190	4520	73%	6310	4955	79%	6250	5120	82%	5900	5839	99%	5613	5153	92%	12455	9796	79%	84%
<i>Të kombinuar (fakt)</i>	9790	6200	63%	10410	6760	65%	10450	6900	66%	7000	6803	97%	11399	6182	54%	18906	10901	58%	67%
<i>Kostot vjetore të shërbimit</i>	26,407,000			19,928,000			18,272,900			17,700,000			14,573,966			22,798,955			
<i>Boshllëku në faturim për familjet me referencë bazë vitin 2013</i>	14%			2%			0%			74%									
<i>Përlogaritur (Familjet e faturuara si në vitin 2013)</i>	3600	1680	47%	4100	1805	44%	4200	1780	42%	4200	964	23%	5786	1029	18%	6451	1105	17%	32%
<i>Të kombinuar me projektim</i>	55%			54%			54%			60%			36%			37%			50%

Tabela e mësipërme tregon një normë mesatare grumbullimi, rreth 50%, nga të tre kategoritë e klientëve, ku kontribuesit më të mëdhenj janë bizneset dhe institucionet. Megjithatë, në përqindje, duket një performancë më e mirë për vitin 2014, ky vit ka qenë më negativ për grumbullimin e tarifës nga familjet, që më vonë u rregullua duke shkuar 23%. Bashkia mbulon pjesën tjetër të shpenzimeve nëpërmjet buxhetit të transferuar nga qeveria.


### 7.3.6 Tarifa e paguar (ekv. banorë / vit)

**Grafiku 7: Ndryshimet në grumbullimin e tarifës për periudhën 2011-2016**




Grafiku tregon një “përmirësim” të rëndësishëm në grumbullim për vitin 2014, të cilat edhe të përshtatura, janë akoma në nivele jorealiste, duke treguar një planifikim jo të mirë në mbledhjen e tarifës. Gjithashtu, një reduktim i madh në grumbullimin e tarifës në vitin 2015 dhe 2016 ka ndodhur sepse Bashkia është bërë më e madhe dhe tre Njësitë (ish komuna) janë pjesë e sistemit të menaxhimit të tarifës (Maqellarë, Melan dhe Tomin), ku grumbullimi është thujse 0%.

**Grafiku 8: Ndryshimet në grumbullimin e tarifës për familjet për periudhën 2011-2016**



Grumbullimi i tarifës nga familjet mbetet pjesa më e dobët e sistemit të menaxhimit të tarifës. Nuk ka një sistem për grumbullimin dhe zbatimin e tarifës. Qytetarët paguajnë vetëm kur kërkojnë shërbime të tjera nga Bashkia. Shumica e paguesve të tarifës janë familjet, të cilat janë pjesë e skemës së ndihmës ekonomike, ku tarifa iu mbahet në shumën e ndihmës ekonomike.

**Grafiku 9: Ndryshimet në grumbullimin e tarifës për bizneset dhe institucionet për periudhën 2011-2016**



Grumbullimi i tarifës për bizneset dhe institucionet është menaxhuar më mirë, pasi zbatimi i pagesës së tarifës për biznesin është më i rregullt. Grumbullimi mesatar i tarifës është 75%. Rritja e lartë e grumbullimit të tarifës në 2014 lidhet me planifikimin jo të mirë për vitin dhe prandaj ka një nivel shumë të ulët të besueshmërisë.

## 7.4 Niveli i performancës

Sipas grumbullimit të të dhënave dhe vlerësimeve të bëra nga ekipi i ekspertëve, Bashkia Dibër i ka treguesit e performancës si më poshtë:

Tabela 19: Situata aktuale e performancës për Bashkinë Dibër (viti 2016)

Kategoria Nr.	Treguesi	Aktuale	Saktësia e të dhënave Ulët/Mesatar/Lartë	
Cilësia e shërbimit	C1	<b>Zonat e mbuluara me shërbim grumbullimi</b>		
		<i>C1.1 Mbulimi me shërbim i zonave urbane dhe periferike</i>	80%	Mesatar
		<i>C1.2 Mbulimi me shërbim i zonave të largëta</i>	0%	Ulët
	C2	<b>Pastërtia e qytetit</b>	80%	Mesatar
C3	<b>Perceptimi publik: shkalla e kënaqësisë</b>	87%	Lartë	
Qëndrueshmëria mjedisore	D1	<b>Shkalla e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve</b>	0%	Lartë
	D2	<b>Mbrojtja e burimeve natyrore: shkalla e trajtimit të mbetjeve në landfill inxhinierik ose në zona të depozitimit të kontrolluara dhe të aprovuara</b>	0%	Lartë
Qëndrueshmëria Financ.&Instit.	E1	<b>Mbulimi i kostos: Tarifa mbulon koston</b>	75%	Mesatar
	E2	<b>Sa kontribuojnë qytetarët në financimin e shërbimit: shkalla e mbledhjes së tarifës</b>	50%	Mesatar
	E3	<b>Transparenca e sistemit të faturimit</b>	Ulët	Lartë
<b>Kosto e shërbimit</b>	<b>~5,250 Lek / t    1,140 Lek / banorë / vit</b>			

Treguesit e mësipërm janë matur duke u bazuar në një metodologji, e cila është shpjeguar me detaje në shtojcën 09 të këtij plani.

### 7.4.1 1.1 Kuptimi i vlerave të treguesve

**Treguesi C1.1.** Ky tregues mundëson vetëm të dhëna për mbulimin me shërbim të qytetit të Peshkopisë dhe të një pjese të njësisë Tomin, e cila është përreth qytetit dhe ku mundësohet shërbimi. Shifra është vendosur 80%, duke konsideruar një mbulim 100% të qytetit dhe pjesë të Tomin ku vetëm disa lagje ose fshatra, si Dohoshishti, përfshihen në skemën e grumbullimit të mbetjeve. Niveli i saktësisë së treguesit është mesatar, pasi matjet janë kryer për sasinë e transportuar të mbetjeve nga kamioni, në vjeshtë të 2016-ës.

**Treguesi C1.2.** Ky tregues i referohet sasisë së mbetjeve të grumbulluara nga zonat e largëta të Bashkisë. Siç është përshkruar në të dhënat demografike, të paktën 5 Njësi konsiderohen si zona të largëta (Kala e Dodës, Zall-Dardhë, Zall-Reç, Lurë dhe Selishtë) dhe pothuajse të gjitha të tjerat një pjesë të njësive e kanë të shtrirë në zona të izoluara malore si Arras, Muhurr, Sllovë, Fushë Çidhën, Kastriot, Tomini dhe Melan. Në këto zona nuk ofrohet shërbim dhe për këtë arsye treguesi qëndron 0% për 2016-ën. Niveli i saktësisë së treguesit është i lartë.

**Treguesi C2.** Ky tregues është i lidhur me pastërtinë e zonave urbane, ku në Dibër është i lidhur vetëm me qytetin e Peshkopisë. Si një tregues i vëzhguar, në bazë të raporteve të kompanive publike, qyteti konsiderohet i pastër, por duke marrë në konsideratë cilësinë e përgjithshme të shërbimit dhe amortizimin e objekteve, niveli i treguesit mbetet 80% për vitin 2016. Niveli i saktësisë së treguesit është mesatar, pasi nuk ka asnjë sistem raportimi në vend.

**Treguesi C3:** Ky tregues lidhet me perceptimin public, i cili është mbledhur nëpërmjet pyetësorëve që u janë shpërndarë 300 qytetarëve në qytetin e Peshkopisë gjatë pranverës së 2016-ës, të pyetur **mbi kënaqësinë e tyre ndaj shërbimit të përgjithshëm**. Sipas përgjigjeve të mbledhura, rreth 87% e banorëve të Peshkopisë janë të kënaqur dhe, gjithashtu, të gatshëm për të paguar për një shërbim më të mirë. Niveli i saktësisë së treguesit është i lartë, pasi numri i pyetësorëve është 300.

**Treguesi D1:** Ky tregues lidhet me sasinë e mbetjeve, e cila ndahet në burim dhe dërgohet për material riciklimi ose forma të tjera trajtimi. Me përjashtim të disa aktiviteteve shumë sporadike, të cilat nuk janë zyrtare, nuk ka ndarje të mbetjeve në burim as të vëzhguar dhe as të raportuar. Për më tepër, nuk ka aktivitete jo zyrtare të grupeve të marxhualizuara si në qytetet e tjera në vend, të cilët mund të merreshin në konsideratë për këtë tregues. Prandaj, niveli i ndarjes së mbetjeve në burim qëndron 0% për qytetin. Megjithatë, ka aktivitete si për shembull në njësinë Kastriot, ku është futur aktiviteti i ndarjes së mbetjeve organike, por që rezultatet në tregues do të përdoren për vitin 2017. Nuk ka një informacion të konfirmuar që familjet në zonat rurale nuk i përziejnë mbetjet e kuzhinës me mbetjet e tjera, por nuk merret parasysh për 2016-ën, pasi nuk është mundur akoma shërbimi në këto zona. Niveli i saktësisë së treguesit nuk është i rëndësishëm, edhe pse konsiderohet i lartë.

**Treguesi D2:** Ky tregues lidhet me trajtimin e mbetjeve të grumbulluara. Ka vetëm një mënyrë trajtimi në Bashkinë Dibër, e cila është depozitimi direkt i mbetjeve të grumbulluara. Një venddepozitim ndodhet 2 km larg qytetit dhe nuk ka asnjë aktivitet tjetër trajtimi për mbetjet në zonë. Prandaj, niveli i treguesit mbetet **0%**, pasi nuk ka masa për parandalimin e ndotjes deri për vitin 2016. Niveli i saktësisë së treguesit nuk është i rëndësishëm, edhe pse konsiderohet i lartë.

**Treguesi E1:** Treguesi lidhet me llogaritjen e tarifës përkundrejt kostos që nevojitet për të mbuluar të gjithë shërbimin. Ky tregues është i vjetër për vitin 2016, pasi kostot janë llogaritur në bazë të fakteve të vitit paraardhës dhe bazuar në sistemin ekzistues, i cili është shumë i amortizuar. Bazuar në shifrat për tarifën e faturuar, vlera për dy vitet e fundit është 75%. Niveli i saktësisë së treguesit nuk është i rëndësishëm, edhe pse konsiderohet i lartë.

**Treguesi E2:** Treguesi llogarit sasinë e të ardhurave përkundrejt kostos totale. Bazuar në shifrat ekzistuese, sasia e të ardhurave nga grumbullimi mesatar i tarifës për 5 vitet e fundit është rreth **50%** dhe pjesa e mbetur mbulohet nga burimet e tjera. Niveli i saktësisë së treguesit nuk është i rëndësishëm, edhe pse konsiderohet mesatar.

**Treguesi E3:** Ky tregues lidhet me ekzistencën e një sistemi faturimi për klientët. Normalisht, nuk ka një sistem të vendosur për faturimin e klientëve. Nuk ka sisteme për këtë shërbim, por në disa qytete, përfshirja e shërbimit të pastrimit në shërbimin e ujësjellësit përbën një sistem faturimi. Me

mbështetjen e sistemit të *dldp* është zhvilluar vendosja e tarifës dhe e faturimit. E vetmja njësi në Bashkinë Dibër, që mbulohet me shërbim, është Peshkopia dhe nuk ekziston asnjë nga sistemet e përmendura më lart. Prandaj, treguesi qëndron i ulët dhe saktësia e lartë.

## 8 Planifikimi për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve në nivel vendor

### 8.1 Vizioni i planit

***“Qytetarët e Bashkisë së Dibrës respektojnë mjedisin e tyre dhe përfitojnë nga menaxhimi i duhur i mbetjeve për një të ardhme si një zonë turistike me potenciale të mëdha.”***

### 8.2 Qëllimi i planit

***“Ofrimi i shërbimeve të zgjeruara për menaxhimin e mbetjeve dhe rritja e ndërgjegjësimit publik për një Bashki të pastër dhe tërheqëse.”***

### 8.3 Objektivat specifike të planit

- **SO1:** Shërbimet për grumbullimin e mbetjeve do të mbulojnë 50% të Bashkisë në vitin 2017-të dhe, deri në vitin 2020-të, do të shtrihet në të gjithë Bashkinë e Dibrës;
- **SO2:** Qytetarët e Bashkisë japin mbështetje maksimale për shtrirjen e shërbimeve dhe do të kontribuojnë me të paktën 60% me anë të tarifës;
- **SO3:** Qyteti i Peshkopisë shndërrohet në njësinë kryesore të Bashkisë së Dibrës përsa i përket grumbullimit dhe ndarjes së mbetjeve në të ardhmen;
- **SO4:** Gjatë vitit 2017-të, venddepozitimi i Bashkisë Dibër kthehet në një venddepozitim të kontrolluar dhe në gjendje për të përballuar shtrirjen e mëtejshme të shërbimeve të reja;
- **SO5:** Deri në 2022-ën, Bashkia e Dibrës rehabiliton shumicën e zonave të ndotura (venddepozitimet e paligjshme).

### 8.4 Rrymat e mbetjeve që janë objekt i këtij plani

Në bazë të legjislationit ekzistues, plani do të përqëndrohet kryesisht në mbetjet urbane, për të cilat Bashkia e Dibrës është drejtpërdrejtë ose pjesërisht përgjegjëse.

Bazuar në përbërjen dhe në metodën e menaxhimit të mbetjeve, mbetjet do të klasifikohen në:

- Mbetje urbane (mbetjet shtëpiake, ushqimet, bimët, të riciklueshme ose të dekompozueshme, etj.);
- Mbetje urbane të veçanta (mbetjet inerte nga ndërtimet, mbetjet nga orenditë shtëpiake, pajisjet elektrike dhe ato shtëpiake, etj.) Këto mbetje gjenerohen nga familjet ose subjektet tregtare;
- Mbetjet e rrezikshme të gjeneruara brenda territorit të Bashkisë nga ana e banorëve të përhershëm ose të përkohshëm.

### 8.5 Zbatimi i hierarkisë së menaxhimit të mbetjeve

Neni 4 i Direktivës Kuadër të BE-së për Mbetjet, i rishikuar (WFD (Direktiva 2008/98/EC), përcakton pesë hapa për trajtimin e mbetjeve në bazë të prioriteteve. Këto hapa formojnë bazën e hierarkisë së mbetjeve, e treguar edhe në figurën e mëposhtme, e cila ilustron rradhën e prioriteteve që duhet të merren parasysh në momentin e marrjes së vendimeve, përsa i përket përdorimit të burimeve dhe gjenerimit të mbetjeve në territorin që secila bashki ka në administrim.

Hierarkia e menaxhimit të mbetjeve është një udhëzues i pranuar kombëtar dhe ndërkombëtar, për t'i dhënë prioritet praktikave të menaxhimit të mbetjeve, me qëllim arritjen e rezultateve optimale mjedisore. Kjo hierarki përcakton rendin e preferuar të praktikave për menaxhimin e mbetjeve, nga më të preferuarat tek ato më pak të preferuara.



Politikat e mëposhtme janë zhvilluar dhe do të ndiqen gjatë zbatimit të planit, për të arritur rezultate të pranueshme, duke analizuar mundësitë e Bashkisë së Dibrës.

#### 8.5.1 Shmangia



Procesi i shmangies së gjenerimit të mbetjeve në Dibër është akoma në një fazë shumë të hershme. Megjithatë, në nivel shkollash, individët do të edukohen për përdorimin e çantave prej cope gjatë blerjes së produkteve. Rezultatet e kësaj politike do të jenë të vështira për t'u matur, por mund të vëzhgohen.



## 8.5.2 Ripërdorimi

### Ripërdorim

#### 2 Ripërdorim i materialeve

Në Dibër është e lartë mundësia e ripërdorimit të materialeve, si për shembull shishet plastike, shishet e qelqit, kavanozët dhe enët, rrobat e vjetra, materialet e ndryshme të paketimit, druri dhe gomat. Të qënurit një bashki e varfër nga ana ekonomike, ripërdorimi i materialeve është shumë i rëndësishëm. Njerëzit përdorin shishet për të mbajtur ujin apo qumështin, ose enë qelqi për përdorime shtëpiake. I vetmi produkt paketimi, i cili mund të përdoret relativisht më pak, janë qeset e holla plastike.

Promovimi i ripërdorimit të materialeve është shumë i arritshëm dhe Bashkia do të sigurohet që ky proces të njihet sa më mirë nga individët dhe të zbatohet në nivele sa më të larta të mundshme. Hapi i parë drejt zbatimit të kësaj politike do të jetë ndërgjegjësimi i qytetarëve.

## 8.5.3 Riciklimi

### Riciklim

#### 3 Riciklimi i materialeve

Materiali i riciklueshëm në Bashkinë e Dibrës nuk është në sasi shumë të madhe, pasi shumica e mbetjeve janë organike për vetë faktin se zona ka në përgjithësi karakter rural. Megjithatë, riciklimi është i mundshëm. Në këtë aspekt, kjo politikë do të përqëndrohet në dy drejtime kryesore:

#### 1. Kompostimi

Kompostimi është një proces ku mbetjet degradojnë në përzierje plehu, i cili mund të përdoret në kopësht për rritjen e bimëve. Kjo metodë është një mënyrë e shkëlqyer për të ricikluar mbetjet e kopshteve dhe të kuzhinës, si për shembull krasitjet nga bimët dhe ushqimi i mbetur.

Të gjithë qytetarët dhe bizneset në fshat do të inkurajohen dhe do të edukohen të shmangin plotësisht mbetjet organike nga sistemi i menaxhimit. Një politikë e tillë pritet të reduktojë maksimalisht, me rreth 50%, sasinë e mbetjeve urbane në nivel lokal.

#### 2. Zbatimi i një sistemi për ndarjen e mbetjeve dhe rikuperimi

Duke reduktuar sasinë e mbetjeve organike, pjesa e mbetur e mbetjeve që do të grumbullohet konsiderohet si mbetje e thatë dhe sistemi i grumbullimit do të përpiqet të grumbullojë këtë lloj mbetje në gjendje të pastër, për ta përdorur më vonë për riciklim.

Një sistem i grumbullimit të mbetjes së thatë me thasë në disa njësi administrative dhe me depo në disa njësi të tjera, si dhe një sistem i ndarjes së mbetjeve në zonën e gjelbër në qytetin e Peshkopisë (në bulevardin kryesor), do të krijojë mundësinë e grumbullimit të sa më shumë mbetjeje të thatë, e cila do të ruhet në një depo në qytet për t'u shitur më pas tek kompanitë e riciklimit. Lagjet kryesore të qytetit do të kenë skema pilote me dy kosha, për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve, ku në njërin kosh do të hidhet mbetja e thatë dhe në koshin tjetër mbetja organike.

#### 8.5.4 Mbetje për energji

Mbetje  
në energji

4 Rikuperim energjie para depozitimit

Mbetjet për energji nuk janë një mundësi për Dibrën, pasi sasia e mbetjeve të grumbulluara dhe të projektuara nuk do të jetë e mjaftueshme për të mbështetur ekonominë e një instalimi për të prodhuar energji nga mbetjet.

#### 8.5.5 Depozitimi i mbetjeve

Depozitim

5 Humbje totale e materialeve

Depozitimi i mbetjeve do të jetë mundësia e vetme për Dibrën, për 5 – 10 vitet e ardhshme. Venddepozitimi ekzistues do të përmirësohet nga ana teknike, për t'u kthyer në një zonë të kontrolluar. Fatkeqësisht, nuk ka një *landfill* në këtë zonë dhe kushtet, përsa i përket vendit, fondeve dhe fizibilitetit ekonomik, nuk e mundësojnë dot ndërtimin e një instalimi të tillë sanitar në 5 vitet e ardhshme. Në këtë aspekt, politika do të fokusohet në një kontroll më të mirë të mbetjeve të depozituara, për të zvogëluar sa më shumë mundësinë e pasojave jo të këndshme mjedisore dhe shëndetësore.

## 9 Planifikimi i menaxhimit të mbetjeve

Për zhvillimin e skenarit të propozuar, duhet të merren parasysh kufizimet në vijim, në lidhje me mungesën e shërbimit: Gjeografia, Vendbanimet, Infrastruktura rrugore, Popullsia, Zhvillimi Ekonomik, Kapaciteti Financiar dhe Sjellja e klientëve (tarifa).


### 9.1 Analiza e detajuar e gjendjes




#### 9.1.1 Gjeografia

Sic tregohet edhe më poshtë, në mënyrë të detajuar, Bashkia e Dibrës ka një nga profilet gjeografike më dinamike në vend, duke filluar me 380 m mbi nivelin e detit (lumi Drin) në 2751 m mbi nivelin e detit (mali i Korabit). Përgjithësisht, i gjithë territori rrethohet nga male dhe kodra, ku përkatësisht 50% e territorit është malor, 30% kodrinor dhe 15% fushor. Njësitë Administrative më të izoluar janë Lura, Zall Dardha, Zall Reçi, Arras, Selishta dhe Kalaja e Dodës, ndërkohë që Muhurri, Luznia, Arrasi, Sllova, Kastrioti dhe Tomini një pjesë të madhe të territorit të tyre e kanë të shpërndarë në zonat malore.

Harta e mëposhtme dhe grafikët e profileve tërthore tregojnë ndryshimet horizontale në lartësi, nga perëndimi në lindje, dhe rrugëtimin nga Maqellara (lumi Drin) në Kalanë e Dodës nëpërmjet rrugës kombëtare që kalon edhe në qytetin e Peshkopisë.

Harta 9: Relievi i Bashkisë Dibër (modelim)








**Zbatimi i shërbimeve moderne për menaxhimin e mbetjeve në këtë territor është i pamundur, për shkak të mungesës së një sistemi rrugor të përshtatshëm për mjetet teknologjike, kohën e madhe për të ushtruar shërbim në një territor kaq të thyer dhe për rrjedhojë financat e pamjaftueshme për të përballuar një shtrirje maksimale.**

### 9.1.2 Vendbanimet

Bashkia ka kryesisht karakter rural, me një shpërndarje prej rreth 90% rurale dhe 10% urbane (qyteti i Peshkopisë). Me rreth 140 fshatra, toka është përdorur gjerësisht për ndërtimin e shtëpive, të cilat tashmë janë shpërndarë në të gjithë territorin, nga zonat malore në ato të ulta. Për shkak të përdorimit të pakontrolluar të tokës pas vitit 1990, vendbanimet janë shpërndarë në të gjithë territorin. Fshatrat brenda Njësi Administrative janë zgjeruar në formë rrezore, ku secili fshat ka lidhje me qendrën e njësisë me rrugë më vete, por shumë rrallë ndodh që këto fshatra të lidhen me rrugë me njëri – tjetrin. Figura e mëposhtme tregon tipologjinë e shtrirjes së vendbanimeve në Njësinë Administrative të Maqellarës dhe aksesin në fshatra, ku secili ka dy drejtime nga fshati drejt qendrës dhe anasjelltas, për shkak të moslidhjes me njëri – tjetrin.



**Ofrimi i shërbimeve për këtë zhvillim kaq dinamik është shumë i kushtueshëm, për shkak të mungesës së rrugëve ndërlidhëse.**


### 9.1.3 Infrastruktura rrugore

Bashkia e re ka trashëguar një rrjet rrugor jo shumë të zhvilluar, me 911 km rrugë në total, ku vetëm 145 km janë të asfaltuara dhe pjesa e mbetur (766 km) e paasfaltuar, sipas të dhënave të vitit 2016-të. Shumica e njësive kanë rrugë të aksesueshme, të cilat mund të kalohen vetëm me mjete të veçanta transporti, si për shembull kuaj ose automjete të përshtatshme për terren malor. Lidhja me rrugën kryesore nuk ekziston në disa fshatra të Njësi Administrative, si për shembull Lurë, Zall Dardhë, Zall Reç dhe Selishtë.

***Ofrimi i një sistemi për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve me kamionë dhe kontenierë është e pamundur për disa nga njësitë dhe fshatrat, të shënuar edhe në hartën e mëposhtme të fshatrave të aksesueshëm (shumica e fshatra të paaksesueshëm ndodhen në njësitë administrative Lurë, Zall Dardhë, Zall Reç dhe Selishtë). Shërbimet mund të mundësohen vetëm në zonat e ulta të njësive administrative si Fushë Çidhën, Kastriot, Muhurr, Tomin, Melan dhe Maqellarë dhe në disa pjesë të zonave malore të njësive administrative si Sllovë, Luzni dhe Kala e Dodës, pasi disa nga fshatrat janë të pozicionuar në afërsi të rrugëve kombëtare. Harta e mëposhtme tregon rrugët e aksesueshme, të cilat lejojnë shërbimet “moderne” për mbetjet.***


***Harta jep një pamje të qartë për rrugët e asfaltuara, të pasfaltuara dhe ato rrugë të cilat janë planifikuar të asfaltohen pas Janarit të vitit 2017.***

Harta 10: Gjendja e sistemit rrugor në Bashkinë Dibër (Mars 2017)





**Në mënyrë që të zgjerohet zona e shërbimit, duhet të asftratohen dy rrugë lidhëse: 1. Rruga ndërmjet fshatit Lushaj dhe Fushë Kastriot; dhe 2. Rruga ndërmjet fshatrave Muhurr dhe Arras, deri në urën e re që lidh Fushë Çidhën me Arrasin, të cila janë shënjuar në hartën e mëposhtme me ngjyrë vjollcë.**



#### 9.1.4 Popullsia

Duke marrë parasysh të dhënat kryesore në menaxhimin e mbetjeve për ofrimin e një shërbimi për mbetjet e gjeneruara, numri i qytetarëve dhe trendi ndër vite është një informacion shumë i rëndësishëm për të adresuar sa më mirë qasjen e planifikimit për 5 vitet e ardhshme. Si kudo në vend, shifrat mbeten të diskutueshme. Zyrtarisht ka dy burime kryesore të dhënash, Census dhe Gjendja Civile. Këto dy regjistra raportojnë të dhëna të ndryshme për popullsinë në Bashkinë e Dibrës, respektivisht 61,619 (Census 2011) dhe 79,097 (Gjendja Civile 2014). Për qëllim të këtij planifikimi do të merren në konsideratë të dhënat nga Gjendja Civile. E gjithë zona është prekur nga migrimi dhe popullsia ka patur rënie që nga viti 1989, me një mesatare prej 30%. Në Njësitë Administrative Zall Reç, Lurë, Zall Dardhë dhe Kala e Dodës popullsia është reduktuar me 50 – 80%. Edhe pse gjendja është stabilizuar pak, kjo tendencë vazhdon të mbetet negative. Zonat më të populluara janë Njësitë Administrative Maqellarë, Melan, Peshkopi dhe Tomin.

**Planifikimi për këto zona do të ndikohet si nga numri i popullsisë (të qëndrueshme) dhe nga fakti se shumica e zonës është rurale, çka do të thotë që ka më shumë sasi mbetjesh organike të gjeneruara sesa mbetje e thatë.**

#### 9.1.5 Zhvillimi ekonomik

Bashkia e Dibrës është një zonë e varfër, e listuar shumë poshtë krahasuar me mesataren kombëtare për GDP-në. GDP-ja për Bashkinë e Dibrës është 177,111 Lek për person, krahasuar me mesataren kombëtare me 305,229 Lek për person. Forca shtytëse kryesore ekonomike është bujqësia, e ndjekur nga sektori i shërbimeve, ndërkohë që sektori i bizneseve është shumë i kufizuar dhe shumica e tyre janë pozicionuar në qytetin e Peshkopisë. Papunësia është shumë e lartë, duke variuar nga 15% në zonat rurale në 40% në qytetin e Peshkopisë. Papunësia kryesisht prek të rinjtë, ku rreth 60% e tyre

janë nën 34 vjeç. Në këtë Bashki gjenden 4,859 familje, të cilat jetojnë nën kufirin zyrtar të varfërisë dhe 25% e këtyre familjeve mbështeten me ndihmë ekonomike.

***Të mbështesësh një sistem modern të menaxhimit të mbetjeve, në kushte kaq të vështira të zhvillimit ekonomik dhe të të ardhurave, është një sfidë e vërtetë. Niveli i përballueshmërisë është shumë i ulët dhe duhet të zbatohet një përzierje e modeleve të menaxhimit për të arritur grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve.***

#### 9.1.6 Kapaciteti financiar

Në diskutimin e kapacitetit financiar, përqëndrohemi në proporcionin e fondeve të shpenzuara për menaxhimin e mbetjeve, në krahasim me totalin e shpenzuar nga Bashkia. Sipas të dhënave të 7 viteve të fundit, shuma e caktuar është zvogëluar në krahasim me buxhetin (6% në 2009 në 4% në 2016). Por dhe vetë shuma e buxhetit është zvogëluar në krahasim me buxhetin para bashkimit të komunave. Megjithatë, kjo është për faktin se nuk ka ndryshuar asgjë në lidhje me operacionet dhe zonat e shërbimit.

***Për të mbështetur kërkesat e sistemit të ri, është e nevojshme një llogaritje më e mirë e kostos dhe rritje e shumës së fondit të akorduar për arritjen e objektivave të menaxhimit të mbetjeve në fazën e parë dhe për zhvillimet në të ardhmen. Duke marrë parasysh fondet aktuale të transferuara në Bashki dhe nivelin e infrastrukturës dhe të ardhurat, një rritje e tillë nuk mund të jetë e lehtë për t'u arritur.***

#### 9.1.7 Sjellja e klientit

Principet “Tarifa mbulon koston” dhe “Ndotësi paguan” nuk janë shumë të zakonshme dhe të kuptueshme nga administrata dhe popullsia në Bashkinë Dibër. Duke marrë parasysh që nuk ka një llogaritje të duhur për koston, plotësisht larg nga vendosja e sistemit të tarifës dhe niveli i grumbullimit të tarifës (jo më shumë se 505) dhe kjo kryesisht nga bizneset dhe familjet me ndihmë ekonomike, avancimi i infrastrukturës së menaxhimit të mbetjeve është shumë kritik.

***Për të adresuar një nevojë për modelimin e kostos në të gjitha aspektet e shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve – i përmirësuar nga monitorimi i duhur i të dhënave – është përdorur dhe modeli i përcaktimit të tarifës. Paketa fiskale 2017 është përmirësuar dhe principi “ndotësi paguan” është adresuar më mirë. Bashkëpunimi me ndërmarrjen e ujit, si një agjent për mbledhjen e tarifës, pritet të përmirësojë performancën e përgjithshme të grumbullimit të mbetjeve.***

## 9.2 Zhvillimi i skemës funksionale për periudhën 2017 - 2022

Sipas analizës së mësipërme dhe, kryesisht, për shkak të mungesës së lidhjeve me rrugë, shërbimet e menaxhimit të mbetjeve për Bashkinë e Dibrës do të organizohen **në dy zona kryesore** operacionale dhe **1 nënzonë**, duke nisur që nga Qershori 2017. Pjesa e mbetur e Bashkisë nuk mund të arrihet nga kamionët, kështu që do të përdoren modalitete alternative. **Pjesa tjetër e Bashkisë do të konsiderohet si zona 3 operacionale** dhe do të ketë një model unik, grumbullim të brendshëm dhe transferim të mëvonshëm të shpjeguar si më poshtë.

Zona e Shërbimit	Shtirirja
1 Zona kryesore – Zona operacionale 1	Peshkopi + Tomin, përfshirë disa fshatra të Kastriotit dhe Muhurrit
2 Nënzona operacionale 3	Kastriot + Fushë Çidhën + Sillovë + Kala e Dodës
3 Zona kryesore – Zona operacionale 2	Maqellarë + Melan
4 Zonat e tjera	Të gjitha njësitë

Skicimi i zonës është bazuar në infrastrukturën ekzistuese të rrugëve dhe aksesin në fshatra. Megjithatë, disa fshatra kanë rrugë shumë të ngushta dhe do të jetë shumë e vështirë për kamionët të manovrojnë në këto zona. Kjo do të shkaktonte vonesa në shërbim, por që nuk pritet të jenë shumë domethënëse. Në fshatrat e aksesueshëm me asfalt, Muhurri dhe Kastrioti, distanca dhe koha e udhëtimit është më e madhja.

Propozimi bazohet në një skemë, e cila do të mundësohet me kamionë ngjeshës dhe do të ketë sistemin e duhur të kontenierëve. Megjithatë, e gjithë zona është projektuar si një kombinim i grumbullimit alternativ dhe grumbullimit me kamionë. Një skemë e tillë është treguar më poshtë (*harta 12*) dhe është mundësia e vetme për pesë vitet e ardhshme, duke marrë parasysh faktin që nuk pritet zhvillimi i infrastrukturës rrugore në zonat e largëta dhe që popullsia dhe gjenerimi i mbetjeve është i papërfillshëm. Kështu që, propozohet grumbullimi i bazuar derë më derë ose me thasë.

Sistemi i grumbullimit do të bazohet në një orar të caktuar, i cili do të funksionojë nga një sistem i mirë komunikimi ndërmjet bashkisë, administratorëve dhe kryepleqve të fshatrave, në mënyrë që të kuptohet kur është koha e duhur për grumbullimin dhe transferimin.

Pasi të ngrihet sistemi i rrugëve, sugjerohet vendosja e një sistemi me kontenierë të mëdhenj në qendër të çdo Njësie Administrative. Këta kontenierë do të zbrasen, bazuar në sasinë e mbetjeve të depozituara në to, nga një kamion, i cili do të vizitojë secilën njësi në një datë specifike përgjatë muajit.

Për zonat tejet të izoluar, një depo për mbetjet e thata do të ishte zgjidhja e situatës në këtë fazë. Një sistem i tillë propozohet për Njësinë Administrative Lurë, ku turizmi është një sektor premtues dhe një sistem i tillë mund të reduktojë sasinë e mbetjeve në zonë.

Njësia Administrative Kala e Dodës do të nisë që vitin e parë një skemë të kombinuar, ku një mjet i brendshëm (derë më derë) grumbullon mbetjen e thatë në të gjithë fshatrat e paaksesueshëm të


### Kontenieri Skip- 5-10m<sup>3</sup>




Transporti dhe instalimi kryhet nëpërmjet mjeteve të dedikuara për kontenierët "Skip". Këto sisteme janë të përshtatshme për menaxhimin e mbetjeve, grumbullimin e metaleve, për materialet e ndryshme të paketimit, materialet nga prishja e ndërtesave, mbetjet industriale – tregtare, etj.

Njësisë dhe i transferon ato në qendër (fshati Ceren), më pas bëhet grumbullimi nga një kamion i cili i transferon këto mbetje në venddepozitim.

Harta 11: Skema e përgjithshme e funksionimit (kamioni dhe sistemi i kontenierëve)



Harta 12: Skema e përgjithshme e funksionimit (kamioni dhe sistemi i kontenierëve)



(Shënim: sasia e mjeteve është dhënë vetëm për të kuptuar sistemin dhe nuk është në përputhje me përdorimin e të gjithë infrastrukturës së treguar në hartë)

## Përshkrimi i Zonave

### Zona 1 – Peshkopi – Tomin

Kjo zonë shërbimi është më e dendura, pasi është pjesa më e populluar e Bashkisë. Shërbimi do të mbulojë të gjithë qytetin e Peshkopisë dhe fshatrat e aksesueshëm të Tomin, Kastriotit dhe Luznisë, si më poshtë:

1. Fshatrat e Tomin: Dohoshisht; Cetush; Ushtelenxë; Rashnapojë; Pollozhan dhe Tomin
2. Fshatrat e Kastriotit: Kishavec dhe Kuben;
3. Fshatrat e Muhurrit: Fushë-Muhurr.

Shërbimi në këtë zonë do të zgjerohet në krahasim me atë ekzistues dhe, për këtë arsye, kërkohen edhe investime. Kjo zonë shërbimi do të pajiset e gjitha me kontenierë të rinj dhe një kamion të ri për grumbullimin e mbetjeve. Infrastruktura ekzistuese do të zhvendoset e gjitha në zonën e dytë të shërbimit, siç do të shpjegohet edhe më poshtë.


Tabela e mëposhtme mundëson informacion të detajuar përsa i përket infrastrukturës dhe nevojave operacionale për Zonën 1.

Treguesi	Njësia	Qyteti Peshkopi	+Fshatrat
Popullsia që do të marrë shërbim	Nr.	19179	~6500
Familjet	Nr.	5175	~1700
Bizneset që do të marrin shërbim	Nr.	1018	~50
Institucionet që do të marrin shërbim	Nr.	~10	~3
Sasia totale e mbetjeve të gjeneruara (mbetje të ngurta urbane)	t/vit	~5500	~950
Sasia totale e mbetjeve të gjeneruara (mbetje të ngurta urbane)	ekv.kg/banorë/ditë	~13 (0.7)	~2.5 (0.4)
Nr. i kamionëve	Nr.	1 (lloji 7 ton)	-
Nr. i kontenierëve	Nr. (1.1m3)	150	20
Stafi operacional	Nr.	6 (2 shoferë + 4 puntorë pa fshirjen)	-
Distanca e grumbullimit	km/ditë/zhvendosjet	12	55
Koha e operimit	orë/ditë	8	8
Ditët e operimit	ditë/javë	7	-
Kostoja totale për investime	Lek/vit	7.3 (million)	-
Kostoja totale operacionale	Lek/vit	15.8 (million)	-
Kosto për ton (e gjithë zona)	Lek/vit	2,890	-
Kosto për banorë (e gjithë zona)	Lek/vit/banorë	633	-

Lexo: Kapitulli 13: Llogaritja e detajuar e kostove kapitale dhe operacionale




Harta 13: Harta e mbulimit të Zonës 1 dhe shpërndarja e infrastrukturës grumbulluese



Kjo zone, për shkak të densitetit të lartë të popullsisë dhe, si rrjedhojë, edhe të gjenerimit të lartë të mbetjeve, do të ketë shërbim dy herë në ditë, për 6-7 ditë në javë. Nevoja është për shërbim çdo ditë, por duke marrë në konsideratë shtrirjen e shërbimit në Kalanë e Dodës (nënzona 3), grumbullimi i mbetjeve në zonën 1 mund të bëhet 6 ditë/javë, njëherë në dy javë. Një variant i tillë është i mundshëm pasi aktualisht një skemë e tillë po funksionon në qytet. Ditët e përzgjedhura të javës do të përcaktohen bazuar në sjelljen e popullatës.


Ndërrimet në qytet do të organizohen bazuar në intensitetin e gjenerimit të mbetjeve dhe në rëndësinë e zonës që do të pastrohet e para. Prandaj, rrugëtimi i parë do të mbledhë mbetjet nga lagjet kryesore të qytetit, ashtu siç janë treguar edhe në hartën e mëposhtme. Duke përdorur programin kompjuterik, GIS Network Analyst, për rrugëtimin është përpunuar informacioni për të patur performancë maksimale bazuar në kohë dhe në distancë. Rrugëtimi mund të ndryshojë me zhvillimet në infrastrukturën rrugore, veçanërisht pas ndërtimit të Unazës së qytetit, e cila shkon në afërsi të venddepozitimit dhe përgjatë pjesës jugperëndimore të qytetit. Megjithatë, ky zhvillim nuk sjell ndonjë ndryshim të madh në rrugëtim, pasi turni tjetër duhet të ndjekë rrugën për në lagjen Dobrovë, duke ndjekur rrugën lart kësaj lagjeje.



Koha totale e shpenzuar për grumbullim llogaritet në mënyrë automatike nga programi GIS Network Analyst dhe rezultojnë rreth 8 orë (një kohë normale pune), bazuar në një shpejtësi të dhënë të lëvizjes së kamionit 15 km/orë dhe ndalesë mesatare në çdo kontenier për grumbullimin e mbetjeve rreth 4 minuta. Distanca totale është 12 km dhe koha totale për turn është orari 06:00 - 13:30. Numri total i kontenierëve për të grumbulluar mbetjet është 96 dhe sasia totale e mbetjeve që pritet të grumbullohet është 5 – 6 ton.



Turni tjetër do të mbulojë periferitë dhe fshatrat që janë pjesë e skemës së re, siç tregohet edhe në hartën e mëposhtme.



Koha totale për grumbullim, e llogaritur automatikisht nga programi GIS Network Analyst, është 8 orë (kohë normale për një turn), bazuar në një shpejtësi të dhënë të lëvizjes së kamionit 15 km/orë dhe ndalesë mesatare në çdo kontener për grumbullimin e mbetjeve rreth 4 minuta.

Distanca e përgjithshme është 55 km dhe koha totale për turn është orari 15:00 - 23:00. Numri total i kontenerëve për të grumbulluar mbetjet është 84 dhe sasia totale e mbetjeve që pritet të grumbullohet është më shumë se 5 ton.

Lloji i kamionit për të kryer këtë shërbim është një kompaktor 7 tonësh, i cili ka një kombinim të mirë të fleksibilitetit për të hyrë në rrugët e ngushta dhe të sasisë së mbetjeve të grumbulluara.

#### Lloji i kontenerit të propozuar



*Specifikime: Kapaciteti 1100 lt dhe sistemi i hapjes me pedal qendror.*

### Nënzona 3 e operimit - Kastriot, Sllovë, Kala e Dodës dhe Fushë Çidhën.

Kjo zonë shërbimi është pjesë e shtrirjes së zonës së parë në verilindje të Bashkisë së Dibrës, në Njësinë Administrative Kala e Dodës. Shërbimi mundësohet në fshatrat kryesorë të Njësisë Administrative Kala e Dodës (Ceren, Vasije); Sllovë (Sllovë, Shumbat); Fushë Çidhën (Bllicë, Fushë Çidhën, Laçaj) dhe Kastriot (Kastriot, Brest i Poshtëm, Kandri); të cilët janë me rrugë të asfaltuara.

Në mënyrë që të zgjerohet shërbimi në këtë zone, kontenierët ekzistues të qytetit të Peshkopisë (pasi të riparohen dhe të jenë në gjendje të mirë) do të zhvendosen në fshatrat e përmendur më sipër. Është planifikuar që të shpërndahen më shumë se 32 kontenierë në këto fshatra. Një sistem i tillë është i nevojshëm për fazën e parë të ndërhyrjes.


Si një zonë turistike me vlera të larta natyrore, e shtrirë në një zonë të mbrojtur Korab – Koritnik, Njësia Administrative Kala e Dodës do të fillojë e para modelin alternativ të grumbullimit, i njohur zyrtarisht nga Bashkia e Dibrës. Ky model do të përfshijë marrjen e një punonjësi, i cili, me anë të një kamioni të vogël, do të grumbullojë mbetjen e thatë nga fshatrat e Njësisë Administrative dhe do t'i dërgojë në qendër të fshatit (Ceren), ku do të vijë më pas kamioni i mbetjeve, një ose dy herë në muaj, në varësi të gjenerimit të mbetjeve. Zbatimi i kësaj skeme bëhet për shkak të gjendjes shumë të keqe të rrugëve ndërmjet fshatrave.

*Detajet për këtë skemë janë shpjeguar më tej, në shtojcën 01 të këtij plani.*

Tabela e mëposhtme mundëson informacion të detajuar përsa i përket infrastrukturës dhe nevojave operacionale për nënzonën 3.

Treguesi	Njësia	E gjithë zona
Popullsia që do të marrë shërbim	Nr.	~5000 (zona e shërbimit)
Familjet	Nr.	~1000
Bizneset që do të marrin shërbim	Nr.	~50
Institucionet që do të marrin shërbim	Nr.	~10
Sasia totale e mbetjeve të gjeneruara (mbetje të ngurta urbane)	t/vit	~365
Sasia totale e mbetjeve të gjeneruara (mbetje të ngurta urbane)	ekv.kg/banorë/ditë	~1 (0.2) pjesë e zonës 1
Nr. i kamionëve	Nr.	1 (lloji 7t) ose 10t
Nr. i kontenierëve	Nr. (1.1m <sup>3</sup> )	32
Stafi operacional	Nr.	Pjesë e stafit të zonës 1
Distanca e grumbullimit	km/ditë/zhvendosjet	100
Koha e operimit	orë/ditë	6
Ditët e operimit	ditë/javë	1 herë në muaj ose 2 herë në muaj
Kostoja totale për investime	Lek/vit	Nuk ka nevojë për investime pasi kontenierët do të merren nga qyteti i Peshkopisë
Kostoja totale operacionale	Lek/vit	0,6 milion
Kosto për ton (e gjithë zona)	Lek/vit	1,650
Kosto për banorë (e gjithë zona)	Lek/vit/banorë	120

Harta 14: Shtirirja e Nënzonës 3



## Zona 2 e operimit– Maqellarë - Melan

Kjo zonë shërbimi është e dyta më e rëndësishme për shkak se përfshin zonat e dyta më të populluara të Bashkisë. Ky shërbim do të mbulojë të gjithë Njësinë Administrative Maqellarë dhe Melan duke u shtrirë në shumicën e fshatrave të listuar më poshtë:

1. **Fshatrat e Maqellarës:** Bllatë e Epërme; Klobçisht; Majtarë; Burim; Vojnikë; Ceren; Kovashicë; Kërçisht i Poshtëm; Grazhdan; Gradec; Erebara; Pocest dhe qendra e Maqellarës.
2. **Fshatrat e Melanit:** Trepça; Pejka; Pjece; Melan dhe Grevë.

Në mënyrë që të funksionojë shërbimi në këtë zonë, infrastruktura ekzistuese e qytetit të Peshkopisë (kamioni 10 tonësh dhe kontenierët 1,1m<sup>3</sup>) do të transferohen dhe do të funksionojnë brenda kësaj zone shërbimi. Kamioni do të menaxhohet nga administrata e Njësisë Maqellarë dhe do të ketë planin e saj të funksionimit për të mbuluar të gjithë fshatrat të cilët kanë akses nëpërmjet rrugëve të asfaltuara.


Harta e mëposhtme tregon fshatrat të cilët do të mbulohen me shërbim dhe pozicionim e kontenierëve brenda zonës, gjithashtu jepet rrugëtimi më optimal i kamionit për grumbullimin e mbetjeve realizuar në mënyrë automatike nga programi kompjuterik GIS Network Analyst.

Tabela e mëposhtme jep një informacion të detajuar për sa i përket infrastrukturës dhe nevojave për operim për Zonën 2.

Treguesi	Njësia	E gjithë zona
Popullsia që do marrë shërbim	Nr.	~15000 (zona e shërbimit)
Familjet	Nr.	~3400
Bizneset që do marrin shërbim	Nr.	~200
Institucionet që do marrin shërbim	Nr.	~10
Sasia totale e mbetjeve të gjeneruara (mbetje të ngurta urbane)	t/vit	~2100
Sasia totale e mbetjeve të gjeneruara (mbetje të ngurta urbane)	ekv.kg/banorë/ditë	~6 (0.4)
Nr. i kamionëve	Nr.	1 (lloji 10 ton)
Nr. i kontenierëve	Nr. (1.1m <sup>3</sup> )	~61
Stafi operacional	Nr.	3 (1 shofer, 2 punëtorë)
Distanca e grumbullimit	km/ditë/zhvendosjet	60
Koha e operimit	orë/ditë	6-7
Ditët e operimit	ditë/javë	7
Kostoja totale për investime	Lek/vit	Nuk ka nevojë për investime pasi kontenierët do të merren nga qyteti i Peshkopisë
Kostoja totale operacionale	Lek/vit	5.6 milion
Kosto për ton (e gjithë zona)	Lek/vit	2,550
Kosto për banorë (e gjithë zona)	Lek/vit/banorë	373

Lexo: Kapitulli 13: Llogaritja e detajuar e kostove kapitale dhe operacionale

Harta 15: Zona 2 e shërbimit – Harta e operimit





Koha totale e shpenzuar për grumbullim, e llogaritur në mënyrë automatike nga programi kompjuterik GIS Network Analyst, është mbi 7 orë (një turn normal pune) dhe është bazuar në një shpejtësi të dhënë të lëvizjes së kamionit 15 km/orë dhe ndalesë mesatare në çdo kontenier për grumbullimin e mbetjeve rreth 4 minuta. Distanca e përgjithshme është 60 km dhe koha totale për turnin është orari 07:00 - 14:00. Numri total i kontenierëve për të grumbulluar mbetjet është ~61 dhe sasia totale e mbetjeve që pritet të grumbullohet është 3 – 4 ton.

### Zonat e tjera


Pjesa e mbetur e Njësisë Administrative, deri në momentin kur rrjeti rrugor do të jetë i stabilizuar për të lëvizur mjetet e mëdha, do të kenë një shërbim grumbullimi, i cili do të funksionojë një herë në muaj, nëpërmjet kontenierëve Skip. Një mënyrë e tillë grumbullimi mund të organizohet një herë në muaj, pasi pritet që sasia e mbetjeve të gjeneruara të jetë e vogël.



Njësitë Administrative, të cilat preken totalisht apo pjesërisht nga kjo mënyrë grumbullimi, janë: Lurë; Zall-Reç; Zall-Dardhë; Muhurr; Selishtë; Arras dhe Kastriot.

*Profilet e secilës prej Njësisë Administrative gjenden të bashkëlidhura (shtojcat 02-08) me këtë plan.*

Profili i mëposhtëm i prerjes tërthore tregon se sa i vështirë është terreni nga fshatrat shumë të largët të Njësisë Administrative Muhurr deri në lidhjen me rrjetin rrugor.



Njësitë Administrative Muhurr dhe Arras mund të aksesohen më vonë, nëpërmjet urës së re që lidh Fushë Çidhën me Arrasin, pasi Bashkia të investojë në lidhjen rrugore ndërmjet urës dhe fshatrave të Arrasit.

Duke marrë në konsideratë vlerat shumë të rëndësishme natyrore dhe turistike të Njësisë Administrative të Lurës, një depo për mbetjen e thatë do të vendoset në qendër të kësaj Njësie. Një qasje e tillë është e vetmja mundësi për Lurën, në këtë fazë. Transferimi i mbetjes së thatë do të organizohet nga Bashkia drejt venddepozitimit qendror, sa herë të jetë e nevojshme. Pasi të jetë përmirësuar sistemi rrugor, Njësia Administrative e Lurës do të lidhet me atë të Arrasit.

Harta 16: Njësitë Administrative që do të kenë një formë ndryshe të grumbullimit të mbetjeve



Depo për mbetje të thatë  

Kombinuar  

Kontenierë voluminoz  

## Trajtimi i mbetjeve

Siç është përshkruar edhe më sipër, venddepozitimi i Peshkopisë është zona e vetme zyrtare për grumbullimin e mbetjeve, miratuar në vitin 2003 nga Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë (KRRTRSH). Kjo zonë është keqmenaxhuar dhe nuk përputhet me standardet e kërkuara nga ligji në drejtim të kontrollit të ndotjes në ajër, ujë dhe tokë.



Planet për ndërtimin e një venddepozitimi janë refuzuar, për shkak të problemeve ekonomike dhe financiare. Asnjë nga planet për Menaxhimin Rajonal të Mbetjeve dhe as Plani Rregullator nuk kanë vendosur për ndërtimin e një venddepozitimi.

Në kushte të tilla, Bashkia ka investuar për të përmirësuar situatën e venddepozitimit ekzistues, për ta kthyer atë në një venddepozitim të kontrolluar deri në momentin që do të duhet të mbyllet përfundimisht. Masa të tilla janë projektuar për të rritur hapësirën e zonës për grumbullimin e mbetjeve, për kontrollin e ujërave, kontrollin e riskut, kontrollin e gazit, menaxhimin e përgjithshëm të mbetjeve, kontrollin shëndetësor dhe kontrollin e peisazhit.

Investimet në venddepozitim janë planifikuar të zbatohen rreth gjysmës së parë të vitit 2017 dhe pritet të grumbullojë për pesë vitet e ardhshme edhe mbetjet e grumbulluara nga shërbimi i zgjeruar.

*Bashkëngjitur gjendet plani i rehabilitimit të fushës.*

## Venddepozitimi Peshkopi

Zona ka një sipërfaqe të përgjithshme 8000 m<sup>2</sup> dhe është i pozicionuar 2 km nga qyteti i Peshkopisë, në luginën e një lumi pothuajse të thatë.

Pozicioni: Gjerësi gjeografike 41°40'29.00"N dhe Gjatësi gjeografike 20°25'43.38"E





## Zgjidhjet alternative

### Transferimi i mbetjeve në venddepozitim të Bushatit

Venddepozitimi i Bushatit pozicionohet në Bashkinë e Vaut të Dejës dhe është objekti më i afërt sanitar për trajtimin e mbetjeve nga Bashkia Dibër. Transferimi i mbetjeve në këtë venddepozitim, teknikisht mund të realizohet nëpërmjet tre alternativave:


1. Transferimi ditor direkt me anë të kamionit
2. Ndërtimi i një stacioni transferimi dhe transportimi i mbetjeve me një kamion të madh
3. Bashkimi me skemën rajonale të Bashkisë Bulqizë

### Alternativa 1

Për mundësinë e pare, kamionit i duhet të udhëtojë rreth 200 km vetëm në një drejtim me një kohë udhëtimi 5 – 6 orë, siç tregohet edhe më poshtë nëpërmjet hartës nga Google Maps. Në këtë mënyrë, kamioni duhet të shpenzojë një ditë të tërë për të shkuar e për t'u kthyer nga venddepozitimi.

***Dërgimi ditor i mbetjeve atje nuk është një mundësi e përshtatshme, për shkak të kohës dhe kostos së lartë.***

**Harta 17: Distanca nga venddepozitimi i Bushatit (Google Maps)**



## Alternativa 2

Për mundësinë e dytë, ndërtimi i një stacioni transferimi në Maqellarë është mundësia më e mirë për shkak të qasjes dhe afërsisë me venddepozitimin e Bushatit, i cili është edhe destinacioni final.

Mund të merren në konsideratë dy tipe, që janë më të përballeshme edhe nga ana financiare: a) Rimorkio e lartë e hapur pa ngjeshje; b) Sistem ngjeshës.



Në secilin rast, llogaritet që të dërgohet në stacionin e transferimit një sasi mbetjesh prej rreth 20 ton. Kjo sasi mbetjesh do të transferohet një herë në dy ditë drejt venddepozitimit të Bushatit, me anë të një kamioni të madh.

Zbatimi i kësaj skeme operimi do të përfshijë blerjen e një toke me sipërfaqe jo më pak se 4000 m<sup>2</sup>, ndërtimin e zonës për ngarkimin dhe shkarkimin e mbetjeve, blerjen e dy kontenerëve të mëdhenj që mund të mbajnë 20 ton mbetje dhe blerjen e një kamioni, i cili mund të mbajë këta kontenerë.

Në kushtet operacionale, kjo mundësi do të kërkojë më shumë karburant, fuqi punëtore, mirëmbajtje dhe amortizim, energji dhe kosto të tjera operacionale, siç janë monitorimi dhe mbrojtja e mjedisit.

Duke e konsideruar analizën e koston si një ushtrim të thelluar fizibiliteti, përllogaritjet janë bërë sipas studimeve të ngjashme. Më poshtë janë dhënë llogaritjet.

### Llogaritjet e kostove për stacionin e transferimit në Dibër

Sipas studimeve, kostoja për ton për ndërtimin dhe operimin e këtij lloj stacioni transferimi është rreth 20-25 Euro.

Kostoja e transportit për një trailer 20 tonësh është llogaritur në bazë të formulës:

$Kosto\ për\ ton = (kostoja\ e\ trailerit/orë) \times (orë\ pune) / mbetjet\ e\ transferuara$

Duke marrë në konsideratë që një trailer kushton rreth 15 Euro/orë (karburanti = 10 lt orë \* 1.3 Euro = 13 Euro/orë + kostoja për shoferin + mirëmbajtja + amortizimi + të tjera) dhe distanca vetëm në një drejtim për në venddepozitim është 6 orë, llogaritjet janë si më poshtë:

$Kosto\ për\ ton = 20 * 12 / 20 = 12\ Euro$

Duke i përmbledhur, kostoja totale për ndërtimin dhe funksionimin e një stacioni transferimi dhe për transferimin e mbetjeve do të jetë 30 – 35 Euro/ton.

*Kësaj shume do të duhet t'i shtojmë taksën e hyrjes në venddepozitim, e cila është 5 – 7 Euro/ton.*

**Si përfundim, transferimi i mbetjeve me një kamion, një herë në ditë, për në venddepozitim e Bushatit do të ketë një kosto për Bashkinë: 30 (funksionim+transferim) + 5 (taksa) = 35 Euro \* 20 (ton për transfertë) = 700 Euro/transfertë ose 10,500 Euro/muaj ose 126,000 Euro/vit.**

Këto kosto përfaqësojnë 70% të buxhetit total për menaxhimin e mbetjeve për Bashkinë e Dibrës.

***Kjo mundësi do të jetë shumë e kushtueshme për buxhetin vendor të Dibrës dhe nëse do të financohej, do të nevojiteshin të paktën 3 vite për ndërtim dhe për të filluar punën.***

### **Alternativa 3**

Ky variant kërkon studime të tjera dhe bashkëpunim institucional. Gjithashtu, kërkon ndërtimin e një numri të madh objektesh me destinacion final venddepozitim e Bushatit, ose ndërtimin e një venddepozitimi rajonal, i cili sërish do të kërkonte ndërtimin e Stacioneve të Transferimit.


Në këtë stad nuk mund të kryhen llogaritje.

**Në parim, është më e pranueshme një skemë rajonale për shkak edhe të nivelit ekonomik. Megjithatë, do të kërkohet mbështetja me fonde shtesë nga Ministria apo mbështetësit ndërkombëtarë dhe vendosja e një sistemi grumbullimi të tarifës vendore.**

## Zbatimi i skemave të ndryshme të menaxhimit në qytetin e Peshkopisë

Qyteti i Peshkopisë, si zona kryesore urbane dhe qendra e aktivitetit njerëzor dhe institucional, do të fokusohet në disa skema të ndryshme pilot, në mënyrë që të nisë zbatimin e dispozitave të përcaktuara nga legjislacioni shqiptar për ndarjen e mbetjeve.

Siç tregohet edhe në hartën e mëposhtme, qyteti do të ketë katër zona të brendshme, të ndryshme, për menaxhimin e mbetjeve.



Përshkrimi se si do të funksionojë shërbimi në zonat e përzgjedhura.

### Zona 1 – Zona e gjelbër – bulevardi kryesor

Si imazhi kryesor i qytetit të Peshkopisë, bulevardi, i cili tashmë është në rikonstrukcion, do të jetë zonë pilote e qytetit për një Dibër të pastër. Në bulevard do të funksionojë sistemi për ndarjen e mbetjeve, ku do të përfshihet edhe një kosh i veçantë për bateritë.





Një sistem i tillë do të propozohet edhe në brendësi të kompleksit të llixhave në Peshkopi. Investimet e planifikuara në kompleks do të integrojnë një sistem të ndarjes së mbetjeve në burim dhe grumbullim të veçantë të mbetjeve.

### Zona 2 – Sistemi me dy kosha për ndarjen e mbetjeve (e thatë dhe e njomë)

Në këtë zonë (kudo ku të jetë e mundur) do të vendoset një sistem me dy kosha. Koshat do të kenë një ngjithës, i cili do t'u tregojë qytetarëve se ku duhet të hidhen mbetjet e thata ose ato të njoma. Një nismë e tillë do të fokusohet në qendër të lagjeve.



### Shkollat – Sistem me tre kosha

Në të gjithë shkollat që do të përfshihen në shërbimin e zgjeruar, pritet të vendoset sistemi për ndarjen e mbetjeve në burim. Një nismë e tillë do të fillojë me zbatimin e planit dhe do të shtrihet edhe më tej, për të futur të gjitha parimet e menaxhimit të integruar të mbetjeve. Shkollat kryesore në qytetin e Peshkopisë do të jenë të parat që do të kenë sistemin me tre kosha dhe mësuesit do të angazhohen në edukimin e fëmijëve dhe monitorimin e situatës çdo ditë, në mënyrë që kjo nismë të funksionojë. Duke marrë parasysh që shkollat kanë numrin më të madh të individëve në një zonë, sasia e mbetjeve të gjeneruara dhe të grumbulluara do të jetë domethënëse dhe kjo do të jetë një mesazh për pjesën tjetër të njësisë.



### Zona 3 - Lagjia "Stojke" – grumbullimi derë më derë

Pjesa e lagjes Stojke në qytetin e Peshkopisë ka shumë vështirësi në menaxhimin e mbetjeve.

Kjo si pasojë e aksesit të kufizuar për të vendosur një strukturë tipike me kontenerë për grumbullimin e mbetjeve. Për më tepër, banorët nuk pranojnë vendosjen e kontenerëve në afërsi të hyrjes së shtëpive të tyre. Në këto kushte, një çështje e tillë mund të jetë një mundësi për futjen e shërbimit të grumbullimit derë më derë për këtë lagje. Për arritjen e kësaj qasjeje, qytetarët do të duhet të informohen për orët kur do të kalojë kamioni dhe se kur punëtorët do të hyjnë në këtë lagje për të marrë mbetjet, në mënyrë që të lenë qeset e tyre të mbetjeve tek dera.



Duke e konsideruar këtë si përpjekjen e parë për këtë lloj menaxhimi, do të duhet pak kohë që të ndërtohet besimi dhe bashkëpunimi me qytetarët, prandaj stafi i Bashkisë do t'i kushtojë vëmendje të veçantë kësaj pjese të qytetit.

### Ekzistenca e zonave të ndotura

Për shkak të mosekzistencës së formave të grumbullimit të mbetjeve në shumicën e fshatrave të Dibrës (më shumë se 100), janë krijuar zona të ndotura, duke hedhur mbetjet në venddepozitime të improvizuara (gropa) dhe në trupat ujorë në të gjithë Bashkinë. Venddepozitime të tilla gjenden kudo përgjatë rrugëve kryesore, përrenjve, lumenjve, rezervuarëve e fshatrave. Sasia e mbetjeve të grumbulluara është shumë e madhe dhe pastrimi i këtyre zonave është shumë i rëndësishëm, por është një proces i kushtueshëm dhe që kërkon kohë dhe shërbime logjistike.



Për të zgjidhur këtë situatë, në këto “venddepozitime” duhet të merren në konsideratë tre nivele ndërhyrjeje:

1. Alokimi i fondeve vjetore për aktivitete pastrimi dhe ndalimi i aktiviteteve në këto “venddepozitime”, duke zhvilluar një plan identifikimi dhe kontrolli me anë të administratorit të Njësisë;
2. Të fillohet puna nga “venddepozitimet” përgjatë rrugëve kombëtare dhe rrjedhave ujore kryesore;
3. Të zgjerohet procesi duke mbyllur të gjithë këto “venddepozitime” dhe duke pastruar zonën sipas situatës.



*Fig 1: Një rezervuar i përdorur si zonë depozitimi për mbetjet në fshatin Vojnikë në Njësinë Administrative Maqellarë*



*Fig 2: Një zonë e ndotur përgjatë rrugës kombëtare Peshkopi – Kukës dhe rrjedhës ujore në Njësinë Administrative të Kastriotit*

### 9.3 Përcaktimi i nivelit të performancës 2017-2022

Bazuar në analizën e paraqitur më sipër dhe në përdorimin e mjeteve për koston dhe tarifën, është projektuar performanca e mëposhtme, si më e përballueshja që do të zbatohet gjatë planit të ardhshëm 5-vjeçar të menaxhimit të mbetjeve (2017-2022).

Tabela 20: Performanca e projektuar

Kategoria	Nr.	Treguesi	Aktualisht (2016)	Periudha e propozuar (2017 – 2020)	Propozimi (2020 – 2022)
Cilësia e shërbimit	C1	<b>Zonat e mbuluara me shërbim grumbullimi</b>			
		<i>C1.1 Mbulimi me shërbim i zonave urbane dhe periferike</i>	80%	100%	100%
		<i>C1.2 Mbulimi me shërbim i zonave të largëta</i>	0%	30%	56%
		<i>C1.3 Mbulimi me shërbim i zonave rurale</i>	5%	50%	70%
	C2	<b>Pastërtia e qytetit</b>	80%	90%	95%
	C3	<b>Perceptimi publik: shkalla e kënaqësisë</b>	87%	90%	95%
Qëndrueshmëria mjedisore	D1	<b>Shkalla e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve</b>	0%	10%	25%
	D2	<b>Mbrojtja e burimeve natyrore: shkalla e trajtimit të mbetjeve në venddepozitimin inxhinierik ose në zona depozitimi të kontrolluara dhe të aprovuara.</b>	0%	80%	90%
Qëndrueshmëria financ.&insttit.	E1	<b>Mbulimi i koston: Tarifa mbulon koston.</b>	75%	95%	100%
	E2	<b>Sa kontribuojnë qytetarët në financimin e shërbimit: shkalla e mbledhjes së tarifës</b>	50%	60%	70%
	E3	<b>Transparenca e sistemit të faturimit</b>	E ulët	Mesatare	Mesatare
<b>Kostoja e shërbimit</b>			~5,250 Lek/t 1,140 Lek/banorë/vit	~5,443 Lek/t 1,000 Lek/banorë/vit	~5,443 Lek/t 1,000 Lek/ banorë/vit

Treguesit e mësipërm janë matur duke u bazuar në një metodologji, e shpjeguar më në detaje në Shtojcën 09 të këtij plani.



## 9.4 Shpjegimi i vlerave të treguesve të projektuar

### Treguesi C1.1.

*I llogaritur në bazë të formulës së mëposhtme:*

$$C1.1 = \frac{\text{Sasia e mbetjeve të grumbulluara në zonat urbane \& periferike} \left(\frac{\text{ton}}{\text{vit}}\right)}{\text{Sasia e mbetjeve të gjeneruara në zonat urbane \& periferike} \left(\frac{\text{ton}}{\text{vit}}\right)} \times 100$$

*Plotësimi i formulës*

$$C1.1 = \frac{5475}{5475} \times 100$$

Shërbimi do të mbulojë të gjithë zonën urbane që në vitin e parë të funksionimit dhe do të intensifikohet duke rritur sasinë e mbetjeve të grumbulluara dhe performancën e përgjithshme. Një kamion i ri dhe kontenierë të rinj do të blihen dhe do të instalohen, duke zgjeruar shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zona të veçanta të qytetit.

*Investimet e kërkuara për të arritur performancën:*

Vlera totale e investimeve është rreth 8 milion Lek dhe janë mbështetur plotësisht nga *dldp* dhe Bashkia.

*Niveli i saktësisë së treguesit*

Mesatar

---

### Treguesi C1.2.

*I llogaritur në bazë të formulës së mëposhtme:*

$$C1.2 = \frac{\text{Sasia e mbetjeve të grumbulluara në zonat e largëta} \left(\frac{\text{ton}}{\text{vit}}\right)}{\text{Sasia e mbetjeve të gjeneruara në zonat e largëta} \left(\frac{\text{ton}}{\text{vit}}\right)} \times 100$$

Shërbimi do të zgjerohet deri në Kalanë e Dodës në pothuajse 100% të territorit dhe me një grumbullim alternativ në Zall – Dardhë, Zall Reç, Lurë dhe Selishtë. E njëjta mënyrë alternative grumbullimi do të merret në konsideratë për fshatrat tejet të izoluar të Arrasit, Muhurrit, Sllovës, Fushë – Çidhës, Kastriotit, Tominit dhe Melanit. Për zonat pa akses është projektuar një total prej 2300 ton/vit mbetjesh

mikse. Në të gjithë zonën, e cila konsiderohet si zonë rurale, është projektuar të gjenerohen rreth 8300 ton/vit mbetje mikse. Prandaj, fshatrat të cilat do të kenë akses, pritet të gjenerojnë rreth 6000 ton/vit mbetje mikse. Duke marrë në konsideratë që rreth 60% e mbetjeve është organike dhe shumica e saj kompostohet në shtëpi, sasia totale e mbetjeve të thata për fshatrat e largët është projektuar të jetë 900 ton/vit; për të gjithë zonën rurale është 3300 ton/vit dhe për fshatrat e aksesueshëm është rreth 2400 ton/vit. Megjithatë, arritja e shkallës optimale të grumbullimit të mbetjeve është shumë e vështirë, për shkak të terrenit të vështirë dhe, duhet të theksohet këtu që, rreth 50% e sasisë së gjeneruar të mbetjeve nuk do të grumbullohet.

Për qëllime llogaritjeje, do të konsiderohen të largët fshatrat pa akses, siç tregohet edhe në hartën përkatëse, dhe nga sasia e projektuar prej 900 ton/vit do të zbritet 50% e grumbullimit - rreth 500 ton/vit.

Pilotimi i Kalasë së Dodës do të ofrojë mësim për zgjerimin dhe përmirësimin e shërbimit në Njësitë e tjera. Por, rezultatet mund të vërehen vetëm pas 2 – 4 vitesh nga fillimi i procesit.

*Plotësimi i formulës*

$$C1.2 = \frac{500}{900} \times 100$$

Përveç kësaj, është i nevojshëm një tjetër nëntregues për zonat rurale, për të marrë parasysh tipologjinë tejet rurale të Dibrës.

*Plotësimi i formulës, bazuar në supozimet e paraqitura më lart, me një potencial për sukses 70% në fund të kësaj periudhe planifikimi.*

$$C1.3 = \frac{2400 * 70\%}{2400} \times 100$$

*Investimet e kërkuara për të arritur performancën:*

Investimet janë minimale, pasi infrastruktura ekzistuese do të transferohet në këto zona. Megjithatë, janë të nevojshëm një minimum prej 50 kontenierësh 1.1 m<sup>3</sup> dhe një kontenier Skip prej 5 m<sup>3</sup> me një çmim total 1.5 milion Lek. Për Njësitë Administrative të përzgjedhura për këtë shërbim është i nevojshëm një kamion i vogël ngarkues, me një çmim rreth 1.5 milion Lek. Investimet totale janë 3 milion Lek.

*Niveli i saktësisë së treguesit*

Mesatar

---

### Treguesi C2:

Një shërbim më i mirë pritet në të gjithë qytetin, si dhe një ndarje më e mirë e detyrave për brigadën e grumbullimit të mbetjeve dhe të brigadës së fshirjes. Nëpërmjet një menaxhimi më të mirë të shërbimit, pastërtia e qytetit pritet të përmirësohet.

Do të caktohet një mbikëqyrje dhe rregulla monitorimi më të mira dhe për këtë arsye priten të dhëna më të mira në lidhje me cilësinë e shërbimit. Për periudhën e parë të propozuar (afatmesme) efikasiteti do të rritet me 10% dhe në fund të periudhës së planifikimit me 5 % më shumë.

*Investimet e kërkuara për të arritur performancën:*

Nuk kërkohen investime për të arritur këtë nivel performance. Cilësia e rrugëve pritet të përmirësohet sipas planit rregullues të Bashkisë.

*Niveli i saktësisë së treguesit*

Niveli i saktësisë së treguesit është mesatar dhe mund të forcohet edhe më tej.

---

### Treguesi C3:

Ky tregues lidhet me perceptimin e publikut, i cili është grumbulluar nëpërmjet pyetësorëve të shpërndarë tek qytetarët në zonat ku do të mundësohet shërbimi.

Një nga pyetjet është për llogaritjen e treguesve: **“A është i kënaqshëm shërbimi i grumbullimit të mbetjeve në shtëpinë/rrugën tuaj?”** Përgjigja “po” ose “jo”.

*I llogaritur në bazë të formulës së mëposhtme:*

$$C3 = \frac{\text{Numri i përgjigjeve "po"}}{\text{Numri i personave të intervistuar}} \times 100$$

Për të verifikuar nivelin e kënaqësisë, bazuar në metodologji, do t’u shpërndahen qytetarëve rreth 300 pyetësorë që përfshihen në zonat e shërbimit, me rreth 55,000 banorë gjithsej.

*Investimet e kërkuara për të arritur performancën:*

Lidhur me investimet e bëra. Nuk ka investime të mëtejshme.

*Niveli i saktësisë së treguesit*

Niveli i saktësisë së treguesit do të jetë i lartë.

### Treguesi D1:

Treguesi lidhet me sasinë e mbetjeve të cilat ndahen në burim dhe dërgohen për riciklim ose për forma të tjera trajtimi.

*I llogaritur në bazë të formulës së mëposhtme:*

$$D1 = \frac{\text{Sasia e grumbulluar e mbetjeve të ndara [t/vit]}}{\text{Sasia e mbetjeve të grumbulluara [t/vit]}} \times 100$$

Ashtu siç është përshkruar edhe në qasjen për zonat rurale dhe të largëta, grumbullimi i mbetjeve në këto Njësi Administrative do të fokusohet vetëm në mbetjen e thatë. Prandaj, në mënyrë ideale, mbetjet e grumbulluara do të konsiderohen si mbetje të grumbulluara në mënyrë të ndarë. Megjithatë, niveli i suksesit në grumbullim do të përcaktohet dhe do të vëzhgohet më vonë.

Sasia totale e mbetjeve të grumbulluara në zonat e largëta dhe në fshatrat me akses, pritet të jetë të paktën 30% e sasisë totale të projektuar për grumbullimin e mbetjeve, rreth 300 t/vit. Priten të grumbullohen mbetje shtesë nga depot në Selishtë dhe në Lurë, zona e gjelbër në qytetin e Peshkopisë dhe shkollat në zonat e shërbimit. Një sasi e tillë, e bazuar në normën e gjenerimit 0.3 kg/banorë, duke marrë në konsideratë 5.000 nxënës të shkollave (nga rreth 12.000 nxënës shkollash gjithsej), i shtohet sasisë së përgjithshme me 1.5 ton/ditë ose 550 ton/vit. Përveç kësaj, 40% e mbetjeve organike pritet të reduktohen në burim, në zonat e fshatrave me një sasi totale prej 2.500 ton/vit.

*Plotësimi i formulës*

$$D1 = \frac{3000}{13200} \times 100$$

*Investimet e kërkuara për të arritur performancën:*

Grumbullimi i diferencuar i mbetjeve kërkon një infrastrukturë të ndarë për secilën rrymë mbetjesh. Duke marrë parasysh një ndarje të ngushtë, siç është përshkruar në planin 5-vjeçar, investimet do të jenë minimale sepse më shumë përpjekje do të bëhet për edukimin e individëve, duke përdorur metodën e propozuar. Investimet shtesë për zonën e gjelbër do të jenë rreth 1000 – 2000 Euro.

*Niveli i saktësisë së treguesit*

Mesatar [Vlerësimi i numrit të udhëtimeve dhe i tonazhit të makinës drejt venddepozitimit.]

---

### Treguesi D2:

Ky tregues ka të bëjë me trajtimin e mbetjeve të grumbulluara.

*I llogaritur në bazë të formulës së mëposhtme:*

$$D2 = \frac{\text{Sasia e mbetjeve të trajtuara në mënyrën e duhur}}{\text{Sasia e mbetjeve të grumbulluara}} \times 100$$

Meqënëse nuk ka asnjë mundësi për trajtimin e mbetjeve gjatë kësaj periudhe të planit, e gjithë mbetja e grumbulluar do të depozitohet në venddepozitim të Peshkopisë. Një trajtim i tillë nuk njihet si një zgjidhje sanitare dhe venddepozitimi i kontrolluar nuk është një mundësi që pranohet nga legjislacioni kombëtar. Megjithatë, është një zonë zyrtare dhe janë marrë të gjithë masat e nevojshme për të reduktuar ndotjen në ajër, tokë dhe ujë. Për këtë arsye, konsiderojmë që trajtimi i mbetjeve është i rregullt dhe i vlefshëm për formulën. Do të merret parasysh një normë suksesi rreth 80% për grumbullim, me përpjekjen për ta përmirësuar deri në fund të periudhës së këtij plani.

*Plotësimi i formulës*

$$D2 = \frac{13,000 * 80\%}{13,000} \times 100$$

*Investimet e kërkuara për të arritur performancën:*

Për përmirësimin e gjendjes aktuale të venddepozitimit në kthimin e saj në një venddepozitim të kontrolluar, nevojitet një buxhet prej 5 milion Lek, që do të mbështetet nga fondet e donatorëve të jashtëm.

*Niveli i saktësisë së treguesit*

Niveli i saktësisë së treguesit do të jetë i lartë.

---

### **Treguesi E1:**

Treguesi lidhet me tarifën e llogaritur përkundrejt kostos totale, për të funksionuar i gjithë shërbimi.

*I llogaritur në bazë të formulës së mëposhtme:*

$$E1 = \frac{\text{Të ardhurat vjetore nga MM nëpërmjet tarifës} \left(\frac{\text{lek}}{\text{vit}}\right)}{\text{Kostoja vjetore për funksionimin e shërbimit} \left(\frac{\text{lek}}{\text{vit}}\right)} \times 100$$

Llogaritjet e kostos në këtë plan janë bërë në bazë të një modeli të konsoliduar të kostos. Prandaj, kostoja e propozuar është reflektuar në vendosjen e tarifës në plan. Saktësia e kostos do të përmirësohet gjatë vitit të dytë të funksionimit të planit, prandaj mbulimi 100% në planifikim do të marrë 2 vjet kohë.

*Plotësimi i formulës*

$$E1 = \frac{24,000,000}{24,000,000} \times 100$$

*Investimet e kërkuara për të arritur performancën:*

Nuk nevojiten investime.

*Niveli i saktësisë së treguesit*

**I lartë** [Kostoja e shërbimit: kostoja llogaritet në bazë të llogaritjes së kostos totale, duke përfshirë koston operacionale, amortizimin, kostot administrative. Të ardhurat: tarifa është llogaritur bazuar në një metodologji të qartë. Ka një tarifë specifike për gjenerues të ndryshëm (qytetarët, bizneset, institucionet, ...). Llogaritjet në vendosjen e tarifave dhe të shkallës së arkëtimit janë mëse të qarta.]

---

**Treguesi E2:**

Treguesi llogarit sasinë e të ardhurave përkundrejt kostos totale.

*I llogaritur në bazë të formulës së mëposhtme:*

$$E2 = \frac{\text{Të ardhurat vjetore nga MM nëpërmjet tarifës } \left(\frac{\text{lek}}{\text{vit}}\right)}{\text{Totali i të ardhurave të planifikuara } \left(\frac{\text{lek}}{\text{vit}}\right)} \times 100$$

Duke nisur nga viti 2017 Bashkia do të rrisë numrin e taksapaguesve, duke rritur tarifën dhe duke e përfshirë ndërmarrjen e ujësjellësit si një agjent të tarifës, në mënyrë që të rritet norma e grumbullimit të tarifës. Pritshmëritë bazohen tek vullneti i njerëzve për të paguar tarifën, siç është raportuar nga zyrtarët. Megjithatë, norma e grumbullimit të tarifës nuk do të rritet në mënyrë të menjëhershme. Pritet që të ndodhë një rritje me 10% në fazën e parë dhe 20% në përfundim të planit.

*Plotësimi i formulës*

$$E2 = \frac{24,000,000 * 60\%}{24,000,000} \times 100$$

*Investimet e kërkuara për të arritur performancën:*

Nuk ka nevojë për investime, por shumë përpjekje për të ndërtuar sistemin.

*Niveli i saktësisë së treguesit*

**I lartë** [Llogaritë transparente, por të arritshme nga pjesa e dytë e planit]

---

**Treguesi E3:**

Ka të bëjë me ekzistencën e një sistemi faturimi për klientët.

Një sistem i ri për vendosjen e tarifës do të vendoset që në vitin e parë të planit. Lëshimi i faturave për të gjithë qytetarët do të zbatohet në bashkëpunim me ndërmarrjen e ujësjellësit.

*Investimet e kërkuara për të arritur performancën:*

Për të ofruar shërbimin nevojiten pajisje zyre dhe specialist.


*Niveli i saktësisë së treguesit*

**I lartë** [Llogaritë transparente, por të arritshme nga pjesa e dytë e planit]

## 9.5 Politikat e tarifës

Vendosja dhe grumbullimi i tarifës ka nevojë për përmirësime të konsiderueshme, deri në fund të periudhës së planifikimit. Përmirësime të tilla janë të nevojshme jo vetëm për zbatimin e kësaj strategjie, por edhe për përgatitjen e Bashkisë për t’iu përgjigjur nevojave për një sistem të avancuar të menaxhimit të mbetjeve, sapo infrastruktura rrugore të zhvillohet dhe menaxhimi i integruar të zgjerohet në të gjithë territorin.

Prandaj, janë zhvilluar tre politika të cilat do të vihen në zbatim:




Tashmë ka shërbime që nuk janë zyrtare dhe nuk drejtohen nga Bashkia. Në disa fshatra, qytetarët paguajnë një individ të zonës për të grumbulluar mbetjet dhe për t’i depozituar ato në mjedis. Një aktivitet i tillë duhet të trajtohet në dy mënyra: 1) shmangia hap pas hapi e kësaj skeme; 2) ndërgjegjësimi i individëve për të paguar për një mjedis të pastër dhe grumbullimi ligjërish të tarifës.

### Zbatimi i politikës 1 dhe 2:

Paketa e re fiskale e 2017-ës ka zbatuar parimet duke rritur nivelin e tarifës dhe duke futur tarifë për zonën e re të zgjeruar. Një vështrim i detajuar i politikës së shpërndarjes së tarifës në zonën e re të zgjeruar gjendet bashkëngjitur.

Kjo politikë njeh faktin që, nëse nuk ofrohet shërbim nuk paguhet tarifë. Megjithatë, nxiten të gjithë qytetarët të paguajnë tarifën (një shumë minimale) për të mbështetur Bashkinë në zgjerimin e mëtejshëm të shërbimit dhe për të shërbyer si një mekanizëm për rritjen e ndërgjegjësimit.







### Zbatimi i politikës 3:

Ndërmarrja e ujësjellësit është konsideruar si një agjent për grumbullimin e tarifës. Brenda vitit 2017 do të zbatohet futja e tarifës së mbetjeve në sistemin e faturës së ujit.

Pagesa e tarifës është një koncept i vështirë për shumicën e individëve dhe niveli i besimit për të paguar shërbimet është shumë i ulët. Për të kapërcyer pengesa të tilla është i nevojshëm ndërtimi i një sistemi për rritjen e ndërgjegjësimit dhe një bashkëpunim i ngushtë përmes një kanali të drejtpërdrejtë komunikimi. Një sistem i tillë përfshin komunikimin direkt dhe transparent ndërmjet Bashkisë, Administratorëve dhe Kryepleqve të fshatit.






## 9.6 Tarifa mbulon koston

Bazuar në llogaritjen e kostove për periudhën e planifikimit 2017 – 2022, rezultojnë nivelet e mëposhtme të tarifave, të cilat plotësojnë më së miri operacionet e propozuara:

### Shpërndarja e kostove për Zonën 1 (Peshkopi – Tomin)


Zona e Shërbimit	Zona 1
Kosto Totale për Menaxhim [LEK/vit]	<b>15.826.562,78</b>



Kostot janë llogaritur ekuivalent për banorë. Normalisht, tarifat paguhen në bazë familjeje dhe përfshijnë tre kategori klientësh: a) Familjet; b) Bizneset; c) Institucionet.

Për këtë arsye, tarifa do të shpërndahet në këto tre grupe klientësh dhe për familjet do të llogaritet me një mesatare prej 4 – 5 anëtarësh secila.

Pesha e shpërndarjes së tarifës do të jetë si mëposhtë:




Duke marrë parasysh këtë shpërndarje, secila familje në zonën 1 të shërbimit do të paguajë një mesatare prej  $3,165 * 40\% = 1,266$  lek/vit, për të mbuluar plotësisht koston për modelin operacional të propozuar.


Përsa i përket bizneseve dhe institucioneve, tarifa do të vendoset bazuar në modele të ndryshme për bizneset e vogla, bizneset e mëdha dhe institucionet, duke marrë në konsideratë dhe normën e tyre të gjenerimit të mbetjeve (numrin e punonjësve).

### Shpërndarja e kostove për Zonën 2 (Maqellarë – Melan)

Zona e Shërbimit	Zona 2
Kosto Totale për Menaxhim [LEK/vit]	<b>5.588.260,11</b>



Pesha e shpërndarjes së tarifës do të jetë si më poshtë:



Duke marrë parasysh këtë shpërndarje, secila familje në zonën 2 të shërbimit do të paguajë një mesatare prej  $1,865 * 40\% = 746$  lek/vit, për të mbuluar plotësisht koston për modelin operacional të propozuar.

Përsa i përket bizneseve dhe institucioneve, tarifa do të vendoset bazuar në modele të ndryshme për bizneset e vogla, bizneset e mëdha dhe institucionet, duke marrë në konsideratë dhe normën e tyre të gjenerimit të mbetjeve (numrin e punonjësve).

Për të siguruar një menaxhim sa më të mirë të tarifës në Bashki do të vendoset dhe do të përditësohet rregullisht sistemi i modelimit të tarifës i zhvilluar nga *dldp*. Një sistem i tillë do të përmirësojë zbatimin e politikave dhe do të rrisë transparencën për qytetarët.

## 9.7 Procesi i fshirjes

### 9.7.1 Gjendja aktuale

Ky proces konsiston në fshirjen manuale të rrugëve, trotuareve, hapësirave ndërmjet ndërtesave apo pallateve, si dhe pastrimin e koshave të vegjël vetëm në Njësinë Administrative Peshkopi.

Puna bazohet në dy turne: Turni i parë, ku punonjësit merren me pastrimin dhe fshirjen e rrugëve kryesore dhe të bulevardit (orari 04:00 – 08:00) dhe turni i dytë që kryesisht kryen procesin e fshirjes në hapësirat publike (vetëm një pjesë e tyre, pasi lulishtet dhe shumica e hapësirave publike pastrohen nga ndërmarrja e gjelbërimit) dhe rrugët periferike të qytetit (orari 13:00 – 16:00).

Duke përfshirë rrugët kryesore dhe një pjesë të rrugëve periferike të qytetit, trotualet dhe një pjesë të hapësirave publike, rezulton **një sipërfaqe 70.329 m<sup>2</sup>** që pastrohet çdo ditë në secilin turn, rreth **45%** e sipërfaqes së lagjeve kryesore në total. Lagjet si ajo e Qendrës, Kaleci dhe e Tregut kanë sipërfaqen më të madhe të përfshirë në procesin e fshirjes, për shkak edhe të përqëndrimit të lartë të popullsisë dhe të aktiviteteve në to.

Gjithsej brigada e pastrimit ka 23 punëtorë, nga këta 1 është brigadier dhe 22 punonjës fshese.

Punëtorët punojnë 6 ditë në javë, me 220 ditë pune në vit (duke marrë në konsideratë edhe pushimet gjatë festave apo lejet vjetore).

**Tabela 21: Shpenzimet mujore dhe vjetore aktuale në lidhje me punonjësit e fshirjes, NJA Peshkopi**

	Nr.	Paga mujore (bruto)	Sig. Shëndt. (1.7%)	Sig. Shoq. (9.5%)	Tatim Page (13%-mbi 30 000)	Paga mujore (neto)	Shpenzime mujore Lek	Shpenzime vjetore Lek
Punonjës	22	23.040	392	2189	0	20.460	450.109	5.401.313
Brigadier	1	36.500	621	3468	845	31.567	31.567	378.804
Total	23						481.676	5.780.117

**Tabela 22: Shpenzimet vjetore aktuale në lidhje me mjetet e punës për punonjësit e fshirjes, NJA Peshkopi**

Nr.	Emërtimi	Afati	Çmimi/ njësi	Nr. i punonjësve	Mjete total /vit	Shpenzime vjetore
1	Fshesa plastike me bisht të gjatë për fshesarët	1 në çdo 6 muaj	500	22	44	22.000
2	Fshesa plastike dore për fshesarët	1 në çdo 6 muaj	400	22	44	17.600
3	Fshesa melakuqe për fshesarët	1 në çdo 3 muaj	300	22	88	26,400
4	Kaci për fshesarët	1 në çdo 3 muaj	80	22	44	3.520
5	Bishta fshese për fshesarët	1 në çdo 6 muaj	200	22	44	8.800
6	Doreza për punëtorët	1 palë në çdo 3 muaj	200	22	88	17.600
7	Sapun për punëtorët e transp. + fshesarët	1 copë në 1 muaj	60	22	264	15.840
8	Rroba pune	1 në vit	3.800	22	22	83.600
9	Mushama shiu	1 në vit	2.000	22	22	44.000
10	Çizme	2 palë në vit	600	22	44	26.400
11	Maska mbrojtëse	1 palë në 3 muaj	200	22	88	17.600
12	Lopata transporti	1 në çdo 6 muaj	200	22	44	8.800
13	Karroca fshesarësh	1 në 3 vjet	7.200	22	7	52.800
Total					843	344.960

**Tabela 23: Shpenzimet totale vjetore për NJA Peshkopi në lidhje me procesin e fshirjes**

Kosto Operacionale (Lek/vit)	5.780.117
Materiale Mbështetëse (Lek/vit)	344.960
Totali (Lek/vit)	6.125.077

### 9.7.2 Plani i fshirjes së qytetit Peshkopi (2017-2022)

Shërbimi i fshirjes nuk bazohet në një sistem normimi apo standardizimi. Gjithashtu, Bashkia nuk ka një rregullore pastrimi të qytetit dhe puna kryhet në bazë të përvojës shumëvjeçare.

Për këtë arsye, lind nevoja e vendosjes së një sistemi përlllogaritje të nevojave dhe operacioneve të fshirjes/pastrimit. Në kushtet e mungesës së një standardi kombëtar në këtë përlllogaritje, janë marrë në konsideratë normat nga qytete të tjera, të cilat kanë një sistem të konsoliduar pastrimi siç është qyteti i Durrësit.

### 9.7.3 Standardizimi i procesit të fshirjes

Ushtrimi i mëposhtëm bazohet në përvojën e grumbulluar në njësitë vendore me më shumë përvojë në këtë shërbim. Aktualisht (2017), nuk ka një manual shërbimi me norma të përcaktuara qartë të punës dhe të materialeve, të cilat mund të përdoren për të analizuar saktë nevojën operacionale, logjistike dhe financiare për këtë shërbim. Për këtë arsye, në këtë plan, shërbimi është përlllogaritur në bazë të kritereve të mirëpranuara deri më tani.


Shërbimi do të vijojë të kryhet vetëm në njësinë qytet (Peshkopi) dhe do të konsistojë në fshirjen dhe largimin e mbetjeve të grumbulluara, duke zgjeruar pak më shumë territorin që përfshihet aktualisht në procesin e fshirjes.

Kështu, normat ditore janë të përcaktuara në bazë të turneve, ku turni i parë ka një normë prej 13.400 m<sup>2</sup> për person dhe turni i dytë 20.000 m<sup>2</sup> për person.

Harta 18: Zona aktuale e shërbimit të fshirjes (NJA Peshkopi)



Shërbimi Aktual i Fshirjes (Peshkopi)





Sipërfaqja totale në të cilën kryhet shërbimi i fshirjes, siç është përmendur edhe më lart, është **70.329 m<sup>2</sup>**, nga të cilat **4.411 m<sup>2</sup>** janë *hapësira publike* dhe **65.918 m<sup>2</sup> rrugë** (të asfaltuara dhe të paasfaltuara). Kjo shtrirje do të vijojë të mbetet e njëjtë, por cilësia e shërbimit do të përmirësohet edhe me përmirësimin e rrugëve, të bulevardit dhe të shesheve.

**Tabela 24: Numri i punonjësve të nevojshëm bazuar në normat ditore të fshirjes, NJA Peshkopi**

Nr	Turnet	Procesi	Emërtimi i sip.	Njësia	Nr. i njësive	Norma ditore	Nr. i punonj.
1	I	Mirëmbajtje	Rr. të asfaltuara+ të paasfaltuara	m <sup>2</sup>	65.918	13.400	5
			Hapësira publike	m <sup>2</sup>	4.411		
			Totali turni I	m <sup>2</sup>	70.329		
2	II	Mirëmbajtje	Rr. të asfaltuara+ të paasfaltuara	m <sup>2</sup>	65.918	20.000	4
			Hapësira publike	m <sup>2</sup>	4.411		
			Totali turni II	m <sup>2</sup>	70.329		
Totali							9

Sipas tabelës së mësipërme, bazuar në normat ditore dhe të sipërfaqes që fshihet në qytetin e Peshkopisë, rezulton se janë të nevojshëm 9 punonjës për fshirjen. Këtij numri i duhet të shtohen edhe 2 punonjës zëvendësues për turn, nëse për arsye të ndryshme nevojitet zëvendësimi i ndonjë punonjësi.

Bazuar në llogaritje, rezulton se numri i nevojshëm i punonjësve për shërbimin e pastrimit është 5+2=7 (*turni I*) dhe 4+2=6 (*turni II*), përfshirë dhe 1 Brigadier, **Totali= 14 punonjës**.

**Tabela 25: Shpenzimet mujore dhe vjetore të standardizuara në lidhje me punonjësit e fshirjes, NJA Peshkopi**

	Nr.	Paga mujore (bruto)	Sig. Shënd. (1.7%)	Sig. Shoq. (9.5%)	Tatim page (13%-mbi 30 000 Lek)	Paga mujore (neto)	Shpenzime mujore Lek	Shpenzime vjetore Lek
Punonjës	13	23.040	392	2.189	0	20.460	265.974	3.191.685
Brigadier	1	36.500	621	3.468	845	31.567	31.567	378.804
Total	14						297.541	3.570.489

**Tabela 26: Tabela e materialeve logjistike**

Nr.	Emërtimi	Afati	Çmimi/ njësi	Nr. i punonjësve	Mjete total /Vit	Shpenzime vjetore
1	Fshesa plastike me bisht të gjatë për fshesarët	1 në çdo 6 muaj	500	13	26	12.800
2	Fshesa plastike dore për fshesarët	1 në çdo 6 muaj	400	13	26	10.240
3	Fshesa melakuqe për fshesarët	1 në çdo 3 muaj	300	13	52	15.600
4	Kaci për fshesarët	1 në çdo 3 muaj	80	13	26	2.048
5	Bishta fshese për fshesarët	1 në çdo 6 muaj	200	13	26	5.120
6	Doreza për punëtorët	1 palë në çdo 3 muaj	200	13	51	10.240
7	Sapun për punëtorët e transp + fshesarët	1 copë në 1 muaj	60	13	154	9.216
8	Rroba pune	1 në vit	3.800	13	13	48.640
9	Mushama shiu	1 në vit	2.000	13	13	25.600
10	Çizme	2 palë në vit	600	13	26	15.360
11	Maska mbrojtëse	1 palë në 3 muaj	200	13	52	10.400
12	Lopata transporti	1 në çdo 6 muaj	200	13	26	5.120
13	Karroca fshesarësh	1 në 3 vjet	7.200	13	4	30.720
Total					492	201.104

**Tabela 27: Shpenzimet totale vjetore të standardizuara për NJA Peshkopi në lidhje me procesin e fshirjes**

Kosto Operacionale (Lek/vit)	3.570.489
Materiale Mbështetëse (Lek/vit)	201.104
<b>Totali (Lek/vit)</b>	<b>3.771.593</b>

## 9.8 Menaxhimi i rrymave të tjera të mbetjeve

### 9.8.1 Mbetjet spitalore (të kujdesit shëndetësor)

Autoritetet vendore, në bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror të Shëndetit, duhet të monitorojnë dhe të menaxhojnë mbetjet spitalore, si dhe të parandalojnë përzierjen e tyre me mbetjet urbane. Bazuar në ligjin përkatës, Bashkia nuk mund të përfshijë në shërbimin e saj të menaxhimit të mbetjeve tërheqjen e mbetjeve spitalore. Rregullorja Nr. 6 datë 30.11.2007 “Për menaxhimin e mbetjeve spitalore” përcakton, në mënyrë të qartë, detyrimet e prodhuesve të mbetjeve spitalore dhe fazat e grumbullimit dhe të depozitimit të këtyre mbetjeve.

Përpyekjet kryesore do të bëhen për të vendosur kontroll mbi mbetjet e gjeneruara nga spitali i qytetit të Peshkopisë, të cilat u gjetën në kontenerët e Bashkisë (monitorimi i kryer në Shkurt 2017).

### 9.8.2 Mbetjet elektrike dhe elektronike (MEE)

Qeveria Shqiptare ka aprovuar një VKM Nr. 957, datë 19.12.2012 “Për mbetjet që vijnë nga pajisjet elektrike dhe elektronike”, duke përcaktuar disa rregulla në lidhje me menaxhimin e këtyre mbetjeve”.

Në kreun IX-të i këtij Vendimi, paragrafi 5 përcakton se qeverisjet vendore duhet të llogarisin peshën totale të hyrjeve dhe të daljeve në territorin e tyre gjatë vitit kalendarik të mëparshëm dhe përqindjet respektive, siç përcaktohet në këtë vendim dhe duhet t’i rregjistrojnë këto të dhëna në rregjistrat e tyre të krijuar për këtë qëllim.

Në kreun IX-të të këtij Vendimi, paragrafi 5 përcakton: Prodhuesit, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore, duhet të marrin masat e nevojshme që konsumatorët të jenë pjesë e grumbullimit të diferencuar të MEE dhe të inkurajohen për të ndihmuar në procesin e ripërdorimit, të trajtimit dhe të rikuperimit.

Në këtë kontekst, Bashkia do të fokusohet në dy drejtime:

1. Pastrimi i lumenjve dhe i zonave ku për vite me rradhë janë depozituar mbetjet elektrike dhe elektronike;
2. Ndërtimi i qendrave për grumbullim të diferencuar të MEE të gjeneruar nga familjet dhe ndalimi i depozitimit të tyre në venddepozitime apo zona të tjera. Në të njëjtën kohë, Bashkia do t’u kërkojë pronarëve të MEE të respektojnë rregulloret vendore dhe VKM-në e lartpërmendur për të grumbulluar këto mbetje dhe për të monitoruar zbatimin e rregullave.

Sasia e mbetjeve të gjeneruara nuk mund të matet. Për këtë arsye, e vetmja masë që mund të merret është grumbullimi i tyre. Bashkëpunimi me institucionet e tjera, si për shembull Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit dhe i Pyjeve (ISHMP), është kyç për kontrollin e këtij procesi.

### 9.8.3 Mbetjet nga vajrat e përdorur

Është shumë e rëndësishme të kryhet grumbullimi i këtyre mbetjeve, në mënyrë që të shmanget ndotja mjedisore, dhe, në të njëjtën kohë, për të përfitur nga riciklimi dhe përdorimi i këtyre substancave. Për këtë arsye, industria, konsumatorët dhe garazhet e automjeteve duhet të përfshihen në nismën e grumbullimit, duke minimizuar derdhjen e vajrave të përdorur dhe duke i dërguar ato tek grumbulluesit e autorizuar. Duke krijuar skemat publike – private për grumbullim,

asgjësim dhe riciklim të këtyre mbetjeve, shkarkimi i pakontrolluar i tyre duhet të shoqërohet nga një numër i madh masash administrative.

Sasia e mbetjeve të gjeneruara nuk mund të matet. Për këtë arsye, e vetmja masë që mund të merret është grumbullimi i tyre. Bashkëpunimi me institucionet e tjera, si për shembull Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit dhe i Pyjeve (ISHMP), është kyç për kontrollin e këtij procesi.

#### 9.8.4 Mbetjet nga gomat e përdorura

Inspektimi i aktiviteteve të paligjshme të grumbullimit privat dhe i tregtimit të gomave të përdorura, regjistrimit, mbledhjes të të dhënave në lidhje me sasinë e mbetjeve, si dhe parandalimi i djegies së pakontrolluar, mbeten detyrat parësore gjatë kësaj periudhe planifikimi.

Këto mbetje kanë një vlerë të lartë kalorifike, kështu që ato përfaqësojnë një produkt me vlerë të lartë energjitike, për të ushqyer dhe furnizuar me energji impiantet e ardhshme të trajtimit të mbetjeve (nëse ato do të ndërtohen në të ardhmen në rajon ose në vend).

Sasia e mbetjeve të gjeneruara nuk mund të matet. Për këtë arsye, e vetmja masë që mund të merret është grumbullimi i tyre. Bashkëpunimi me institucionet e tjera, si për shembull Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit dhe i Pyjeve (ISHMP), është kyç për kontrollin e këtij procesi.


## 9.9 Struktura e ofrimit të shërbimit

Për të arritur shtrirjen e shërbimit dhe nivelin e performances, duhet të përmirësohet dhe të rregullohet struktura e menaxhimit të mbetjeve. Kjo përfshin një strukturë vertikale më të mirë dhe vendosjen e rregulloreve të duhura. Për të siguruar një angazhim të plotë dhe për të mundur shërbimin e kërkuar, është e nevojshme një përshkrim më i mirë i punës ose të paktën një ndarje më e mirë e punës për stafin ekzistues.

Për këtë arsye, janë parashikuar dy rregullore kryesore:

1. Struktura e menaxhimit
2. Rregullore lokale për menaxhimin e mbetjeve

Më poshtë jepet struktura e menaxhimit, ndërkohë që bashkëngjitur me dokumentin gjendet edhe rregullorja.



Përshkrimi i punës së strukturës do të përpunohet më tej dhe efikasiteti i punës së tyre do të kontrollohet nga Drejtoria. Struktura do të ketë dy objektiva kryesore: 1) Të sigurohet ofrimi i shërbimit në të gjithë zonën; 2) Të kontrollohet cilësia dhe monitorimi.

## 10 Plani i veprimit

Objektivi specifik: SO1: Shërbimi i grumbullimit të mbetjeve përfshin rreth 50% të Bashkisë deri në vitin 2017 dhe shtrihet në të gjithë Bashkinë deri në vitin 2022						
Nr.	Titulli i veprimit	Përshkrim i shkurtër	Mjetet e zbatimit dhe partnerët	Afatet kohore	Burimet	
					Të disponueshme	Të nevojshme
1.1	Investim në përmirësimin e sistemit të grumbullimit të mbetjeve në qytetin e Peshkopisë dhe një pjesë të Njësisë Administrative Tomin	Veprimi konsiston në zëvendësimin e të gjithë sistemit të grumbullimit të qytetit, duke përfshirë kontenierët dhe kamionin. Infrastruktura përfshin të gjithë qytetin e Peshkopisë dhe fshatrat e aksesueshëm me rrugë të asfaltuara të Tominit, Muhurrit dhe Kastriotit.	Bashkia Dibër me mbështetje të programit të dldp	Maj – Dhjetor 2017	78800 Eur	-
1.2	Vendosja e një sistemi për grumbullimin e mbetjeve për 50% të Bashkisë Dibër	Shtirirja e shërbimit do të përfshijë përmirësimin e shërbimit në Maqellarë dhe Melan, duke mbuluar të gjithë fshatrat e aksesueshëm me rrugë të asfaltuara dhe zhvendosjen e infrastrukturës ekzistuese të qytetit të Peshkopisë, që përfshin 60 kontenierë dhe 1 kamion 10 tonësh. Për herë të parë përfshihen në shërbim fshatrat e aksesueshëm të Kalasë së Dodës, Slllovës, Fushë Çidhës dhe Kastriotit.	Bashkia Dibër me mbështetje të programit të dldp	Maj – Dhjetor 2017	-	-
1.3	Investime në skemat alternative të grumbullimit të mbetjeve për Njësinë Administrative Kala e Dodës (pilotim)	Ky shërbim do të pilotojë një skemë mikse për grumbullimin e brendshëm, duke punësuar një mjet të vogël dhe një person, i cili do të grumbullojë derë më derë dhe do t'i dërgojë këto mbetje tek kamioni një ose dy herë në	Bashkia Dibër me mbështetje të programit të dldp	Maj – Dhjetor 2017	-	-

		muaj, sipas nevojave. Në këtë shërbim përfshihet promovimi i zvogëlimit të mbetjeve organike në burim. Detajet e kësaj skeme janë dhënë në shtojcën përkatëse të këtij plani.				
1.4	<b>Zbatimi i një sistemi alternativ për grumbullimin e mbetjeve në Njësinë Administrative Muhurr, Arras, Selishtë, Luzni, Zall Reç, Zall Dardhë, Lurë</b>	Shërbimi përfshin një sistem alternativ për grumbullimin e brendshëm të mbetjeve nëpërmjet kontenierëve Skip. Gjithashtu, përfshin vendosjen e një depoje grumbullimi për mbetjen e thatë në Lurë dhe Selishtë. Detajet e kësaj skeme janë dhënë në shtojcën përkatëse të këtij plani.	Bashkia	2018	1000 Euro kontenieri Skip	Kamioni për kontenierin Skip 25000 Euro ose marrje me qera
1.5	<b>Përmirësimi i sistemit të grumbullimit të mbetjeve, duke zgjeruar më tej shërbimin në zonë</b>	Kjo skemë do të zbatohet vetëm nëse do të përmirësohet në të ardhmen infrastruktura rrugore, si për shembull rruga që lidh Muhurr, Arras dhe Fushë Çidhën dhe me lidhje të mëvonshme të Fushë Çidhës me Kastriotin. Zgjerimi i mëtejshëm do të ndodhë pasi i gjithë rrjeti rrugor të arrijë edhe në zonat më të largëta si Zall Reç, Lurë dhe Selishtë.	Bashkia, Këshilli i Qarkut, AZHR, FSHZH	2018 - 2025	Buxhet vjetor rreth 10000 Euro për kontenierët dhe kostot operacionale	Nuk mund të llogaritet > 10000 Euro
1.6	<b>Zbatimi i një fushate ndërgjegjësimi për komunitetin</b>	Fushata do të zhvillohet për të promovuar sistemin e ri dhe për të edukuar individët për ta respektuar këtë sistem, për të shmangur hedhjet e mbetjeve në mjedis dhe depozitimin e tyre në natyrë. Materialet e fushatës do të zhvillohen nga projekti dhe do të shpërndahen tek qytetarët.	Bashkia Dibër me mbështetje të programit të dldp	2017 – në vazhdim	8000	-
1.7	<b>Krijimi i një strukture të zgjeruar për shërbimet publike në nivel bashkie dhe zhvillimi i një rregulloreje lokale</b>	Struktura është e nevojshme për të mbuluar shërbimin e zgjeruar dhe për të përmirësuar performancën e shërbimit. Kjo strukturë nuk do të ndryshojë shumë nga ajo ekzistuese, por do të përcaktojë më mirë detyrat dhe përgjegjësitë.	Bashkia	2017	Asnjë	Asnjë

1.8	<b>Ndërtimi i një objekti sanitar për trajtimin e mbetjeve në Bashkinë e Dibrës</b>	Ndërtimi i një objekti sanitar për trajtimin e mbetjeve është një projekt që mund të zhvillohet pas 5 – 10 vjetësh. Një objekt i tillë mund të jetë një venddepozitim lokal, rajonal ose një stacion transferimi. Venddepozitimi ekzistues do të mbyllet hap pas hapi, bazuar në procedurat e përcaktuara në planin operacional. Ndërtimi i këtij objekti do të kërkojë një studim fizibiliteti, për të kuptuar shkallën e ekonomisë dhe potencialin e mundshëm të zonës.	Bashkia me mbështjen e Qeverisë Shqiptare dhe të donatorëve	2020 - 2025	Asnjë	Më shumë se 500K Euro
1.9	<b>Ndërtimi i një zone për mbetjet inerte/të ndërtimit</b>	Aktualisht mbetjet inerte depozitohen, në mënyrë jo zyrtare, në një zonë në afërsi të lumit Dohoshisht. Kjo zonë do të pastrohet dhe do të përdoret për venddepozitimin e këtij materiali. Duhet të identifikohet një zonë për depozitim të ligjshëm dhe të ndërtohet në bazë të VKM-së Nr. 575, datë 24.06.2015 dhe VKM-së Nr. 452, datë 11.07.2012.	Bashkia	2018 - 2020	Asnjë	>500K Euro por varet nga studimi i fizibilitetit
1.10	<b>Ndërtimi i një objekti për mbetjet elektronike, elektrike, bateritë, gomat dhe vajrat</b>	Duhet të krijohet një zonë shumëfunktionale për grumbullimin dhe një skemë me shkallë të vogël. Rojet e mbetjeve duhet të informohen bazuar në rregullat e VKM-ve përkatëse. Kompanitë janë përgjegjëse për menaxhimin e situates, prandaj duhen bërë përpjekje për bashkëpunim. Skema do të vendoset vetëm kur të arrihen marrëveshjet me grumbulluesit e mbetjeve dhe kur zotëruesit e këtyre mbetjeve të jenë të gatshëm të sjellin vetë mbetjet në zonë.	Bashkia dhe sektori i bizneseve dhe ISHMP	2018 – në vazhdim	Akordimi i zonës me zonat industriale	Asnjë
1.11	<b>Zbatimi i skemave të kompostimit në qytetin e Peshkopisë</b>	Duhet të ndërtohet një zonë për kompostimin e mbetjeve organike në një zonë ish-industriale,	Bashkia	2018	~ 2000 Euro	Asnjë



mbi të cilën ka leje Bashkia dhe që plotëson kriteret e VKM-së Nr.608, datë 17.09.2014 “Për mbetjet organike”. Një skemë e vogël për kompostimin e mbetjeve do të fillojë në shkolla, institucione dhe biznese, duke u zgjeruar deri tek familjet. Një sistem i vogël grumbullimi do të vendoset në qytetin e Peshkopisë, duke përfshirë 10 - 15 kontenierë 70 lt dhe duke përdorur një mjet të vogël për grumbullimin dhe ndërtimin e një zone anaerobike.

Objektivi specifik: SO2: Qytetarët e Bashkisë mbështesin plotësisht zgjerimin e shërbimit dhe kontribuojnë nëpërmjet tarifës me të paktën 60%						
Nr.	Titulli i veprimit	Përshkrim i shkurtër	Mjetet e zbatimit dhe partnerët	Afatet kohore	Burimet	
					Të disponueshme	Të nevojshme
2.1	Zbatimi i një sistemi për menaxhimin e klientit dhe të tarifës	Sistemi i zhvilluar nga dldp do të përditësohet dhe, përfundimisht, do të vendoset dhe do të menaxhohet nga sektori i menaxhimit të mbetjeve, në bashkëpunim me zyrën e taksave. Përditësimi do të kërkojë grumbullim të mëtejshëm të të dhënave dhe verifikim të tyre, veçanërisht për familjet. Është e nevojshme që me zgjerimin e sistemit të përditësohen rregullisht të dhënat.	Bashkia me mbështetje nga zyrat që mbajnë të dhënat, bizneset, qytetarët, pronarët, institucionet.	2017 – në vazhdim	Asnjë	Asnjë
2.2	Vendosja e tarifës së mbetjeve në faturën e ujit	Pasi janë bërë llogaritjet, në bashkëpunim të ngushtë me ndërmarrjen e ujësjellësit, tarifa për menaxhimin e mbetjeve do të përfshihet në faturën e ujit. Kjo pritet të përmirësojë normën e arkëtimit, e cila është shumë e kufizuar në kategorinë e qytetarëve.	Bashkia në bashkëpunim me ndërmarrjen e ujësjellësit	2017 – në vazhdim	Asnjë	Asnjë

2.3	<b>Zbatimi i mbledhjes së tarifës</b>	Kjo përfshin një komunikim më të mirë dhe ndërgjegjësim të qytetarëve, si dhe imponim bazuar në shërbimet e tjera. Në një fazë të mëvonshme do të angazhohen agjentët për mbledhjen e tarifës.	Bashkia	2017 – në vazhdim	Asnjë	Fonde për zhvillimin e një sistemi faturimi
-----	---------------------------------------	--	---------	-------------------	-------	---

Objektivi specifik: SO3: Qyteti i Peshkopisë është njësi e parë administrative e cila do të udhëheqë më tej grumbullimin dhe diferencimin e mbetjeve në Bashkinë Dibër						
Nr.	Titulli i veprimit	Përshkrim i shkurtër	Mjetet e zbatimit dhe partnerët	Afatet kohore	Burimet	
					Të disponueshme	Të nevojshme
3.1	<b>Zbatimi i një skeme për diferencimin e mbetjeve në qytetin e Peshkopisë</b>	Kjo përfshin përcaktimin e disa zonave, si për shembull Zona e Gjelbër ( <i>bulevardi kryesor</i> ), ku do të vendosen kosha për tre rryma mbetjesh dhe për bateritë, si një zgjidhje inovative. Një zonë për ndarjen me dy rryma të mbetjeve, në të thata dhe të njoma, do të vendosen në lagjet kryesore. Një zonë e sistemit derë më derë do të zhvillohet në një nga lagjet e qytetit. Për më tepër, zona e llixhave do të ketë një sistem të brendshëm, modern për grumbullimin e mbetjeve. Edhe në shkolla do të futet sistemi i ndarjes së mbetjeve. Mbetjet do të transferohen në venddepozitimin e qytetit, ku mbetja e thatë do të ndahet nga punëtorët dhe do t'u shitet kompanive të riciklimit.	Bashkia dhe institucione të tjera në qytet	2017 – në vazhdim	3000 Euro	Përputhje e plotë me ligjin, nevojiten më shumë se 50.000 Euro vetëm për skemën e grumbullimit
3.2	<b>Zbatimi i një skeme të plotë të ndarjes së mbetjeve nga gjenerimi deri tek trajtimi</b>	Një skemë e tillë duhet të ketë përputhje të plotë me kuadrin ligjor aktual për mbetjet. Një sistem i tillë është shumë modern dhe kompleks për situatën.	Bashkia dhe Qeveria Shqiptare	2022 - 2030	Asnjë	Më shumë se 2M Euro

Objektivi specifik: SO4: Deri në vitin 2017, venddepozitimi i Bashkisë Dibër do të kthehet në një venddepozitim të kontrolluar dhe në gjendje për të mbajtur mbetjet nga shërbimi i zgjeruar						
Nr.	Titulli i veprimit	Përshkrim i shkurtër	Mjetet e zbatimit dhe partnerët	Afatet kohore	Burimet	
					Të disponueshme	Të nevojshme
4.1	Investim në përmirësimin e menaxhimit të riskut të venddepozitimit aktual të Peshkopisë	Investimet përfshijnë përforcimin e zonës ekzistuese, zgjerimin e zonës, rritjen e kapacitetit, trajtimin më të mirë të mbetjeve dhe zvogëlimin e ndikimit në mjedis, në shëndet dhe në peisazh. Detajet e investimeve i janë bashkëngjitur këtij plani.	Bashkia Dibër me mbështetje të programit të dldp	2017-2018	35000 Euro	Asnjë
4.2	Përmirësimi i operacioneve në venddepozitimin e modernizuar	Do të zhvillohet një plan operacional, i cili do të ndiqet nga punonjësit e zonës për të përmirësuar menaxhimin e mbetjeve, për të reduktuar sasinë e mbetjeve, për të mbrojtur zonën dhe mjedisin.	Bashkia Dibër me mbështetje të programit të dldp	2017	Asnjë	Asnjë
Objektivi specifik: SO5: Bashkia e Dibrës rehabiliton shumicën e zonave të ndotura (venddepozitimet e paligjshme) deri në vitin 2022						
Nr.	Titulli i veprimit	Përshkrim i shkurtër	Mjetet e zbatimit dhe partnerët	Afatet kohore	Burimet	
					Të disponueshme	Të nevojshme
5.1	Marrja përsipër e aktiviteteve për pastrim	Aktualisht, ka më shumë se 100 zona të ndotura me mbetje të depozituara në tokë ose në trupat ujorë. Disa nga këto vende depozitimi janë përgjatë rrugëve kombëtare, rrymave kryesore ujore dhe qendrave të fshatrave. Aktivitetet do të planifikohen dhe kryhen çdo vit nga buxheti. Zbatimi i këtyre aktiviteteve do	Bashkia	2017 – në vazhdim	5000 Euro çdo vit	Një venddepozitim i ri më shumë se >300 Euro

		të përfshijë kryepleqtë e fshatrave, të cilët do të kenë komunikim direkt me qytetarët dhe do të monitorojnë aktivitetin.				
5.2	Shmangia e hedhjes së mbetjeve në natyrë ose në mënyrë të paligjshme	Pastrimi, rehabilitimi dhe sinjalistika e nevojshme në zona. Zbatimi i aktiviteteve duke përfshirë kryepleqtë e fshatrave, të cilët do të kenë komunikim direkt me qytetarët dhe do të monitorojnë aktivitetin.	Bashkia	2017 – në vazhdim	Asnjë	Asnjë

## 11 Monitorimi dhe performanca

### 11.1 Objekti

Ky sistem monitorimi ka për qëllim të përcaktojë detyrat e secilës prej hallkave të përfshira në sistem, mënyrën e raportimit të llogaridhënies, si dhe komunikimin mes aktorëve kryesorë, përgjegjës për mbarëvajtjen e shërbimit të pastrimit.

### 11.2 Aktorët e monitorimit

Aktori	Bashkia (Drejtorja e Shërbimeve Publike)	Administratori dhe Inspektorët	Supervizorët	Kontrollori në venddepozitim	Brigadieri/ët e shërbimit	Qytetarët
Detyrat	Bën grumbullimin, përpunimin e informacionit, harton raporte dhe jep direktiva. Raporton tek kryetari i Bashkisë.	Lidhja kryesore me qytetarët. Njohje më e mirë e zonave të tyre. Raportojnë tek supervizorët.	Koordinatorët lidhin Bashkinë - Ofruesin e shërbimit – Qytetarët. Raportojnë tek Drejtorja e Shërbimeve Publike.	Raporton tek supervizorët.	Mban raporte të detajuara dhe raporton tek supervizori.	Raportojnë/ankohen në rajone; Zyra me një ndalesë, Telefon/façe internet e Bashkisë; Media

Figura1: Shkalla hierarkike dhe frekuenca e raportimit





Figura2: Mënyra e raportimit dhe e komunikimit



### C. Detyrat kryesore të ekipit monitorues

#### Bashkia (Drejtoria e Shërbimeve Publike)

- Përcakton prioritetet, termat e tenderit, planin e menaxhimit të mbetjeve
- Përcakton strategjinë e komunikimit mbi grumbullimin e mbetjeve, fshirjen dhe larjen e rrugëve
- Përcakton buxhetet, miraton faturat, përfshirë gjobat
- Blen materiale të reja (kazanë) dhe hap tenderat e rinj, nëse është e nevojshme
- Përcjell shqetësimet e këshillit/kryetarit/qytetarëve në lidhje me shërbimin e ofruar
- Negocion me kompaninë në rast mosmarrëveshjes
- Raporton periodikisht (një herë në javë) tek kryetari i bashkisë

#### Kryetari i Rajonit

- Kontrollon çdo ditë (vetë ose nëpërmjet inspektorëve) shërbimin e ofruar ndaj qytetarëve dhe raporton tek supervizori (një herë në javë);
- Verifikon cilësinë dhe sasinë e shërbimit (një herë në javë): kazanë të papastruar, rrugë jo të fshira, pika grumbullimi jo të pastra, kazanë të dëmtuar;
- Verifikon dhe përshtat nevojat për kazanë:
  - ✓ Kur ka shumë kazanë (ata janë bosh): propozon pakësimin
  - ✓ Kur kazanët nuk mjaftojnë (kazanë të mbushur plot dhe mbetje në rrugë): propozon shtimin;
  - ✓ Propozon të zhvendosë / të heqë ose të shtojë pika grumbullimi

- ✓ Identifikon nevojat e veçanta: p.sh. mbetje inerte për t'u mbledhur, ngjarje, bën propozime tek supervizorët (kur nevojitet)
- Jep informacion:
  - ✓ Kompanisë + supervizorit, menjëherë për çdo mangësi në cilësi / sasi:
  - ✓ Kananë të papastuar - (ID e kazanit, rrugën, ditën dhe orën e vëzhgimit)
  - ✓ Rrugë jo të fshira - (rrugët, ditën dhe orën e vëzhgimit)
  - ✓ Kananë të dëmtuar - (ID e kazanit, rrugën, llojin e dëmtimit, ditën dhe orën e vëzhgimit)
  - ✓ Kananë që nuk lahen një herë në muaj
  - ✓ Bashkisë një herë në muaj, përmbledhje e mangësive në cilësi / sasi
  - ✓ Raport mujor, si bazë e raportit për bashkinë, ndëshkimet dhe gjobat e mundshme
- Kryetarët e rajoneve/administratorët mbajnë një regjistër të grumbullimit të mbetjeve + pastrimi i rrugëve (fshirje, mirëmbajtje dhe larje) i cili përmbledh:
  - ✓ Kontrollat e tyre ditore
  - ✓ Komunikimet e menjëhershme të problemeve (të shkruara në formularë të tjerë)
  - ✓ Pjesë të raportit mujor

### Supervizorët

- Koordinimi mes kryetarëve të lagjeve/rajoneve, administratorëve, bashkisë dhe ofruesit të shërbimit për zbatimin dhe funksionimin e mëtejshëm të sistemit.
  - ✓ Sqaron kompaninë për punën që do të bëjë (pikat e grumbullimit, pozicionimi i kazanëve, zonat/rrugët që do të pastrohen e do të lahen, grafiku).
  - ✓ Verifikon planin e punës së ofruesit të shërbimit, nëse ky i fundit përmbush kërkesat (punën që duhet bërë) dhe nevojat e publikut në çdo kohë.
  - ✓ Verifikon që specifikimet teknike dhe kërkesat ligjore janë përmbushur nga ofruesi i shërbimit në çdo kohë.
  - ✓ Organizon takime me të gjithë partnerët (kryetarët e rajoneve, departamentin e shërbimeve publike dhe përfaqësuesit e kompanisë), kur është e nevojshme.
- Krijimin e statistikave dhe kontrollin e sasive (formulari në excel)
  - ✓ Grumbullon të dhënat mujore të ofruara nga kompania (statistika të dhëna nga kompania), çdo muaj.
  - ✓ Grumbullon të dhënat e ofruara nga kryetarët e lagjeve/rajoneve dhe kontrolluesi në dispozicion, çdo javë (formulari Shtojca 1).
  - ✓ Verifikon të dhënat, çdo javë.
  - ✓ Bën kontrole fizike në zonë, takon kryetarët e rajoneve/lagjeve dhe kërkon sqarime shpesh, çdo ditë ose kur është e nevojshme.
- Përgatitja javore dhe mujore e raporteve në bashki, bazuar në raportet e kryetarëve të lagjeve/rajoneve dhe sipas statistikave përkatëse.
  - ✓ Sasitë e shërbimeve: kontrollon vlefshmërinë e faturimit
  - ✓ Në mungesë të cilësisë: kananët e pambledhur, rrugët e papastuara, pikat e grumbullimit jo të pastra, kananët e dëmtuar të hedhur jashtë venddepozitimit
  - ✓ Bën propozime masash administrative (gjobash) në Bashki, nëse është e nevojshme: bazuar në kontratat, raportet dhe statistikave të kryetarëve të lagjeve/rajoneve.

- ✓ Nëse shërbimi kalon me sipërmarrje private, kërkon nevoja specifike tek kompania në bazë të kontratës dhe buxhetit:
  - ✓ Mbledhje e mbetjeve voluminoze.
  - ✓ Pastrim (mbledhja e mbetjeve, pastrimi, larja) në rastet e ngjarjeve të veçanta.
  - ✓ Vendos zvogëlimin ose lëvizjen e kazanëve, ose propozon rritjen e numrit të tyre nëse është e nevojshme.
  - ✓ Informon menjëherë kompaninë dhe ndëshkon në rast të mungesës së cilësisë. Kontrollon zgjidhjen efektive të problemeve.
- Bën propozime për përshtatjen/përmirësimin e sistemit:
    - ✓ Në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë partnerët.
    - ✓ Propozon fushata shtesë për komunikimin, për të rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve.
    - ✓ Shqyrton dhe, bazuar në propozimet e brigadierit, i propozon bashkisë:
      - Ndryshimin e orareve të grumbullimit
      - Shtimin e kazanëve aty ku është e nevojshme
      - Zvogëlimin e numrit të kazanëve ku është e nevojshme ose zëvendësimin e tyre
      - Shtimin e pikave të reja të grumbullimit
      - Propozime për përmirësimin e shërbimeve, rikuperimin e mbetjeve etj.

Të dhëna të siguruara nga ofruesi i shërbimit/brigadieri për Supervizorët

### **Statistika të ofruara nga kompania**

Kontraktuesi duhet të mbajë statistika ditore në pikat kryesore dhe t'i raportojë ato çdo muaj, në formë elektronike apo në letër, tek mbikqyesi.

- ✓ Sasinë ditore të mbetjeve të grumbulluara dhe të depozituara në venddepozitim
- ✓ Numrin e kazanëve të pastruar
- ✓ Orët e sakta të grumbullimit: kohën e saktë të nisjes së kamionëve, kohën e zbrasjes në venddepozitim dhe kohën e kthimit në garazh
- ✓ Kilometrat ditore të çdo kamioni
- ✓ Numrin ditor dhe itinerarin e lëvizjes së kamionëve
- ✓ Listën ditore të pastrimit dhe të larjes së rrugëve
- ✓ Oraret ditore të larjes dhe të fshirjes manuale/ mekanike
- ✓ Listën e punonjësve dhe oraret ditore të punës
- ✓ Inventarin mujor të kazanëve, nga rruga në rrugë dhe gjendjen fizike të tyre
- ✓ Zhvendosjen, mbajtjen ose humbjen e kazanëve: kazanët e larë: listën e kazanëve me probleme (rrugën, numrin e kazanit), riparimet specifike, datën etj.
- ✓ Sasinë e mbetjeve të riciklueshme të grumbulluar/përpunuar nga qendra(t) e grumbullimit
- ✓ Marrjen e komenteve/reagim ndaj kërkesave të kryetarëve të lagjeve/rajoneve ose supervizorit rreth mungesës së cilësisë apo të sasisë së grumbulluar

### **Kontrollori në venddepozitim**

- ✓ Raporton mbi aktivitetet në venddepozitim, kontrollon dhe mbledh informacione mbi sasinë e shërbimit



- ✓ Raporton për çdo kamion: ID-në e kamionit, orën, llojin e mbetjeve (nëse është e veçantë)
- ✓ Raporton orët e punës së makinerive (buldozerit)
- ✓ Raporton për ndonjë ngjarje të veçantë në venddepozitim: zjarr, aksident, etj. dhe kontrollon cilësinë e mbetjeve
- ✓ Informon supervizorin në rast mbetjesh ose kamionësh jo në përshtatje me atë çka është përcaktuar
- ✓ Siguron raporte javore për supervizorin (formulari Shtojca 2)




Aneks 1: Raport javor qe pergatisin Kryetaret e rajoneve /Administratoret per Supervizorin												
Rajoni:		Emri i kryetarit te rajonit:		Muaji: / 2015			I eshte dhene supervizorit me dt. _____ (para dt.5 te muajit pasardhes):					
ID (ose ne mungese emri) i pikes grumbullimit	Per t'u lare ne kohen e veres	Grumbullimi i mbeturinave			Mirembajtje e rrugeve	Fshirja e rrugeve	Larja e rrugeve	Data e vezhgimit	Data e komunikimit me kompanine dhe supervizorin	Data e riparimit te problemit	Problemete tjera, probleme me sasite, nevoja per zhvendosje kazaneshtj.	
		Numri i kazaneve	shpeshtesia 1 diteose 1 here ne 2 dite	mungese cilësie, nese ka: kazane jo te pastruar, kazane te demtuar : ID, kazane te palare, kazane qe mungojne : ID	Mungese mirembajtjeje : pike grumbullimi jo e pastruar çdo dite; rruge jo e mirembajtur çdo dite, data	Mungesesisieosecil esie : rrugjetefshirakeq; data	Mungese sasie : rruge jo te lara 2*jave, data					
A 1	Y	3	1/dite	3 kazane jo te lare				1 Mars	1 Mars	3 Mars		
A 1	Y	3	1/dite	3 kazane jo te lare				1 Mars	1 Mars	3 Mars		
A 2	Y	2	1/dite	-								
A 4	N	1	1/ 2dite	-							punime ne rruge: duhet zhvendosja e kazaneve	
A 5	N	5	1/ 2dite	kazani # 401me rote te demtuar				25 Mars	25 Mars	26 Mars: kazan i ri # 514	shumekazane, 2 janeshpesh bosh, njeritelevizet	
B1	Y	3	1/dite		13 Mars: pika e grumbullimit jo e paster	Rruge jo e paster, mbeturina ne rruge		13 Mars	13 Mars	13 Mars	nuk ka kazane mjaftueshem, te gjithë jane plot, nje duhet te shtohet	
B2	Y	2	1/dite	-								
C1	Y	4	1/dite	-								
C2	Y	2	1/dite	mungon kazani # 207				13 Mars	13 Mars	i pa kryer		
A 1	Y	3	1/dite	3 kazane jo te lare				1 Mars	1 Mars	3 Mars		
A 2	Y	2	1/dite	-								
A 4	N	1	1/ 2dite	-							punime ne rruge: duhet zhvendosja e kazaneve	
A 5	N	5	1/ 2dite	kazani # 401me rote te demtuar				25 Mars	25 Mars	26 Mars: kazan i ri # 514	shumekazane, 2 janesh pesh bosh, njeri te levizet	
B1	Y	3	1/dite		13 Mars: pika e grumbullimit jo e paster	Rruge jo e paster, mbeturina ne rruge		13 Mars	13 Mars	13 Mars	nuk ka kazane mjaftueshem, te gjithë jane plot, nje duhet te shtohet	
Administratori/inspektori i Lagjes/NIA					Supervizori			Specialisti				
					Eva Poja			Fatbardh Kuci				



## 12 Sistemi i performancës

Për të monitoruar dhe për të përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme planin dhe për të rritur cilësinë e shërbimit, Bashkia do të bazohet tek treguesit e performancës dhe ‘benchmarking’, të cilat jepen më poshtë dhe gjenden të shpjeguara me detaje në shtojcën përkatëse të këtij plani - “Manual për shërbimet bazuar në performancë”.

### Treguesit e përzgjedhur të performancës së dhënë për skenarin bazë

Treguesit		Klasifikimi i koduar me ngjyra			Saktësia e të dhënave
		I ulët	I mesëm	I lartë	
					<b>I ulët</b> <b>I mesëm</b> <b>I lartë</b>
Cilësia e shërbimit	C1 Zona e mbuluar me shërbim				
	C1.1 Mbulimi me shërbim në zonat urbane dhe peri-urbane	0 – 40 %	41 – 80%	81 – 100%	
	C1.2 Mbulimi me shërbim në zonat e largëta/izoluara	0 – 30 %	31 – 50%	51 – 100%	
	C2 Pastërtia e qytetit	0 – 32 %	33 - 66%	> 66%	
	C3 Perceptimi publik: shkalla e kënaqshmërisë publike me shërbimin	0 – 50%	51% - 80%	81% - 100%	
Qëndrueshmëria mjedisore	D1 Ripërdorimi: Shkalla e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve në zonat urbane	0 – 5%	5 – 20%	>20%	
	D2 Mbrojtja e burimeve natyrore: shkalla e mbetjeve të trajtuara në venddepozitimet inxhinierike dhe zonat e miratuara dhe të kontrolluara për depozitim	0 – 30%	31 – 70%	71 – 100%	
Qëndrueshmëria e institucioneve ekon.&financ.	E1 Mbulimi i kostos: Tarifa mbulon koston	0 – 35%	36 – 70%	71 – 100%	
	E2 Si qytetarët mund të kontribuojnë në financimin e shërbimit: shkalla e mbledhjes së tarifave	0 – 40%	41 – 75%	75 – 100%	
	E3 Transparenca e sistemit të faturimit	I ulët	I mesëm	I lartë	
<b>Kosto e shërbimit</b>		.....Lek/t .....Lek /banorë / vit			

## 13 Analiza e detajuar financiare dhe operative e shërbimit

### 13.1 Zona e shërbimit Peshkopi – Tomin

<b>Të dhënat bazë</b>	
Emri i NJQV	<b>Zona 1</b>
Frekuenca e grumbullimit (nr. i mbledhjeve)	7
Kategoria (rurale, urbane)	Urbane
Popullsia e shërbyer në këtë zonë	25,000
% e popullsisë që përjashtohet (të regjistruar, por jetojnë jashtë)	0%
<b>Popullsia e shërbyer (merr/konsiderohet për shërbimin)</b>	25,000
Rrugët (distanca nga venddepozitimi një kah) [km]	3.0
Rrugët (distanca e përshkuar gjatë grumbullimit për një turn për një kamion) [km]	12.0
Mbetjet e gjeneruara për eqv. person [kg/ban]	0.60
Totali i mbetjeve të gjeneruara [t/dit]	15.0
Totali i mbetjeve të gjeneruara ndërmjet dy grumbullimeve [t] sipas frekuencës	15.0
Totali i mbetjeve të gjeneruara [t/vit]	5475
<b>Kamionë</b>	
<b>Hipotezat: grumbullimi në të gjithë territorin e NJQV-së, çdo ditë</b>	
Tipi i kamionit [t]	7
Faktori i mbushjes së kamionit [%]	0.85
Kapaciteti mbushës i kamionit (85% kapacitet mbushës) [t]	6.0
<i>Kufiri për numrin e turneve dhe të kamionëve që nevojiten (duke marrë në konsideratë faktin e mbushjes së kamionëve plotësisht, për të evituar blerjen e një tjetri) [t]</i>	1.05
Numri i turneve për kamion në ditë [turne/ditë]	2
Numri i kamionëve të nevojshëm [total]	1.0
<b>Kontenierë</b>	
<b>Hipoteza: grumbullim në të gjithë territorin, çdo ditë</b>	
Kontenitori i mbetjeve (kazan/qese)	<b>Kazan</b>
Lloji i kazanit	1.1
Pesha e mbetjeve në një kazan [t]	0.117
Kazanë/qese ekstra (dëmtim ose nevoja shtesë)	
Numri i kontenitorëve (sipas llojit të zgjedhur - 85% kapacitet mbushës)	128

<b>Kostot operative (grumbullim, transport, mirëmbajtje, personel)</b>	
Ditë në punë/VIT (nëse më pak se 2 ton/ditë, grumbullimi 2 herë/javë)	365
Kostot e karburantit [LEK/l]	190.0
<b>Kostot e mirëmbajtjes</b>	
Sigurimi i kamionit + taksat [LEK/kamion/vit]	100,000 Lek
Vaj + filtra [LEK/kamion/vit]	75,000 Lek
Goma [LEK/kamion/vit]	160,000 Lek
Mirëmbajtja mekanike [LEK/kamion/vit]	200,000 Lek
Parkim [LEK/kamion/vit]	50,000 Lek
Kostot totale të mirëmbajtjes [LEK/vit]	585,000 Lek
<b>Kostot e grumbullimit dhe të transportit</b>	
<b>Kostot e grumbullimit</b>	
Koha për të ngarkuar një kamion një herë - koha e grumbullimit [h]	8.0
Koha totale për grumbullim (nr. i kamionëve * kohë/kamion * nr. i turneve) [h/ditë]	16
Koha për të shkarkuar në "venddepozitim" [h]	0.3
Përqindja e kohës totale për grumbullim [%]	95%
Karburanti i konsumuar gjatë grumbullimit [L/ditë]	83.0
Karburant total i konsumuar për grumbullim [L/vit]	30,295.0
Kostot totale për grumbullim [vit]	5,756,050 Lek
<b>Kostot e transportit</b>	
Shpejtësia e lëvizjes [km/h]	60.0
Koha e transportimit për në "venddepozitim" [h]	0.1
Koha totale e harxhuar për transportim (një ditë/të gjithë kamionët) [hr/d]	0.8
Përqindja e kohës totale për transport [%]	5%
Totali i km për transport për ditë, të gjithë kamionët [km/d]	12
Karburant i konsumuar gjatë transportit [L/d]	4.8
Totali i karburantit të konsumuar për transport [L/vit]	1752
Kostot totale për transport [vit]	332,880 Lek
<b>Grumbullim dhe transport, kostot nëntotale</b>	
Koha në shkarkim në "venddepozitim" (dist.*2/shpejtësi+shkarkim 0,30 h) [h]	0.4
Koha totale e shpenzuar nga një kamion për të përfunduar në një turn [h/turn]	8.4

Koha totale e harxhuar për grumbullim dhe depozitim (një ditë/të gjithë kamionët) [hr/d]	16.8
Totali i karburantit të konsumuar [L/ditë]	87.8
Totali i karburantit të konsumuar [L/vit]	32,047.0
Totali i kostos për karburant për grumbullim dhe transport [LEK/vit]	6,088,930 Lek
<b>Kostot e personelit</b>	
Koha maksimale e punës [h/ditë]	8.0
Ditët maksimale të punës në javë [d/javë]	7.0
Orët maksimale të punës në javë [h/javë]	40
Mirëmbajtja [% e kohës së punës]	7.3%
Pushimet [% e kohës së punës]	7.7%
<b>Shoferët</b>	
<b>Përlllogaritja sipas nevojës ditore:</b>	
Numri i shoferëve bazuar në nevojën ditore (duke marrë në konsideratë kufizimet sipas turneve = nuk mund të ndërrohen shoferët në mes të turnit)	2
<b>Përlllogaritja sipas nevojës javore:</b>	
<i>Orët e punës në javë / shofer, përfshi mirëmbajtjen [h/j]</i>	58.8
<i>A është konform ligjit, duke konsideruar orët maksimale të punës dhe pushimet? (nëse jo, duhet të konsiderohet të merren më shumë shoferë në punë)</i>	JO
Numri total i shoferëve të nevojshëm bazuar në nevojën javore (duke konsideruar kohën maksimale të punës, mirëmbajtjen dhe pushimet)	3
Kohë e mbetur për punë të tjera në javë / për shofer [h/j]	-18.88
Paga mujore e shoferit [LEK/muaj]	32000
Taksat [%]	48%
Paga e bruto e shoferave [LEK/vit]	1,704,960 Lek
<b>Punonjës/operatorë</b>	
Numri i punonjësve për ekip (1 shofer, x punonjës)	2
Numri total i punonjësve	6
Punonjësit shoqërojnë kamionin në "venddepozitim" (po/jo)	po
Orët e punës në javë / punëtor (përfshi mirëmbajtjen) [h/j]	39.23
Kohë e mbetur për detyra të tjera në javë / për punëtor [h/j]	0.74
Paga mujore e punonjësit [LEK/muaj]	26000
Taksat [%]	48%
Paga bruto e punonjësve [LEK/vit]	2,770,560 Lek
<b>Kostot nëntotale për personelin</b>	

Kostot për personelin [LEK/vit]	817 Lek
Kostot për personelin [LEK/banor/vit]	179 Lek
Kostot totale për personelin [LEK/vit]	4,475,520 Lek
<b>Kostot totale (mirëmbajtje, grumbullim, transport, personel)</b>	
Kostot operacionale për ton [LEK/t]	2,036 Lek
Kostot operacionale për banor/vit [LEK/ban./vit]	446 Lek
Kostot nëntotale operacionale (mirëmbajtje, grumbullim, transport, personel) [LEK/vit]	11,149,450 Lek
<b>Investimet kapitale</b>	
<b>Kamionë</b>	
Kostot e një kamioni [LEK]	3,500,000 Lek
Totali i kostove për kamionë (urbane e madhe + 1 rezervë) [LEK]	3,500,000 Lek
<b>Kontenitorët (kazanë ose qese)</b>	
Kosto e një kontenitori (tipi i përzgjedhur) [LEK]	30,000 Lek
Totali i kostos për kontenitor [LEK]	3,850,267 Lek
Kosto nëntotale për investime [LEK]	7,350,267 Lek
<b>Kostot e depozitimit</b>	
Tarifa e depozitimit [LEK/ton]	300 Lek
Kostot totale për depozitim (ton total * kostot për ton) në ditë [LEK/d]	4,500 Lek
Kostot totale për depozitim [LEK/ban./vit]	66 Lek
Kostot totale për depozitim (ton total * kostot për ton) [LEK/vit]	1,642,500 Lek
<b>Kostot e amortizimit</b>	
<b>Kamionë</b>	
Amortizimi i kamionit në vite [vit]	10%
Amortizimi i kamionëve [LEK/vit]	350,000 Lek
<b>Kazanë</b>	
Amortizimi i kazanit në vite [vit]	10%
Amortizimi i kazanëve [LEK/vit]	385,027 Lek
<b>Kosto nëntotale për amortizimin [LEK]</b>	
Kosto totale amortizimi [LEK/vit]	735,027 Lek
Kosto totale amortizimi [LEK/ton]	134 Lek

Kosto totale amortizimi [LEK/banor/vit]	29 Lek
<b>Kostot totale operacionale (mirëmbajtje, grumbullim, transport, personel, depozitim, amortizim)</b>	
Kosto totale operacionale [LEK/vit]	13,526,977 Lek
Kostot administrative [% e kostove totale]	9%
Kostot administrative për grumbullimin e taksave [% e kostove totale]	2%
Kostot administrative për fushatat e ndërgjegjësimet publik [% e kostove totale]	2%
Kostot totale administrative [LEK/vit]	1,758,507Lek
Të ardhurat neto [% e kostove totale]	4%
Totali i të ardhurave neto [LEK/vit]	541,079 Lek
<b>Kostot totale operacionale + administrative [LEK/vit]</b>	<b>15,826,563 Lek</b>
Kostot totale për ton mbetje (cikël i plotë) [LEK/t]	2,891 Lek
Kostot totale për banor mbetje në vit (cikël i plotë) [LEK/ban./vit]	633 Lek
<b>Kostot totale për investime</b>	<b>7,350,267 Lek</b>



## 13.2 Zona e shërbimit Maqellarë - Melan

<b>Të dhënat bazë</b>	
Emri i NJQV	<b>Zona 2</b>
Frekuenca e grumbullimit (nr. i mbledhjeve)	7
Kategoria (rurale, urbane)	Urbane
Popullsia e shërbyer në këtë zonë	15,000
% e popullsisë që përjashtohet (të regjistruar, por jetojnë jashtë)	0%
<b>Popullsia e shërbyer (merr/konsiderohet për shërbimin)</b>	15,000
Rrugët (distanca nga venddepozitimi një kah) [km]	1.0
Rrugët (distanca e përshkuar gjatë grumbullimit për një turn për një kamion) [km]	3.0
Mbetjet e gjeneruara për eqv. person [kg/ban.]	0.40
Totali i mbetjeve të gjeneruara [t/dit]	6.0
Totali i mbetjeve të gjeneruara ndërmjet dy grumbullimeve [t] sipas frekuencës	6.0
Totali i mbetjeve të gjeneruara [t/vit]	2190
<b>Kamionë</b>	
<b>Hipotezat: grumbullimi në të gjithë territorin e NJQV-së, çdo ditë</b>	
Tipi i kamionit [t]	10
Faktori i mbushjes së kamionit [%]	0.85
Kapaciteti mbushës i kamionit (85% kapacitet mbushës) [t]	8.5
<i>Kufiri për numrin e turneve dhe të kamionëve që nevojiten (duke marrë në konsideratë faktin e mbushjes së kamionëve plotësisht, për të evituar blerjen e një tjetri) [t]</i>	1.50
Numri i turneve për kamion në ditë [turne/ditë]	1
Numri i kamionëve të nevojshëm [total]	1.0
<b>Kontenierë</b>	
<b>Hipoteza: grumbullim në të gjithë territorin, çdo ditë</b>	
Kontenitori i mbetjeve (kazan/qese)	<b>Kazan</b>
Lloji i kazanit	1.1
Pesha e mbetjeve në një kazan [t]	0.117
Kazanë/qese ekstra (dëmtim ose nevoja shtesë)	10
Numri i kontenitorëve (sipas llojit të zgjedhur - 85% kapacitet mbushës)	61

<b>Kostot operative (grumbullim, transport, mirëmbajtje, personel)</b>	
Ditë në punë/VIT (nëse më pak se 2 ton/ditë, grumbullimi 2 herë/javë)	365
Kostot e karburantit [LEK/l]	190.0
<b>Kostot e mirëmbajtjes</b>	
Sigurimi i kamionit + taksat [LEK/kamion/vit]	150,000 Lek
Vaj + filtra [LEK/kamion/vit]	90,000 Lek
Goma [LEK/kamion/vit]	160,000 Lek
Mirëmbajtja mekanike [LEK/kamion/vit]	200,000 Lek
Parkim [LEK/kamion/vit]	50,000 Lek
Kostot totale të mirëmbajtjes [LEK/vit]	650,000 Lek
<b>Kostot e grumbullimit dhe të transportit</b>	
<b>Kostot e grumbullimit</b>	
Koha për të ngarkuar një kamion një herë - koha e grumbullimit [h]	4.0
Koha totale për grumbullim (nr. i kamionëve * kohë/kamion * nr. i turneve) [h/ditë]	4
Koha për të shkarkuar në "venddepozitim" [h]	0.3
Përqindja e kohës totale për grumbullim [%]	92%
Karburanti i konsumuar gjatë grumbullimit [L/ditë]	21.5
Karburanti total i konsumuar për grumbullim [L/vit]	7,847.5
Kostot totale për grumbullim [vit]	1,491,025 Lek
<b>Kostot e transportit</b>	
Shpejtësia e lëvizjes [km/h]	60.0
Koha e transportimit për në "venddepozitim" [h]	0.0
Koha totale e harxhuar për transportim (një ditë/të gjithë kamionët) [hr/d]	0.3
Përqindja e kohës totale për transport [%]	8%
Totali i km për transport për ditë, të gjithë kamionët [km/d]	2
Karburant i konsumuar gjatë transportit [L/d]	0.9
Totali i karburantit të konsumuar për transport [L/vit]	328.5
Kostot totale për transport [vit]	62,415 Lek
<b>Grumbullim dhe transport, kostot nëntotale</b>	
Koha në shkarkim në "venddepozitim" (dist.*2/shpejtësi+shkarkim 0,30 h) [h]	0.3
Koha totale e shpenzuar nga një kamion për të përfunduar në një turn [h/turn]	4.3

Koha totale e harxhuar për grumbullim dhe depozitim (një ditë/të gjithë kamionët) [hr/d]	4.3
Totali i karburantit të konsumuar [L/ditë]	22.4
Totali i karburantit të konsumuar [L/vit]	8,176.0
Totali i kostos për karburant për grumbullim dhe transport [LEK/vit]	1,553,440 Lek
<b>Kostot e personelit</b>	
Koha maksimale e punës [h/ditë]	8.0
Ditët maksimale të punës në javë [d/javë]	7.0
Orët maksimale të punës në javë [h/javë]	40
Mirëmbajtja [% e kohës së punës]	7.3%
Pushimet [% e kohës së punës]	7.7%
<b>Shoferët</b>	
<b>Përlllogaritja sipas nevojës ditore:</b>	
Numri i shoferëve bazuar në nevojën ditore (duke marrë në konsideratë kufizimet sipas turneve = nuk mund të ndërrohen shoferët në mes të turnit)	1
<b>Përlllogaritja sipas nevojës javore:</b>	
<i>Orët e punës në javë / shofer, përfshi mirëmbajtjen [h/j]</i>	30.4
<i>A është konform ligjit, duke konsideruar orët maksimale të punës dhe pushimet? (nëse jo, duhet të konsiderohet të merren më hsumë shoferë në punë)</i>	PO
Numri total i shoferëve të nevojshëm bazuar në nevojën javore (duke konsideruar kohën maksimale të punës, mirëmbajtjen dhe pushimet)	1
Kohë e mbetur për punë të tjera në javë / për shofer [h/j]	9.61
Paga mujore e shoferit [LEK/muaj]	32000
Taksat [%]	48%
Paga bruto e shoferëve [LEK/vit]	568,320 Lek
<b>Punonjës/operatorë</b>	
Numri i punonjësve për ekip (1 shofer, x punonjës)	2
Numri total i punonjësve	2
Punonjësit shoqërojnë kamionin në "venddepozitim" (po/jo)	po
Orët e punës në javë / punëtor (përfshi mirëmbajtjen) [h/j]	30.36
Kohë e mbetur për detyra të tjera në javë / për punëtor [h/j]	9.61
Paga mujore e punonjësve [LEK/muaj]	26000
Taksat [%]	48%
Paga bruto e punonjësve [LEK/vit]	923,520 Lek
<b>Kostot nëntotale për personelin</b>	

Kostot për personelin [LEK/vit]	681 Lek
Kostot për personelin [LEK/banor/vit]	99 Lek
Kostot totale për personelin [LEK/vit]	1,491,840 Lek
<b>Kostot totale (mirëmbajtje, grumbullim, transport, personel)</b>	
Kostot operacionale për ton [LEK/t]	1,687 Lek
Kostot operacionale për banor/vit [LEK/ban./vit]	246 Lek
Kostot nëntotale operacionale (mirëmbajtje, grumbullim, transport, personel) [LEK/vit]	3,695,280 Lek
<b>Investimet kapitale</b>	
<b>Kamionë</b>	
Kostot e një kamioni [LEK]	2,400,000 Lek
Totali i kostove për kamionë (urbane e madhe + 1 rezervë) [LEK]	2,400,000 Lek
<b>Kontenitorët (kazanë ose qese)</b>	
Kosto e një kontenitori (tipi i përzgjedhur) [LEK]	30,000 Lek
Totali i kostos për kontenitor [LEK]	1,840,107 Lek
Kosto nëntotale për investime [LEK]	4,240,107 Lek
<b>Kostot e depozitimit</b>	
Tarifa e depozitimit [LEK/ton]	300 Lek
Kostot totale për depozitim (ton total * kostot për ton) në ditë [LEK/d]	1,800 Lek
Kostot totale për depozitim [LEK/ban./vit]	44 Lek
Kostot totale për depozitim (ton total * kostot për ton) [LEK/vit]	657,000 Lek
<b>Kostot e amortizimit</b>	
<b>Kamionë</b>	
Amortizimi i kamionit në vite [vit]	10%
Amortizimi i kamionëve [LEK/vit]	240,000 Lek
<b>Kazanë</b>	
Amortizimi i kazanit në vite [vit]	10%
Amortizimi i kazanëve [LEK/vit]	184,011 Lek
<b>Kosto nëntotale për amortizimin [LEK]</b>	
Kosto totale amortizimi [LEK/vit]	424,011 Lek
Kosto totale amortizimi [LEK/ton]	194 Lek

Kosto totale amortizimi [LEK/banor/vit]	28 Lek
<b>Kostot totale operacionale (mirëmbajtje, grumbullim, transport, personel, depozitim, amortizim)</b>	
Kosto totale operacionale [LEK/vit]	4,776,291 Lek
Kostot administrative [% e kostove totale]	9%
Kostot administrative për grumbullimin e taksave [% e kostove totale]	2%
Kostot administrative për fushatat e ndërgjegjësimit publik [% e kostove totale]	2%
Kostot totale administrative [LEK/vit]	620,918Lek
Të ardhurat neto [% e kostove totale]	4%
Totali i të ardhurave neto [LEK/vit]	191,052 Lek
<b>Kostot totale operacionale + administrative [LEK/vit]</b>	<b>5,588,260 Lek</b>
Kostot totale për ton mbetje (cikël i plotë) [LEK/t]	2,552 Lek
Kostot totale për banor/mbetje në vit (cikël i plotë) [LEK/ban./vit]	373 Lek
<b>Kostot totale për investime</b>	<b>4,240,107 Lek</b>

## 14 Komunikimi dhe ndërgjegjësimi

## 15 Shtojcat

- Shtojca01-Menaxhimi\_Mbetjeve-NjV-KalaDodes
- Shtojca02-Menaxhimi\_Mbetjeve-NjV-Arras
- Shtojca03-Menaxhimi\_Mbetjeve-NjV-Kastriot
- Shtojca04-Menaxhimi\_Mbetjeve-NjV-Lure
- Shtojca05-Menaxhimi\_Mbetjeve-NjV-Luzni
- Shtojca06-Menaxhimi\_Mbetjeve-NjV-Muhurr
- Shtojca07-Menaxhimi\_Mbetjeve-NjV-Selishte
- Shtojca08-Menaxhimi\_Mbetjeve-NjV-Zall\_Dardhe\_Rec
- Shtojca09-Manual-per-Sherbimet-Baze-Performance
- Shtojca 10 - Plani i rehabilitimit të venddepozitimit
- Shtojca 11 - Konsultimet publike